


Krimet e urrejtjes anti-myslimane

Kujdesi për nevojat e sigurisë
së bashkësive myslimane



Udhëzues praktik

Krimet e urrejtjes anti-myslimane

Kujdesi për nevojat e sigurisë
së bashkësive myslimane

Udhëzues praktik



Publikuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike
dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)
Rr. Miodowa 10
00-251 Varshavë Poloni

www.osce.org/odihr

© OSCE/ODIHR 2023

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij publikimi mund lirisht të përdoret dhe kopjohet për qëllime edukative dhe qëllime të tjera jokomerciale, me kusht që çdo riprodhim i tillë të përmend OSBE/ODIHR si burim.

ISBN 978-92-9271-103-0

Dizajnuar nga Homework

I shtypur në Poloni nga Centrum Poligrafii

Përmbajtja

Parathënie	v
Përmbledhje ekzekutive	vii
Hyrje	1
Pjesa e parë: Sfida	7
I. KRIMET E URREJTJES NDAJ MYSLIMANËVE NË RAJONIN E OSBE-SË: KONTEKSTI	8
II. KRIMET E URREJTJES NDAJ MYSLIMANËVE NË RAJONIN E OSBE-SË: VEÇORITË KRYESORE	12
1. Treguesit e paragjykitimit	13
2. Llojet e krimeve të urrejtjes anti-muslimane	17
III. KRIMET E URREJTJES NDAJ MYSLIMANËVE NË RAJONIN E OSBE-SË: NDIKIMI	22
Pjesa e dytë: Standardet ndërkombëtare për intolerancën ndaj myslimanëve	31
I. ZOTIMET DHE DETYRIMET E TJERA NDËRKOMBËTARE	32
II. PARIMET KRYESORE	40
1. E bazuar në të drejta	40
2. E fokusuar te viktimat	41
3. Jodiskriminuese	43
4. Pjesëmarrëse	44
5. E përbashkët	45
6. Bashkëpunuese	46
7. Empatike	46
8. E ndjeshme ndaj gjinisë	47
9. Transparente	47
10. Holistike	49

PJESA E TRETË: Reagimi ndaj krimeve të urrejtjes anti-muslimane dhe sfidat e sigurisë së bashkësive muslimane	51
HAPA PRAKTIKË	52
1. Pranimi i problemit	52
2. Rritja e vetëdijes	55
3. Njohja dhe regjistrimi i motivimit të krimeve të urrejtjes nga paragjykimi anti-musliman	58
4. Sigurimi i provave të nevojave të sigurisë të bashkësisë muslimane duke punuar me ta për të mbledhur të dhëna për krimin e urrejtjes	63
5. Ndërtimi i besimit midis qeverisë dhe bashkësive muslimane	65
7. Sigurimi i mbrojtjes për bashkësitë muslimane dhe lokacionet islame, përfshirë edhe atë gjatë ngjarjeve të veçanta	73
8. Puna me bashkësitë muslimane për të vendosur sisteme të menaxhimit të krizave	74
9. Sigurimi i bashkësisë në rast të një sulmi	76
10. Sigurimi i mbështetjes për viktimat e sulmeve anti-muslimane	77
Shtojca	81
Shtojca 1: Raste studimore	82
Shtojca 2: Veprime të sugjeruara për palët kryesore të interesit	84
Shtojca 3: Islami dhe muslimanët: Çfarë duhet të dinë efektivët e policisë	90
Shtojca 4: Përkufizimi i terminologjisë	96

Parathënie

Krimet e motivuara nga paragjykimi, të njohura gjithashtu si krime të urrejtjes janë krime mesazh: dërgojnë një mesazh drejtuar një bashkësie dhe pjesëtarëve të saj se ata nuk janë të dëshiruar e as të mirëpritur dhe se kërcënimet dhe dhuna do të jenë gjithnjë pranë.

Krimet e urrejtjes anti-myslimane janë një dukuri e përditshme në shumë vende në gjithë rajonin e OSBE-së. Sulmet dhe diskriminimet e tilla i ndalojnë myslimanët nga të shprehurit e lirshëm të identitetit të tyre, çojnë në një ndjenjë mbizotëruese frike dhe pasigurie midis bashkësive myslimane. Ato kanë në shënjestër individë dhe prona myslimane, ose thjesht njerëz që perceptohen si myslimanë. Krimet e urrejtjes përfshijnë sulme ndaj myslimanëve, xhamive, qendrave islamike dhe objekteve arsimore në gjithë rajonin e OSBE-së, si dhe vendeve me rëndësi historike dhe fetare.

Mbështetja për shtetet pjesëmarrëse në përpjekjet e tyre për të luftuar intolerancën ndaj myslimanëve është një element thelbësorë i mandatit tonë në Zyrën e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR). Me këtë Udhëzues, ODIHR ofron rekomandime për të ndihmuar shtetet pjesëmarrëse që të kthejnë zotimet që kanë bërë në veprime praktike. Dëshirojmë të falënderojmë anëtarët e bashkësisë, efektivistët, ekspertët, konsulentët dhe aktivistët që kanë punuar me ne, jo vetëm për bashkëpunimin e tyre, por edhe për angazhimin e tyre aktiv.

I inkurajojmë shtetet pjesëmarrëse që të përdorin këtë Udhëzues praktik si pikënisje për një vlerësim të hapur dhe të mirëmenduar të çështjeve që lidhen me intolerancën ndaj myslimanëve dhe shqyrtimin e politikave dhe masave për ta trajtuar atë. Ky publikim i përgjigjet nevojës për marrjen e masave ndaj sfidave specifike që krijohen si pasojë e intolerancës ndaj myslimanëve, përmes një qasjeje që bazohet fort te kuadri ndërkom-bëtar i të drejtave të njeriut dhe zotimet e OSBE-së.

Së bashku me Udhëzuesin që kemi botuar më parë *Krimet e urrejtjes anti-semite dhe kujdesi për nevojat e sigurisë së bashkësive hebraike*, shpresojmë që ky botim do të përdoret dhe përshtatet për të trajtuar nevojat e sigurisë dhe përvojat e bashkësive të tjera që janë në shënjestër të krimeve të urrejtjes.

Është e pamundur të përmenden të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e këtij Udhëzuesi. Do të donim të falënderonim të gjithë ata që kanë kontribuar në çfarëdo lloj mënyre në përpilimin e tij dhe na ndihmuar t'i japim formën përfundimtare. Këtu përfshihen zyrtarë publikë, përfaqësues të policisë, udhëheqës të bashkësive, mbrojtës të të drejtave të njeriut dhe aktivistë, dhe shumë të tjerë, shumë prej të cilëve kanë qenë vetë viktimat të krimeve të urrejtjes.

Paragjykimet dhe urrejtja që mund të çojnë në krime të urrejtjes rrallëherë i drejtohen vetëm një grupi dhe kjo është arsyeja se pse është kaq e rëndësishme të punohet në përgjithësi drejt një tolerance më të madhe. Siguria është e mundur vetëm në shoqëritë si themel kanë respektin e ndërsjellë dhe barazinë.

Ingibjörg Sólrún Gísladóttir

Drejtori i ODIHR-it

Përmbledhje ekzekutive

Cilat janë sfidat përpara?

Dhuna anti-myslimane, urrejtja dhe diskriminimi kanë në shënjestër gratë, burrat, djemtë dhe vajzat myslimane, bashkësitë ose thjesht njerëzit e perceptuar myslimanë ose që kanë të bëjnë me myslimanët dhe Islamin në të gjithë rajonin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Institucionet myslimane dhe islamike, duke përfshirë xhamitë, hapësirat e faljes (mesxhide), shkollat dhe varrezat janë gjithashtu në shënjestër të dhunës dhe vandalizmit.

Krimet e urrejtjes, incidentet dhe kërcënimet e motivuara nga intoleranca ndaj mysli-manëve ndikojnë thellësisht jo vetëm viktimat e sulmeve specifike, por edhe jetën e përditshme të individëve dhe bashkësive myslimane në një sërë mënyrash. Efektet fizike, emocionale dhe psikologjike mund të përfshijnë:

- Frikën të frekuentohen shërbimet fetare, hyrja në xhami ose mbajtja e veshjeve ose simboleve të ndryshme fetare ose tradicionale që ndikon negativisht të drejtën e individëve dhe bashkësive për të shprehur fenë ose besimet e tyre;
- Ndjenjën e nevojës për të abstenuar nga identifikimi publik si mysli-man, nga të shprehurit e identitetit të tyre kulturor dhe fetar ose nga pjesëmarrja në ngjarje fetare, kulturore ose të tjera, gjë që mund t'i përjashtojë nga jeta publike. Për shembull, individë të caktuar mund të mos synojnë poste publike për shkak të frikës se mund të sulmohen për shkak të emrit ose tipareve të tjera që mund të lidhen me të qenët mysli-man; dhe
- Ndjenjën se në shkollë, në vendin e punës, në mjediset shoqërore ose në mediat sociale, është e domosdoshme të vetë-censurohen, gjë që mund të bëjë që mysli-manët të përmbahen nga të shprehurit e empatisë ose mbështetjes për vendet që kanë një shumicë mysli-mane, me qëllim shmangien e stigmatizimit; madje edhe fëmijët e vegjël mund të rriten me një ndjenjë frike dhe vetëdije për cenueshmërinë e tyre.

Intoleranca kundër mysli-manëve ka rritur frikën brenda bashkësive mysli-mane në rajonin e OSBE-së.¹ Institucionet mysli-mane, si xhamitë dhe qendrat e bashkësisë, kanë gjithnjë e më shumë gjasa të vendosen nën sigurim për shkak të ndjesisë së frikës dhe perceptimit se janë në shënjestër të grupeve anti-mysli-mane – qoftë ato të ekstremist të djathtë, apo grupe nacionaliste agresive dhe të tjera. Megjithatë, nevoja për të vendosur masa sigurie është një barrë financiare për institucionet mysli-mane, që tërheqin fonde të cilat janë paraparë për aktivitete fetare, kulturore dhe arsimore.

1 Shih faqen e internetit të ODIHR-it për Raportimin e krimet të urrejtjes, „Paragjykimi kundër mysli-manëve“, <<http://hatecrime.osce.org/what-hate-crime/bias-against-muslims>>; dhe „Raporti Evropian i Islamofobisë 2016“, Enes Bayrakli dhe Farid Hafez për Fondacionin SETA për Kërkime Politike, Ekonomike dhe Sociale, 2017, <http://www.islamophobiaeurope.com/wp-content/uploads/2017/05/EIR_2016.pdf>.

Si rezultat, dhuna anti-myslimane dhe kërcënimet e me dhunë rrezikojnë sigurinë fizike të bashkësive myslimane, nxisin ndjenjën e frikës dhe pasigurisë në këto bashkësi dhe në të njëjtën kohë i pengojnë kryerjen e veprimtarive që zhvillojnë jetën fetare dhe kulturore të bashkësisë.

Pse kjo gjë duhet të jetë shqetësuese për shtetet pjesëmarrëse?

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë zotuar të njohin, regjistrojnë dhe raportojnë krimet e urrejtjes të motivuara nga paragjykimi anti-mysliman dhe të mbështesin përpjekjet e institucioneve të OSBE-së në zhvillimin e përgjigjeve efektive dhe gjithëpërfshirëse ndaj krimeve të urrejtjes.

Sipas të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, shtetet kanë detyrim të ndalojnë me ligj çdo promovim të urrejtjes fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë.² Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së në Kiev për lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit u bëri thirrje qeverive të OSBE-së që „të marrin masa efektive për të parandaluar dhe eliminuar diskriminimin kundër individëve ose bashkësive fetare apo të besimit në baza fetare ose besimi nga ana e zyrtarëve publikë gjatë përmbushjes së detyrave të tyre publike, përfshirë këtu edhe diskriminimin ndaj jobesimtarëve“, si dhe „të miratojnë politika për të promovuar respekt dhe mbrojtje të vendeve të shërbiemeve fetare dhe të adhurimit, monumentet fetare, varrezat dhe tempujt kundër vandalizimit dhe shkatërrimit“.³ Disa vendime të Këshillit Ministror kanë riafirmuar në mënyrë të përsëritur se krimet e urrejtjes paraqesin kërcënim për sigurinë e individëve dhe për kohezionin social, si dhe potencialin që kjo të çojë në konflikt dhe dhunë të një shkalle më të gjerë.⁴

Çfarë mund të bëjnë qeveritë?

Qeveritë mund të marrin një sërë masash për të adresuar problemin e intolerancës ndaj myslimanëve. Ato mund:

- **Të pranojnë** se intoleranca ndaj myslimanëve dhe paragjykimet përbëjnë një kërcënim për sigurinë dhe stabilitetin dhe duhen adresuar institucionalisht dhe sistematikisht nga ana e qeverive; se kjo duhet parë si një kërcënim i vazhdueshëm për kohezionin social brenda bashkësive dhe si një pengesë për përfshirjen brenda shoqërisë më të gjerë;

2 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 2200A (XXI), „Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike“, 16 dhjetor 1966, kyri në fuqi më 23 mars 1976, Neni 20.2, <<http://www.ohchr.org/en/profession-alinterest/pages/ccpr.aspx>>.

3 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi Nr. 3/13, „Liria e Mendimit, Ndërgjegjes, Fesë ose Besimit“, 6 Dhjetor 2013, Kiev, <<https://www.osce.org/mc/109339?download=true>>.

4 Shiko, për shembull: Vendimet e Këshillit Ministror në Porto 2002 „6/02 mbi Tolerancën dhe Mosdiskriminimin“; Sofje 2004 „12/04 mbi Tolerancën dhe Mosdiskriminimin“; Lubjanë 2005 „10/05 mbi Tolerancën dhe Mosdiskriminimin: Promovimi i respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë“; Bruksel 2006 „13/06 për luftën kundër intolerancës dhe diskriminimit dhe nxitjen e respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë“; Madrid 2007 „10/07 për tolerancën dhe mosdiskriminimin: Promovimi i respektit dhe mirëkuptimit reciprok“.

- **Të vlerësojnë rrezikun dhe të parandalojnë sulmet** duke rritur bashkëpunimin midis autoriteteve ligjzbatuese dhe bashkësive myslimane përmes komunikimit formal, transparencës, si dhe planifikimit dhe veprimit të përbashkët, përfshirë takimet e rregullta me xhamitë dhe institucionet islame. Kjo siguron që nivele të ndryshme të policisë të angazhohen që t'i japin përparësi sigurisë së bashkësive;
- **Të rrisin ndërgjegjësimin** për fenomenin e urrejtjes anti-myslimane dhe ndikimin e saj negativ dhe sistematik, duke e sfiduar atë përmes masave për ndërtimin e kapaciteteve me udhëheqësit politikë, nëpunësit civilë, zyrtarët e drejtësisë penale, organet e barazisë, policinë, shoqërinë civile dhe publikun e gjerë, me qëllim rritjen e kohezionit shoqëror në afat të gjatë dhe përforcimin e vlerave të bazuara në mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të gjithë;
- **Të krijojnë besim** duke zhvilluar dhe institucionalizuar partneritetet e punës me bashkësitë myslimane, organizatat e shoqërisë civile dhe individët. Kjo mund të përfshijë marrëveshje ku policia ndan informacion me shoqërinë civile ose partnerët e bashkësisë për të arritur të kuptojë më mirë shpeshësinë dhe llojet e rasteve, si dhe çështjet që lidhen me krimet dhe incidentet e urrejtjes anti-myslimane;
- **Të përmirësojnë mbrojtjen** për bashkësitë, institucionet dhe vendet myslimane, duke përfshirë përforcimin e patrullave policore dhe ndihmës financiare me qëllim përmirësimin e masave të sigurisë. Përforcimi i patrullave policore mund të zbatohet gjatë festave fetare – si Fitër Bajrami, gjatë namazit të Xhumasë dhe muajit të Ramazanit, dhe në disa bashkësi myslimane në Mavlud, ditëlindjen e Profetit Muhamed - ku ka një përqendrim më të madh të myslimanëve që frekuentojnë xhamitë dhe qendrat islame.⁵ Gjithashtu duhet t'i kushtohet vëmendje rasteve që mund të festohen ose shënohen nga grupet e urrejtjes ose autorët e krimit;
- **Të marrin në konsideratë dhe të përdorin ekspertizën brenda bashkësive myslimane gjatë kryerjes së vlerësimit të kërcënimit, planifikimit të sigurisë dhe/ose zhvillimit të sistemeve të menaxhimit të krizave**, për të siguruar planifikimin dhe përgjigjen më të mirë të mundshme të përbashkët ndaj emergjencave. Sa i përket ekspertizës, duhet të merret parasysh diversiteti i bashkësisë myslimane, duke siguruar poashtu që zëri i grave dhe burrave të dëgjohet, në mënyrë që qasja të jetë autentike dhe e bazuar në nevojat;
- **Të njohin dhe regjistrojnë** çdo motivim nga paragjykimi anti-mysliman gjatë hetimit dhe ndjekjes penale ose sensibilizimit të organeve ligjzbatuese për tiparet specifike të krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve, përfshirë situatat që ndodhin në nivel lokal, kombëtar ose ndërkombëtar. Për shembull, tubimet agresive nacionaliste ose incidentet terroriste kanë dëshmuar në mënyrë të përsëritur se janë shkaktarë të incidenteve

5 Për informacione rreth festave dhe datave të tjera të rëndësishme, mund t'i referoheni Shtojcës 3 të këtij Udhëzuesi.

dhe krimeve të urrejtjes anti-myslimane.⁶ Ndërthurja e etnisë, gjinisë, originës dhe fesë (ndër faktorët e tjerë) mund të rezultojë në mosregjistrimin e motivimit nga paragjykimi anti-mysliman, sidomos kur sistemi i regjistrimit nuk njih mundësinë e paragjykimeve të shumëfishta dhe as nuk lejon zbrëthimin e duhur të të dhënave

- **Të sigurojnë dëshmi për nevojat e sigurisë** të bashkësive myslimane duke punuar me ato bashkësi, si dhe me organizatat e shoqërisë civile në teren për të shkëmbyer të dhënat e zbrëthyer rreth incidenteve të urrejtjes, përfshirë seksin dhe gjininë dhe për të shkëmbyer informacione mbi krimet dhe kërcënimet e urrejtjes anti-myslimane përmes angazhimit të rregullt dhe krijimit të marrëveshjeve të qarta dhe transparente për shkëmbimin e të dhënave;
- **T'i sigurojnë bashkësitë myslimane** për angazhimin e shtetit në drejtim të mbrojtjes së të gjitha bashkësive, duke demonstruar solidaritet dhe duke bashkuar bashkësi të ndryshme në rast të ndonjë sulmi dhe/ose kërcënimi;
- **Të sigurojnë mbështetje për viktimat dhe t'i ndihmojnë bashkësitë për t'iu rikthyer jetës së tyre të përditshme pas një sulmi.** Kjo përfshin sigurimin e mbështetjes fizike, psikologjike dhe emocionale për viktimat e sulmeve anti-myslimane dhe bashkësive të tyre më të gjera. Ndërkohë që përgjegjësia kryesore për sigurimin e shërbimeve publike dhe besimin në to i takon shtetit, organizatat private ose shoqëria civile gjithashtu mund të ofrojnë mbështetje. Puna e përbashkët avokuese me organet si autoritetet e pushtetit vendor, autoritetet policore ose bizneset private, mund të ndihmojë në arritjen e rezultateve domethënëse për viktimat e intolerancës ndaj myslimanëve dhe të punojë për të përmirësuar besimin e bashkësive pakicë në shërbimet dhe agjencitë qeveritare;
- **Të mbështesin hulumtime nga qarqet akademike dhe grupe të shoqërisë civile** mbi narrativat dhe ideologjinë e grupeve të urrejtjes dhe individëve që promovojnë retorikë intolerante, e cila shënjestrën myslimanët dhe bashkësitë e tjera brenda vendeve ose rajoneve përkatëse. Hulumtimi gjithashtu mund të ndihmojë në mbështetjen dhe identifikimin e tendencave për policinë dhe organizatat qeveritare, të cilat mund të mbështesin përpjekjet për të adresuar më mirë krimet e urrejtjes anti-myslimane; dhe
- **Të sigurojnë që mesazhet publike të njohin krimin nga urrejtja,** jo vetëm si kërcënim për dinjitetin dhe integritetin e një individi, por edhe për bashkësi të tëra. Shtetet duhet të shohin nëse mesazhet publike sfidojnë çdo lloj retorike të dhunshme që mund të ketë çuar në rritje të incidenteve të urrejtjes anti-myslimane në një moment të caktuar. Mesazhet gjithashtu mund të dërgohen bashkë me organizatat, grupet dhe përfaqësuesit e bashkësisë për të dënuar urrejtjen dhe për të promovuar tolerancën.

6 Tell MAMA: Raporti Vjetor 2016 Një kërcënim i ndërtuar: Identiteti, intoleranca dhe ndikimi i urrejtjes kundër myslimanëve, (London: 2017, Faith Matters) <<https://tellmamauk.org/wp-content/uploads/2017/11/A-Constructed-Threat-Identity-Intolerance-and-the-Impact-of-Anti-Muslim-Hatred-Web.pdf>>, f. 56.

Hyrje

Historiku

Vendimet e Këshillit Ministror të OSBE-së kanë adresuar intolerancën kundër myslimanëve si çelës për të luftuar të gjitha format e diskriminimit dhe janë zotuar të ndër-marrin veprime konkrete për t'iu përgjigjur kësaj.

Në vitin 2002 në Porto, Këshilli Ministror i OSBE-së dënoi rritjen e akteve të diskriminimit dhe dhunës kundër myslimanëve në zonën e OSBE-së dhe refuzoi fuqimisht identifikimin e terrorizmit dhe ekstremizmit me një fe ose kulturë të caktuar.⁷ Pastaj, në vitin 2004 në Sofje, shtetet pjesëmarrëse i bënë thirrje ODIHR-it që të përdorë informacione të besueshme dhe të ndjekë nga afër incidentet e motivuara nga racizmi, ksenofobia ose intoleranca, përfshirë ato kundër myslimanëve dhe antisemitizmin në zonën e OSBE-së, në bashkëpunim të plotë me institucionet e tjera të OSBE-së, si dhe institucionet përkatëse ndërkombëtare dhe zonës së OSBE-së. Ky vendim gjithashtu bëri thirrje për mbështetjen e shoqërisë civile dhe zhvillimin e partneriteteve për të adresuar këto çështje.⁸

Në vitin 2007, Këshilli Ministror në Madrid theksoi faktin se përgjegjësia kryesore për adresimin e akteve të intolerancës dhe diskriminimit qëndron tek shtetet pjesëmarrëse, përfshirë përfaqësuesit e tyre politikë.⁹ Ky vendim gjithashtu njohu se manifestimet e intolerancës dhe diskriminimit mund të dëmtojnë përpjekjet për të mbrojtur të drejtat e individëve, përfshirë emigrantët, refugjatët, njerëzit që u përkasin pakicave kombëtare dhe njerëzit pa shtetësi. Ky vendim pranoi format e ndryshme të intolerancës, njëkohësisht duke njohur rëndësinë e mbajtjes së një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të adresimit të çështjeve ndër-sektoriale, me qëllim adresimin e të gjitha formave të urrejtjes dhe diskriminimit në mënyrë efektive.

Në vitin 2011, OSBE, UNESCO dhe Këshilli i Evropës publikuan Udhëzimet e tyre të përbashkëta *për Edukatorë për luftimin e intolerancës dhe diskriminimit ndaj myslimanëve: Adresimi i Islamofobisë përmes arsimit*.¹⁰ Ky Udhëzues për shkollat fillore dhe të mesme është në dispozicion në gjashtë gjuhë, dhe u dedikohet politikëbërësve dhe zyrtarëve që punojnë në arsim, si dhe mësëmdhënësve, stafit administrativ të shkollave dhe shoqërisë civile përkatëse. Intoleranca ndaj myslimanëve, ashtu si format e tjera të intolerancës

7 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi Nr. 6/02, „Toleranca dhe mosdiskriminimi“, Porto, 7 dhjetor 2002, <<https://www.osce.org/mc/40521>>.

8 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi Nr. 12/04, „Toleranca dhe mosdiskriminimi“, Sofje, 7 dhjetor 2004, <<https://www.osce.org/mc/23133?download=true>>. Shih gjithashtu, Këshilli i Përhershëm, Vendimi Nr. 621, „Toleranca dhe lufta kundër racizmit, ksenofobisë dhe diskriminimit“, Sofje, 29 korrik 2004, <<https://www.osce.org/pc/35610?download=true>>.

9 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi Nr. 10/07, „Toleranca dhe mosdiskriminimi: Promovimi i respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë“, Madrid, 30 nëntor 2007, <<https://www.osce.org/mc/29452?download=true>>.

10 Udhëzime për edukatorët për luftën kundër intolerancës dhe diskriminimit kundër myslimanëve: Adresimi i islamofobisë përmes arsimit, (Varshavë: ODIHR, Këshilli i Evropës, UNESCO, 2011), <<https://www.osce.org/odihr/84495>>.

dhe paragjykimit, ndikon bashkësitë, duke përfshirë shkollat dhe institucionet arsimore. Përpyekja për të reduktuar intolerancën ndaj myslimanëve nga fëmijët dhe të rinjtë brenda institucioneve arsimore është thelbësore në përballimin dhe luftimin e një sjellje të tillë nga të rriturit e së ardhmes.

Në Kiev në vitin 2013, Këshilli Ministror u bëri thirrje qeverive të OSBE-së të punojnë për të eliminuar diskriminimin në bazë fetare ose besimi. Shteteve pjesëmarrëse u kërkohet gjithashtu të miratojnë politika për të mbrojtur vendet e adhurimit dhe vendet fetare, monumentet fetare, varrezat dhe tempujt.¹¹

Përkufizimi i incidenteve të urrejtjes

Gjatë Konferencës së fundit vjetore të Zbatimit të Dimensionit Njerëzor të OSBE-së, organizatat shoqërore civile theksuan seriozitetin e intolerancës ndaj myslimanëve dhe nevojën urgjente për të mbrojtur bashkësitë nga abuzimi dhe diskriminimi.¹² Në vitin 2018, Përfaqësuesi Personal i Kryesuesit të OSBE-së Profesor Bülent Şenay tërhoqi vëmendjen për trendin shqetësues të retorikës anti-muslimane, theksoi nevojën urgjente për të luftuar demonizimin e myslimanëve dhe tendencat rritëse anti-muslimane në Evropë pas krizës humanitare në vitin 2015 dhe vuri në dukje problemin e raportimit dhe regjistrimit të pamjaftueshëm të krimeve të urrejtjes anti-muslimane.¹³

Pse nevojitet ky Udhëzues?

Intoleranca kundër myslimanëve në çdo formë – qoftë ajo dhunë, diskriminim, ngacim apo abuzim në internet – ka një efekt të dëmshëm në jetën e individëve dhe bashkësive myslimane. Ky Udhëzues është hartuar për të ndihmuar qeveritë në veprimet e tyre për parandalimin dhe luftimin e krimeve të urrejtjes, duke përfshirë analizën e rreziqeve të sigurisë dhe veprimet e nevojshme që kërkohen, me qëllim përmirësimin e kapacitetit të policisë dhe institucioneve të tjera në përmbytjen e nevojave të sigurisë së bashkësive dhe individëve myslimanë. Ai prek gjithashtu tema të veçanta, të tilla si raportimi dhe regjistrimi i pamjaftueshëm i krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve. Përveç kësaj, kemi përcaktuar hapa praktikë që qeveritë mund të ndërmarrin për të trajtuar çështjet e sigurisë për bashkësitë myslimane, që shkojnë dorë për dorë me përpjekjet brenda po këtyre bashkësive.

Qeveritë kanë përgjegjësinë kryesore që të ofrojnë siguri për bashkësitë dhe individët, veçanërisht duke marrë parasysh se bashkësitë minoritare shpesh nuk kanë burime për të siguruar nivelin e sigurisë që kërkohet. Autoritetet e zbatimit të ligjit, si policia, mbajnë

11 Vendimi i KM të OSBE-së Nr. 3/13, Kiev, *op. cit.*, shënimi 3.

12 Takimi i Zbatimit të Dimensionit Njerëzor 2016, Përmbledhje e Konsoliduar, Varshavë, shtator 2016, <<https://www.osce.org/odihr/274416?download=true>>; Takimi i Zbatimit të Dimensionit Njerëzor 2017, Përmbledhje e Konsoliduar, Varshavë, shtator 2017, <<https://www.osce.org/odihr/365486>>; Takimi i Zbatimit të Dimensionit Njerëzor 2018, Përmbledhje e Konsoliduar, Varshavë, shtator 2018, <<https://www.osce.org/odihr/398840?download=true>>..

13 2018 Takimi i Zbatimit të Dimensionit Njerëzor; *Ibid.*

përgjegjësini për adresimin e manifestimeve kriminale të intolerancës ndaj çdo individi ose bashkësie, përfshirë krimet e urrejtjes anti-myslimane. Mosveprimi, veçanërisht mosbashkëpunimi, ndikon në kohezionin social dhe në disa raste të rralla mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm, dhunë dhe pikëpamje të polarizuara brenda pjesëve të ndryshme të bashkësisë së synuar.¹⁴

Ky udhëzues gjithashtu pranon se disa grupe mund të jenë në shënjestër për shkak të intolerancës dhe paragjytimeve brenda bashkësive myslimane.

“Tani, urrejtja anti-myslimane ka pësuar një ndryshim shqetësues—në nivel individual dhe institucional – nga e rrallë në të zakonshme. Ka një mungesë shqetësuese të guximit politik dhe lidërshiptit për këto çështje. Së bashku, ne duhet ta trajtojmë këtë kërcënim mbi bashkëjetesën tonë paqësore. – Bülent Şenay, 2016 Përfaqësues Personal i Kryesuesit të OSBE-së për Luftimin e Intolerancës dhe Diskriminimit ndaj Myslimanëve.¹⁵

Ky udhëzues synon gjithashtu të nxisë dhe inkurajojë analiza dhe kërkime më të gjera, si dhe angazhimin e qeverisë dhe shoqërisë civile për të reduktuar dhe luftuar ndjenjat dhe urrejtjen anti-myslimane, gjë e cila është një sfidë e vazhdueshme në të gjitha shtetet pjesëmarrëse në rajonin e OSBE-së.

Cili është synimi dhe qëllimi i këtij Udhëzuesi?

Ky publikim përqendrohet, në veçanti, në atë çfarë mund të bëhet nga ata që janë përgjegjës për trajtimin e krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve dhe për nevojat e sigurisë së bashkësive myslimane. Ky dokument udhëzues plotësohet nga puna e vazhdueshme e ODIHR-it për të adresuar urrejtjen dhe paragjykimin anti-mysliman duke luftuar krimin e urrejtjes dhe intolerancën, si dhe duke mbështetur edukatorët në luftimin e intolerancës ndaj myslimanëve.¹⁶

Ky Udhëzues përqendrohet në masat praktike që mund të merren nga ata që janë përgjegjës për trajtimin dhe adresimin e krimeve dhe incidenteve të urrejtjes kundër myslimanëve, si dhe për mbrojtjen e bashkësive myslimane. Këta janë kryesisht zyrtarët qeveritarë dhe përfaqësuesit politikë, por gjithashtu shpresojmë se do të jetë i dobishëm edhe për shoqërinë civile dhe publikun më të gjerë. Ai ka për qëllim:

14 Joel Busher and Graham Macklin, *Interpreting „Cumulative Extremism“: A framework for enhanced conceptual clarity.*, Society for Terrorism Research 7th Annual Conference, 27–28 June 2013, London, <<http://eprints.hud.ac.uk/id/eprint/19406/>>.

15 2016 Takimi i Zbatimit të Dimensionit Njerëzor; Përmbledhje Ekzekutive.

16 Shih faqen e internetit të ODIHR-it për Raportimin e Krimit të Urrëjtjes <<http://hatecrime.osce.org/>> dhe *Udhëzimet për edukatorët mbi luftën kundër Intolerancës dhe diskriminimit kundër myslimanëve*, op. cit., shënimi 14

- **Të rrisë vetëdijen** në lidhje me sfidat e sigurisë me të cilat përballen bashkësitë myslimane dhe intolerancën kundër myslimanëve, online dhe offline, si dhe implikimet gjinore që vijnë bashkë me to.
- **Të ndërtojë kapacitetet e zyrtarëve qeveritarë** (si të politikëbërësve, ashtu dhe të zyrtarëve civilë të linjës së parë) në mënyrë që t'i kuptojnë veçoritë specifike të krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve dhe të identifikojnë hapa praktikë në adresimin e nevojave të sigurisë së bashkësive myslimane. Festat fetare, datat ose ngjarjet e rëndësishme dhe lutjet kolektive paraqesin mundësi dhe çështje sigurie për qeveritë dhe policinë;
- **Të mbështesë zyrtarët e policisë** në përpjekjet e tyre për të njohur, regjistruar dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve;
- **Të lehtësojë shkëmbimin e praktikave më të mira** nga shtete të ndryshme pjesëmarrëse të OSBE-së, duke u fokusuar në modele më të mira të përgjigjes nga ana e policisë dhe bashkësisë për krimet e urrejtjes kundër myslimanëve;
- **Të promovojë komunikimin** dhe bashkëpunimin ndërmjet zyrtarëve të policisë lokale dhe pjesëtarëve të bashkësive myslimane, përfshirë aktivistët e bashkësisë myslimane, profesionistët e sigurisë dhe vullnetarët, duke paraqitur sugjerime praktike për bashkëpunim në luftën kundër intolerancës ndaj myslimanëve; dhe
- **Të mbështesë përpjekjet e shoqërisë civile për avokim** duke ofruar resursa siç janë udhëzime dhe një pasqyrë të përgjithshme të detyrimeve relevante të qeverisë, kur kërkohet llogaridhënie e qeverisë rreth shqetësimeve të sigurisë lidhur me intolerancën ndaj myslimanëve.

Si u hartua ky Udhëzues?

Ky Udhëzues bazohet në një publikim analog të përpiluar më parë nga ODIHR për adresimin e antisemitizmit, me titull *Krimet e urrejtjes antisemite dhe kujdesi për nevojat e sigurisë të bashkësive hebraike*.¹⁷ Rreth draftit të këtij udhëzuesi janë bërë konsultime të gjera me anëtarët e bashkësive myslimane, shoqërinë civile, autoritetet policore, organet e barazisë, qarqet akademike dhe palët e tjera të interesit. Gjithashtu, u organizuan dy ngjarje të mëdha konsultative, një në Maqedoninë e Veriut me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup dhe një tjetër në Frankfurt, Gjermani në bashkëpunim me Akademinë për Islamin në Shkencë dhe Shoqëri të Universitetit „Goethe“.¹⁸ Takimi përfundimtar konsultativë ekspert u organizua në Oslo në bashkëpunim me Rrjetin Mysliman të Dialogut. Shembujt e paraqitur në Udhëzuesin u mblodhën nga përfaqësues të shteteve

17 *Kuptimi i krimeve antisemite të urrejtjes dhe adresimi i nevojave të sigurisë së komuniteteve hebraike*, (Varshavë: OSBE/ODIHR, 2017), <<https://www.osce.org/odihr/317166?download=true>>.

18 „Strategjitë për të përmirësuar sigurinë e komuniteteve muslimane dhe për të reduktuar krimin e urrejtjes në fokus të konsultimeve të organizuara nga ODIHR në Frankfurt“, artikulli i lajmeve të ODIHR, 26 qershor 2018, <<https://www.osce.org/odihr/385875>>

pjesëmarrëse dhe partnerëve të shoqërisë civile me anë të një pyetësoi të shpërndarë nga ODIHR për nevojat e sigurisë së bashkësive myslimane dhe shembuj të praktikave të mira.

Si është i strukturuar ky Udhëzues?

Pjesa e parë ofron një pasqyrë të konteksteve të akteve kriminale të motivuara nga intoleranca ndaj myslimanëve në rajonin e OSBE-së, si dhe tiparet kryesore të këtyre krimeve të urrejtjes. Gjithashtu, këtu përshkruhet ndikimi i këtyre krimeve të urrejtjes dhe sfidat përkatëse të sigurisë në jetën e përditshme të individëve, bashkësive dhe institucioneve myslimane.

Pjesa e dytë shpjegon se si qeveritë duhet të reagojnë ndaj krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve dhe si t'i adresojnë në mënyrë efektive sfidat e sigurisë me të cilat përballen bashkësitë myslimane. Duke u bazuar në zotimet e OSBE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, këtu ofrohet një listë e detyrimeve kryesore të qeverisë dhe paraqiten parimet që duhet të mbështesin politikat dhe nismat qeveritare në këtë fushë.

Pjesa e tretë ofron dhjetë hapa praktikë që qeveritë mund të ndërmarrin për t'iu përgjigjur krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve dhe nevojave të sigurisë së bashkësive myslimane.

Shtojcat ofrojnë informacion plotësues për t'i ndihmuar zyrtarët qeveritarë dhe të tjerët që merren me sulmet anti-myslimane. **Shtojca 1** ofron raste studimore që mund të përdoren për të ndërtuar kapacitetet e zyrtarëve qeveritarë dhe personave të tjerë në mënyrë që t'i njohin krimet e urrejtjes kundër myslimanëve, të mirëmbajnë bashkëpunimin me bashkësitë myslimane në lidhje me çështjet e sigurisë dhe të zhvillojnë përgjigje bazuar në respektimin e standardeve dhe zotimeve për të drejtat e njeriut për të gjithë. **Shtojca 2** ofron një tabelë me aktivitete të sugjeruara për palët kryesore të interesite. Kjo tabelë mund të jetë një mjet i dobishëm për rritjen e ndërgjegjësimit mes grupeve kryesore të synuara, si parlamentarët, udhëheqësit fetarë dhe nëpunësit civilë, në lidhje me çështjet e sigurisë me të cilat përballen bashkësitë myslimane. **Shtojca 3** është një udhëzues i shkurtër për Islamin, i përshtatshëm për efektivet e policisë. **Shtojca 4** ofron mbështetje lidhur me terminologjinë.

Pjesa e parë:

Sfida

I. KRIMET E URREJTJES NDAJ MYSLIMANËVE NË RAJONIN E OSBE-SË: KONTEKSTI

Krimet e urrejtjes janë vepra penale të motivuara nga paragjykimi ndaj grupeve të caktuara të njerëzve ose ndaj individëve të caktuar. Të gjitha krimet nga urrejtja kanë dy elemente karakteristike: (1) janë veprime që përbëjnë një vepër penale sipas ligjit penal dhe (2) gjatë kryerjes së krimit, personi vepron në bazë të paragjykimit apo njëanshmërisë.¹⁹

Dallimi i incidenteve të urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes është i rëndësishëm. Krimet e urrejtjes janë *vepra penale të motivuara nga paragjykimi*.²⁰ Kjo do të thotë që autori i krimit ka zgjedhur viktimën ose shënjestrën e sulmit për shkak të një ose më shumë tipareve të mbrojtura – si feja, besimi, „raca“, orientimi seksual apo aftësia e kufizuar, ose për shkak të lidhje së viktimës me këto tipare. Incidentet e urrejtjes, ndonëse kryhen për shkak të një karakteristike specifike të mbrojtur, ose nuk arrijnë nivelin e sjelljes kriminale, ose nuk raportohen si krime.

Paragjykimi anti-mysliman është një nga motivimet nga paragjykimi që e bën një krim (për shembull, një vepër penale sipas ligjit penal) të jetë krim i urrejtjes. Një krim i urrejtjes anti-myslimane është i tillë kur mund të dëshmohet se autori i krimit ka zgjedhur viktimën ose shënjestrën për shkak të besimit të tyre islamik ose lidhjes së tyre me Islam. Krime të tilla janë kryer edhe kundër njerëzve që perceptohen si myslimanë ose kundër njerëzve që kanë lidhje me myslimanët (si aleatë apo bashkëshortë jomyslimanë), si dhe kundër njerëzve të cilët nuk janë myslimanë, por janë shpesh shënjestër e krimeve të urrejtjes anti-myslimane, duke përfshirë, për shembull, anëtarët e bashkësisë sike.²¹

Krimet e urrejtjes kundër myslimanëve nuk kryhen gjithmonë vetëm ndaj një personi, por gjithashtu mund të shpallin një qendër islame, xhami ose organizata të shoqërisë civile që ofrojnë mbështetje ose trajnim, për shembull për gratë ose të rinjtë myslimanë.

Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se motivimi nga paragjykimi i autorit të krimit të urrejtjes anti-myslimane shpesh ndërthuret me paragjykime të tjera, veçanërisht me seksizmin, paragjykimin ksenofobik anti-migrant ose paragjykimin për shkak të ngjyrës së lëkurës ose përkatësisë apo prejardhjes së perceptuar etnike. Një studim i viktimizimit nga krimi i urrejtjes zbuloi se 50 përqind e viktimave të krimit të urrejtjes ishin në shënjestër për shkak të më shumë se një prej tipareve identitare.²²

19 Për një diskutim më të plotë rreth natyrës së krimeve të urrejtjes, shiko: Parandalimi dhe reagimi ndaj krimeve të urrejtjes» (Warsaw: ODIHR, 2009), <<http://www.osce.org/odihr/39821?download=true>>

20 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi Nr. 9/09, „Luftimi kundër krimeve të urrejtjes“, Athinë, 2 dhjetor 2009, <<https://www.osce.org/cio/40695?download=true>>

21 „Policia polake i thotë burrit britanik sikh ‘çfarë prisni pas sulmeve në Paris’ pas rrahjes në klubin e natës“, The Telegraph, Matthew Day, Varshavë, 2 dhjetor 2015, <<https://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/europe/poloni/12029627/>>

22 N. Chakraborti, „Reconceptualising hate crime victimization through the lens of vulnerability and Difference“, Theoretical Criminology Vol. 16, No. 4, 2012. pp.499-514.

Treguesit e paragjykimit anti-mysliman (treguesit e paragjykimit) janë mjeti kryesor që ndihmon në identifikimin e rasteve të krimit të urrejtjes anti-myslimane. Në disa raste, treguesit – dhe si rrjedhojë, motivimi anti-mysliman i autorit të krimit – mund të jenë shumë të dukshëm (p.sh., kur përdoren shpifje anti-myslimane). Në raste të tjera mund të nevojitet një kuptim i nuancuar i stereotipeve dhe kodeve anti-myslimane (p.sh., mesazhe të rëndësishme, vende ose data), të cilat mund të mos jenë të dukshme menjëherë.

Paragjykimet dhe narrativet anti-myslimane

Ndjenjat anti-myslimane kanë ekzistuar në zonën që tani përbën rajonin e OSBE-së për shumë shekuj. Qarqet akademike dhe studiuesit shpesh vënë në pah rritjen e dukshme të intolerancës kundër myslimanëve në nivel ndërkombëtar pas sulmeve të 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara.²³ Sulmet e terrorizmit, zhvillimet e tjera gjeopolitike, rritja e lëvizjeve agresive nacionaliste dhe nativiste të ekstremit të djathtë dhe flukset e migracionit shpeshherë janë katalizatorë të ndjenjave anti-myslimane në gjithë rajonin e OSBE-së.

„Narrativet anti-myslimane ombrellë“ janë kategorizuar kryesisht si më poshtë: Myslimanët si një kërcënim i sigurisë, të paasimilueshëm, kërcënim demografik dhe proelitizim, teokraci, kërcënim i identitetit, pabarazi gjinore, diversitet ontologjik, dhunë e lindur, shtetësi e paplotë dhe homofobi.²⁴

Kjo gamë narrativesh e vazhdon perceptimin se „vlerat myslimane“ janë kaq larg nga „vlerat kombëtare“ mbizotëruese, sa që myslimanët nuk mundën ose nuk duan të integrohen. Sipas Pew Research mbi qëndrimet ndaj myslimanëve, në nëntë prej dhjetë vendeve të anketuara evropiane, të paktën 50 përqind e pjesëmarrësve besojnë se myslimanët e pëlqejnë veçorinë e tyre fetare dhe rrjedhimisht nuk duan të integrohen. Kjo pikëpamje ishte më e përhapur në Greqi (78 përqind), Hungari (76 përqind), Spanjë (68 përqind), Itali (61 përqind) dhe Gjermani (61 përqind). Vetëm në Poloni ishte nën 50 përqind, 45 përqind të të anketuarve ndanin këtë mendim.²⁵

Për më tepër, retorika e lidhur me sigurinë dhe terrorizmin dhe të ashtuquajturën „Lufta kundër terrorizmit“ mund të kontribuojë në abuzim ose sulme kundër myslimanëve dhe të nxisë diskriminim - madje edhe nga institucionet dhe autoritetet - nëpërmjet aplikimit të papërshtatshëm ose joproporcional të „procedurave të luftës kundër terrorizmit.“²⁶

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore „Sondazhi i dytë i Bashkimit Evropian për minoritetet dhe diskriminimin“ zbulon se gati një në tre të anketuar

23 „Zgjedhja dhe paragjykimi: Diskriminimi kundër muslimanëve në Evropë“ (Londër: Amnesty International, 2012).

24 „Pako mjetesh kundër islamofobisë, narrativ dominues islamofobik – Raport krahasues“, Qendra për Studime të Racizmit dhe Etnicitetit, Universiteti Leeds, korrik 2017, <<https://cik.leeds.ac.uk/wp-content/uploads/sites/36/2017/07/2017.07.26-WS1-Comparative-Final.pdf>>.

25 Evropianët me frikë se vala e refugjatëve do të thotë më shumë terrorizëm, më pak punë, 2016, <<https://www.pewresearch.org/global/2016/07/11/europeans-fear-wave-of-refugees-will-mean-more-terrorism-fewer-jobs/>>.

26 Patel, Tina. G. *It's not about security, it's about racism: counter-terror strategies, civilizing processes and the post-race fiction*. Palgrave Communications, Volume 3 (2017).

myslimanë pohojnë se janë diskriminuar gjatë kërkimit të punës. Studimi zbuloi gjithashtu se ngacmimi në baza të prejardhjes etnike apo emigrante ishte i zakonshëm për një në katër të anketuar myslimanë. Simbolet e dukshme fetare, të tilla si veshjet tradicionale apo fetare kanë shkaktuar që një në tre të anketuar myslimanë të kenë përjetuar diskriminim, ngacmim apo ndalime policore. Rreth gjysma prej tyre deklaruan se emrat e tyre, ngjyra e lëkurës apo pamja fizike janë shkak i diskriminimit gjatë kërkimit të strehimit, punës ose marrjes së kujdesit shëndetësor.²⁷

Pavarësisht faktit se myslimanët që banojnë në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së nuk janë monolitikë, duke qenë se kanë prapavijë dhe identitete të ndryshme, ndonjëherë ndaj individëve dhe bashkësive myslimane merret një qasje reduktioniste. Për shembull, raporti i ODIHR-it „Incidentet e motivuara nga urrejtja që synojnë migrantët, refugjatët dhe azil-kërkuesit në rajonin e OSBE-së“, botuar në dhjetor 2015, vë në pah shqetësimet e vazhdueshme rreth konflacionit të ndjenjave anti-refugjate dhe anti-myslimane.²⁸ Meqenëse gjendja e myslimanëve dallon në varësi të vendit, duhet të merren në konsideratë faktorë kompleksë dhe të ndryshëm. Për të kuptuar klimën specifike të myslimanëve brenda rajoneve të ndryshme të OSBE-së nevojitet një qasje e kontekstualizuar. Këto përfshijnë fusha ku Islami është një fe e pakicës, fusha ku etnia dhe feja janë të ndërthurura ose fusha ku ekziston një interpretim mbizotërues i Islamit krahas interpretimeve të reja ose të grupeve të vogla.

Ndërseksionaliteti

Ndërseksionaliteti është studimi i mbivendosjes ose kryqëzimit të identiteteve shoqërore dhe sistemeve të lidhura me shtypjen, dominimin ose diskriminimin. Ai shqyrton se si kategori të ndryshme, si gjinia, „raca“, etnia, klasa, paaftësia, orientimi seksual, feja dhe moshja, ndërveprojnë në nivele të shumëfishta dhe shpesh të njëkohshme, duke propozuar se çdo element apo tipar i një personi është i lidhur në mënyrë të pashmangshme me të gjithë elementet e tjera.²⁹

Hulumtimi, përfshirë këtu Hulumtimin e Rrjetit Evropian kundër Racizmit (ENAR), tregon se të kuptuarit e ndërseksionalitetit dhe krimeve të urrejtjes është në fazën e zhvillimit

27 „Sondazhi i dytë i Bashkimit Evropian për diskriminimin e pakicave dhe myslimanëve – Gjetje të përzgjedhura“, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2017, <https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2017-eu-mi-norities-survey-muslims-selected-findings_en.pdf>.

28 „Takim për konstatimin e fakteve: Incidente të motivuara nga urrejtja që synojnë migrantët, refugjatët dhe azil-kërkuesit në rajonin e OSBE-së“, OSBE/ODIHR, 11 dhjetor 2015, <http://www.osce.org/odihr/235741?download=e_vërtetë>

29 Ndërseksionaliteti është një kuadër cilësor analitik që identifikon sistemin dhe marrëdhëniet e pushtetit që prekin vetëm njerëzit më të marginalizuar në shoqëri. Termi është nxjerrë nga studimet feministe të Kimberlé Williams Crenshaw në vitin 1989. *Forgotten Women: The Impact of Islamophobia on Muslim Women*, (Brussels: ENAR – European Network Against Racism, 2016), <https://www.enar-eu.org/IMG/pdf/forgottenwomenpublication_lr_final_with_latest_corrections.pdf>.

në shumë autoriteteve policore kombëtare.³⁰ Me sa duket, e njëjta vlen edhe për kërkuesit, punëtorët në organizatat e shoqërisë civile dhe ata në institucionat të drejtësisë penale. Një arsye që përmendet shpesh për regjistrimin e pamjaftueshëm të krimeve të urrejtjes janë motivet e përziera të krimit, ku viktimat sulmohen për shkak të më shumë se një treguesi ose motivi paragjykes. Disa forma të zbatimit të ligjit ose sisteme për regjistrimin e krimeve të urrejtjes bëjnë të mundur sinjalizimin e shumëfishtë ose shënimin e më shumë kutive të vogla të mundësive që iu referohen treguesve të paragjykimit. Megjithatë, në mënyrë që të kategorizojnë krimet e urrejtjes duke përdorur një qasje ndërseksionale, policia dhe autoritetet përkatëse duhet t'i bazojnë metodat e tyre në dijeninë se identitetet e viktimave janë shumëpalëshe dhe ndërseksionale dhe për këtë arsye kanë nevojë për një reagim shumështrësor. Për shembull, sulmi i një gruaje myslimane mund të jetë një krim urrejtjeje nëse asaj i hiqet hijehabi me dhunë. Motivi për një krim të tillë urrejtjeje mund të jetë pjesërisht për shkak të fesë së perceptuar të saj, por edhe për shkak të gjinisë. „Raca“ gjithashtu mund të luajë një rol. Një krim i tillë urrejtjeje nuk do të krijonte të njëjtat pasoja për një burrë mysliman ose një grua zezake pa veshje të dukshme fetare. Koncepti i ndërseksionalitetit mund të jetë i dobishëm për ta kuptuar më mirë viktimizimin dhe gjithashtu për ta përmirësuar hetimin policor të këtyre krimeve.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në gjykimin e saj në rastin Alkoviq kundër Malit të Zi, konstatoi se një burrë rom dhe familja e tij nga Mali i Zi ishin ngacmuar nga fqinjët për shkak se ishin romë dhe myslimanë. Gjykata vendosi në favor të gjykatës për sepse ata i janë nënshtruar diskriminimit racor dhe fetare, kërcënimeve me vdekje, grafiteve të vizatuara në derën e tyre, sulmeve mbi makinën e tyre dhe të shtënave me armë në banesën e tyre, para se t'i drejtoheshin organeve ligjzbatuese. Gjykata u përqendrua në dy nga incidentet më kërcënuese. Duke shqyrtuar me kujdes sjelljen e policisë, Gjykata konstatoi mungesë të fakteve. Në një nga incidentet, ishin shkrepur plumba – të akuzuarit për këto të shtëna mohuan fajin, por pohuan se kishin dëgjuar të shtëna dhe kishin parë fishekët. Gjykata kritikoi policinë për mos mbledhjen e e fishkëve dhe për mos hetimin nëse autorët e dyshuar të krimit kanë pasur armë. Gjykata konstatoi se „aplikantit nuk i është siguruar mbrojtja e nevojshme nisur nga e drejta e tij për integritet psikologjik“. Në paraqitjen e saj me shkrim drejt Gjykatës si palë e tretë, Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (QEDR) vuri në dukje ekzistencën e racizmit endemik kundër romëve në shoqërinë malazeze. QEDR gjithashtu vuri në dukje provat për racizëm institucional brenda policisë malazeze, e cila zakonisht i trajtonte krimet e rënda të urrejtjes si kundërvajtje dhe rrallë kishte dënime.³¹

30 Krimet raciste dhe racizmi institucional në Evropë, (Bruksel: ENAR – Rrjeti Evropian kundër Racizmit, 2019), <https://www.enar-eu.org/IMG/pdf/shadowreport2018_final.pdf>; shih gjithashtu Mason-Bish, Hannah and Zempi, Irene, „Misogyny, racism and Islamophobia: street harassment at the intersections“, 2018, Feminist Criminology, <<http://sro.sussex.ac.uk/id/eprint/76134/>>.

31 Shih, RASTI I ALKOVIQ k. Mali i Zi, Aktgjykim i datës 5 dhjetor 2017, Strasburg, <<https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22%3A%22alkovic%22%22itemid%22%3A%22001-179216%22%7D>> dhe „Romët myslimanë fitojnë rastin e diskriminimit kundër Malit të Zi“, Qendra e të Drejtave Evropiane të Romëve, <<http://www.errc.org/press-releases/muslim-roma-win-discrimination-case-against-montenegro>>

Krimet e urrejtjes pas ngjarjeve kombëtare apo ndërkombëtare

Intoleranca ndaj myslimanëve mund të intensifikohet pas ngjarjeve nxitëse - si ngjarje të profilit të lartë kombëtar ose ngjarje politike ndërkombëtare, tubime agresive nacionaliste ose krime dhe incidente terroriste. Krimet e urrejtjes mund të jenë një mikro-manifestim i konflikteve kombëtare ose ndërkombëtare ku individë të grupeve minoritare konceptohen si në kundërshtim me „normat mbizotëruese kulturore“ ose „duke vepruar kundër interesave kombëtarë.“³² Retorika rreth terrorizmit dhe luftës kundër terrorit shpeshherë përdoret për të abuzuar me myslimanët, por gjithashtu mund të nxisë diskriminim nga autoritetet, duke i përdorur në mënyrë të papërshtatshme procedurat kundër terrorizmit.³³

II. KRIMET E URREJTJES NDAJ MYSLIMANËVE NË RAJONIN E OSBE-SË: VEÇORITË KRYESORE

Kërcënimi ose sulmi ndaj një personi për shkak të identitetit të tij mysliman - ose identitetit të perceptuar mysliman - përbën një krim urrejtjeje anti-muslimane. Krimet e urrejtjes kundër myslimanëve janë krime që synojnë individin për shkak të identitetit të tij real ose të perceptuar mysliman ose janë krime të motivuara nga urrejtja ndaj myslimanëve apo Islamit në përgjithësi. Autori i një incidenti anti-musliman mund të targetojë një individ që nuk është mysliman. Autorët e krimet mund të identifikojnë dhe targetojnë një individ për shkak të etnisë, ngjyrës së lëkurës, veshjeve fetare, gjuhës apo emrit të tij. Autorët shpeshherë iu referohen stereotipeve negative ekzistuese rreth myslimanëve dhe Islamit, shpesh duke iu referuar përgjithësisht terrorizmit ose duke iu referuar posaçërisht një ngjarjeje apo incidenti historik të profilit të lartë që ata ia atribuojnë myslimanëve.

Në mënyrë të ngjashme, myslimanët shpesh janë shënjestër e abuzimit lidhur me aspekte të tjera të identitetit të tyre – sidomos me anë të gjuhës ksenofobe dhe raciste – gjë e cila mund të lidhet me tensionet shoqërore dhe historike. Këto forma mund të mbështeten në mungesën e përkatësisë ose mungesën e të drejtës që ka viktimi për të jetuar në atë që autori e percepton si territorin „e tij“. Megjithatë, krimet e urrejtjes të motivuara nga intoleranca ndaj myslimanëve mund të targetojnë gjithashtu një ndërtesë apo institucion, islamik, një biznes apo objekt banimi që ata e lidhin me myslimanët ose Islamin. Vandalizmi ndaj pronës, grafiti anti-musliman, ose vendosja i produkteve të dërrit brenda ose jashtë pronës së një viktime është gjithashtu një metodë e zakonshme e përdorur nga autorët për t'i abuzuar ose frikësuar myslimanët.

ODIHR ka botuar një fletë të dhënash për të ndihmuar palët e interesit të kuptojnë krimet e urrejtjes kundër myslimanëve.³⁴

32 C. E. Mills, J.D. Freilich, and S.M. Chermak, "Extreme Hatred: Revisiting the Hate Crime and Terrorism Relationship to Determine Whether They are 'Close Cousins' or 'Distant Relatives'" *Crime and Delinquency*, 2015.

33 *Ibid*

34 Fletë të dhënash për Krimet e Urrejtjes kundër Myslimanëve, (Varshavë: ODIHR, 2018), <<https://www.osce.org/odihr/373441>>

1. TREGUESIT E PARAGJYKIMIT

Tregues paragjykimi janë një apo më shumë fakte që sugjerojnë se një krim mund të jetë kryer me motiv paragjykes. Ata ofrojnë kritere objektive me anë të të cilave gjyko-het motivi i mundshëm, por jo medoemos dëshmojnë se veprimet e një ofenduesi janë motivuar nga paragjykimi.

Treguesit e paragjykimit për një krim urrejtjeje anti-myslimane përfshijnë sulmimin e individit për shkak të identitetit të tij aktual apo të perceptuar si një mysliman, të bërit komente të qarta anti-myslimane, ndërlidhja me veprimtari ose grupe terroriste dhe/ose terrorizmin. Autoritetet policore duhet t'i regjistrojnë dhe t'i vënë re këto motive dhe tregues paragjykimi kur i intervistojnë dhe punojnë me viktimat e intolerancës kundër myslimanëve.³⁵

Treguesit e paragjykimit janë një mjet i dobishëm për policinë, prokurorët dhe OJQ-të për të analizuar nëse një krim i raportuar është apo jo një krim i urrejtjes. Qëllimi i tyre është të nxisin procesin e gjetjes së provave nëpërmjet pyetjeve të shkathëta ose hetimit të hollësishëm. Një tregues i paragjykimit mund të jetë, por jo medoemos është, dëshmi në sallën e gjyqit.

Në vijim ndodhet një listë joshteruese e treguesve të paragjykimit për krimet e urrejtjes kundër myslimanëve.

Perceptimi i viktimës, dëshmitarit ose i ekspertëve

Nëse një viktimë ose dëshmitar percepton se një kriminel ka qenë i motivuar nga paragjykime anti-myslimane, incidenti duhet të hetohet si një krim urrejtjeje. Një palë e tretë, si një shoqëri civile apo një organizatë e bashkësisë myslimane, e cila regjistron incidente anti-myslimane ose një ekspert i pavarur gjithashtu mund të jenë në gjendje të identifikojnë një motivim nga paragjykimi, që për viktimen apo dëshmitarët nuk ka qenë i dukshëm. Në këto raste, perceptimi i vetë oficerit për shkëljen si një krim potencial i urrejtjes mund të përfshihet si një tregues i paragjykimit.³⁶

Komente, deklaratat me shkrim, gjeste ose grafito

Autorët e krimeve të urrejtjes shpeshherë i bëjnë të qarta paragjykimet e tyre para, gjatë apo pas aktit. Dëshmitë kryesore në shumicën e krimeve të urrejtjes përbëhen prej fjalëve apo simboleve të përdorura nga vetë autorit. Ata që kryejnë krime urrejtjeje në përgjithësi duan t'u dërgojnë një mesazh viktimave të tyre, bashkësive të viktimave dhe shoqërisë

35 Për më shumë informacion, shih: "Përmirësimi i evidentimi të krimeve të urrejtjes nga autoritetet ligjzbatuese: Parimet kryesore udhëzuese", <https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/ec-2017-key-guiding-principles-recording-hate-crime_en.pdf>.

36 Standardet e Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), "Rekomandimi i Përgjithshëm Politik Nr.11 mbi luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racor në polici, miratuar më 29 qershor 2007, <<https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/recommendation-no.11>>.

në përgjithësi. Këto mesazhe, që nga fyerjet e bërtitura e deri te grafitet, janë dëshmi e fuqishme e motivimit paragjykses. Pyetjet e mëposhtme mund të ndihmojnë për të përcaktuar nëse në një krim ka qenë i përfshirë motivimi nga paragjykimi anti-mysliman:

- A ka bërë i dyshuari komente apo deklarata të shkruara rreth mysli-manëve, Islamit dhe përkatësisë reale ose të perceptuar të viktimës në bashkësinë mysli-manë ose kombësisë apo etnisë reale apo të perceptuar të viktimës? Sa i përket kësaj, mbani mend se deklaratat apo sloganet anti-mysli-manë mund të paraqiten gabimisht si thjesht kritikuese ndaj praktikave kulturore, si veshja islame, mbizotërimi i xhamive, mishi hallall ose debatet në lidhje me emigracionin, terrorizmin ose çështje të tjera sociale të lidhura me bashkësitë mysli-manë. Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se abuzimi anti-mysli-man shpeshherë përzihet me deklarata raciste dhe ksenofobe dhe ndjenja paragjykesë, të cilat mund të shprehen nëpërmjet gjuhës raciste dhe ksenofobe;
- A janë lënë në skenën e incidentit vizatime, grafite, karikatura apo vepra arti që paraqesin dhe demonizojnë mysli-manët, Islamin apo Profetin Muhamed? A janë lënë në vendin e incidentit simbole të epokës naziste apo të ekstremit të djathtë që mund të konsiderohen simbole të urrejtjes në kontekstin e shtetit në fjalë? Referimet ndaj sloganeve dhe simboleve të ekstremit të djathtë që synojnë të nxisin urrejtjen ose të frikësojnë mysli-manët dhe grupet e tjera mund të jenë fshehur. Megjithatë, ikonografia e ekstremit të djathtë nuk përfshihet në çdo krim të urrejtjes anti-mysli-manë – p.sh., svastika – shpesh përdoret në krimet e urrejtjes të motivuara nga një lloj tjetër paragjykimi; dhe
- Nëse në shënjestër ka qenë një vend i një rëndësie fetare ose kulturore, a është lënë në skenën e incidentit ndonjë objekt që konsiderohet fyes për mysli-manët (p.sh., mish ose gjak derri)? Krahas xhamive, qendrave kulturore apo shkollave islamike, elemente që kanë për qëllim të frikësojnë mysli-manët mund të lihen edhe jashtë një objekti biznesi apo banimi, që perceptohet si pronë e mysli-manëve.

Konteksti i krimit

Dallimet fetare apo dallime të tjera midis autorit të krimit dhe viktimës nuk janë, në vetvete, një tregues paragjykimi. Megjithatë, pyetjet në vijim mund të ndihmojnë për të hedhur dritë mbi kontekstin e një krimi dhe mund të japin aludime nëse paragjykimi anti-mysli-man mund të ketë qenë një motiv.

- A mbështet autori i krimit ndonjë grup që dihet se është armiqësor ndaj mysli-manëve? A sugjerojnë provat në dispozicion se autori i krimit mbështet grupet e ekstremit të djathtë apo se ka shprehur mbështetje për grupet anti-mysli-manë, raciste apo ksenofobe në internet?
- A ka qenë viktimë dukshëm e identifikueshme si mysli-manë? Individët mund të jenë target abuzimi anti-mysli-man në qoftë se janë veshur me veshje islame (përfshirë

hixhabin ose kandurën) ose edhe me forma të tjera të veshjes fetare ose kulturore (p.sh., turbani i sikëve ose *Shalwar kameez*). Megjithatë, një individ mund të jetë gjithashtu target abuzimi anti-mysliman për shkak të ngjyrës së lëkurës, kombësisë së perceptuar, gjuhës së perceptuar si një gjuhë „që ka të bëjë me myslimanët“ dhe në qoftë se frekuentojnë institucionet e besimit që perceptohen se kanë lidhje me myslimanët.

- A ka targetuar krimi një person që dukshëm është ngritur për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e bashkësisë myslimane?
- A ka qenë viktima e angazhuar në aktivitete të organizuara nga bashkësia myslimane, nga ndonjë organizatë e lidhur me bashkësinë myslimane apo organizatë që mund të perceptohet se ka lidhje me bashkësinë myslimane në kohën e incidentit?

Grupe të organizuara të urrejtjes

Ndonëse jo të gjitha krimet e urrejtjes kryhen nga grupe të organizuara, anëtarë ose bashkëpunëtorë të këtyre grupeve shpeshherë përfshihen në kryerjen e krimeve të tilla. Përgjigjet pohuese të pyetjeve të mëposhtme do të ishin tregues të paragjykitimit:

- A janë lënë në vendin e ngjarjes objekte ose elemente që sugjerojnë se krimi është veprë e neonazistëve, e organizatave të tjera ekstremiste nacionaliste apo e një organizate terroriste ndërkombëtare?
- A ka treguar shkelësi ndonjë mbështetje për ndonjë organizatë terroriste ose a e ka toleruar haptazi veprimin apo misionin e një organizate terroriste që ka targetuar myslimanët?
- A kanë qenë veprimet e autorit të krimit pasqyrim i veprimeve të terroristëve që targetojnë bashkësi myslimane?
- A ka shprehur autori mbështetje në mediat sociale për ndonjë grup anti-mysliman?
- A ka dëshmi se një grup i tillë është aktiv në zonën në fjalë (p.sh., postera anti-myslimanë, grafite apo fletushka)?
- A ka përdorur autori sjellje që lidhet me anëtarësinë në një organizatë urrejtjeje, si përdorimi i përshëndetjeve naziste apo gjeste të tjera të lidhura me lëvizjet anti-myslimane të krahut të djathtë?
- A ka pasur autori veshje, tatuazhe ose ndonjë shenjë tjetër që e lidh me një grup ekstremist apo grup të urrejtjes?
- A ka bërë ndonjë grup i urrejtjes apo grup neo-nazist kohët e fundit kërcënime publike ndaj bashkësisë myslimane, për shembull në mediat sociale apo mediat kryesore?

- A ka përdorur autori terma specifike që mund të jenë tregues të një paragjykimi kundër myslimanëve dhe terminologji që buron nga retorika apo ideologjia e ekstremit të djathtë?

Vendndodhja dhe koha

Vendndodhja dhe koha e një krimi mund të jenë gjithashtu tregues të paragjykimit anti-mysliman. Përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme mund të zbulojnë tregues të paragjykimit:

- A ka ndodhur incidenti pas ngjarjeve të profilit të lartë që kanë acaruar debatet publike rreth Islamit dhe bashkësisë myslimane (p.sh., ngjarjet terroriste ndërkombëtare)?
- A ka ndodhur incidenti në një datë të veçantë? Si për shembull:
 - Festat fetare (p.sh., Fitër Bajrami, Kurban Bajrami);
 - Një ditë me rëndësi për nacionalistët, që ekstremistët dhe grupet e krahut të djathtë mund ta përdorin për të organizuar tubime dhe marshime (p.sh., datat historike të lidhura me pikëpamjet supremaciste);
 - Gjatë muajit të Ramazanit dhe brenda xhamive apo institucioneve myslimane; ose
 - Data të tjera me rëndësi, (p.sh., ditët kombëtare).

Modelet ose shpeshësia e krimeve apo incidenteve të mëparshme

Krimet e urrejtjes ndonjëherë nuk janë ngjarje të vetme, por pjesë e një modeli më të gjerë. Kur kërkohen treguesit e paragjykimit është e rëndësishme të shtrohen pyetjet:

- A ka patur incidente të tjera anti-myslimane në të njëjtën zonë?
- A ka pasur kohët e fundit një shkallëzim të incidenteve anti-myslimane, nga ngacmimet e nivelit të ulët dhe veprimtarisë jokriminale deri te sjelljet më të rënda kriminale, si vandalizmi apo sulmet?
- A i janë bërë viktimës, bashkësisë myslimane apo organizatës së viktimës kohët e fundit kërcënime apo forma të tjera frikësimi, si përmes telefonatave apo postës?
- A ka pasur qarkullim të literaturës anti-myslimane ose të ekstremit të djathtë në zonën lokale?

Natyra e dhunës

Meqenëse krimet e urrejtjes priren të jenë krime mesazhi, shkalla e dhunës, dëmit dhe brutalitetit priren të jenë serioze. Përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme mund të zbulojnë tregues të paragjykimit:

- A ka treguar sulmi një *modus operandi* tipik të një grupi të organizuar të urrejtjes apo organizate terroriste?
- A është e mundur që veprimi të jetë frymëzuar nga një shkelje anti-myslimane e profilit të lartë ose të jetë përpjekur ta kopjojë atë?
- A ka përfshirë incidenti dhunë të paprovokuar dhe ekstreme apo trajtim degradues?
- A është kryer incidenti publikisht ose në një mënyrë të tillë që të bëhet publik, si regjistrimi dhe postimi në internet?
- A është përdorur gjuhë specifike kundër bashkësive myslimane që mund të tregojë ideologji të nxitur nga ekstremi i djathtë dhe grupe të tjera anti-myslimane?

2. LLOJET E KRIMEVE TË URREJTJES ANTI-MYSLIMANE

Spektri i veprave penale të motivuara nga urrejtja anti-myslimane është i gjerë, duke filluar nga sulmet e profilit të lartë deri te incidentet e vogla, të cilat – nëse nuk trajtohen siç duhet – mund të përshkallëzohen. Këto sulme mund të ekzekutohen nga individë që veprojnë vetëm ose nga ata që janë anëtarë të një grupi të organizuar të urrejtjes.

Sulme kundër individëve

Individët sulmohen për shumë arsye. Ata mund të jenë veçanërisht të cenueshëm si rezultat i faktorëve shoqërorë, politikë, fetarë apo faktorëve të tjerë që i bëjnë të identifikueshëm, për shembull nëse:

- Veshin veshje islame, si *hixhabi* ose *kandura*;
- Identifikohen publikisht si përfaqësues të një organizate myslimane ose islamike;
- Janë në afërsi të një xhamie, shkolle islame, qendre kulturore islamike, ose dyqani/restoranti hallall;
- Marrin pjesë në një ngjarje publike myslimane;
- Shënojnë një festë islame;
- Flasin një gjuhë e cila, në një kontekst të caktuar, mund të tregojë potencialisht se një person është mysliman; dhe
- Janë pakicë ose i përkasin një grupi etnik që mendohet se është mysliman.

Veprat penale të motivuara nga intoleranca ndaj myslimanëve gjithashtu synojnë njerëzit që perceptohen si myslimanë ose që lidhen me myslimanët/ Islamin, ngaqë blejnë

në dyqanet hallall, vizitojnë institucione myslimane, ose kanë miqësi apo marrëdhënie shoqërore me myslimanët. Sulmet anti-myslimane mund të synojnë aktivistë ose ekspertë, si offline ashtu edhe online, të cilët luftojnë intolerancën ndaj myslimanëve ose rrisin ndërgjegjësimin për historinë dhe kulturën islame, pa qenë vetë myslimanë.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë disa shembuj të krimeve dhe incidenteve të urrejtjes anti-myslimane kundër individëve në rajonin e OSBE-së, bazuar në raportimin e krimit të urrejtjes nga ODIHR,³⁷

a. Vrasja

Në vitet e fundit, ka pasur vrasje në rajonin e OSBE-së, ku dëshmitë sugjerojnë se sulmet janë motivuar nga paragjykimet anti-myslimane, për shembull:

Kanada Më 29 janar 2017, një person i armatosur hapi zjarr në një xhami në Kebek, duke vrarë gjashtë veta dhe duke plagosur 19, menjëherë pas lutjes të mbrëmjes. Autori u akuzua me gjashtë akuza për vrasje:

Gjermani Në vitin 2009, u sulmua një grua myslimane e veshur me hixhab, u ther me thikë dhe u vra nga një autor i krimit gjatë një seance dëgjimore në një gjykatë të Dresdenit.

Suedi Më 22 tetor 2015, një 21-vjeçar hyri në një shkollë i veshur me maskë dhe theri me shpatë tre persona në sulmin më vdekjeprurës të shkollave në historinë suedeze. Autori i krimit dyshohet se ka sulmuar shkollën për shkak të numrit të madh të nxënësve emigrantë;

Zvicër Më 19 dhjetor 2016, dy veta u vranë, ku një njeri bërtiti „Raus aus unserem land“ (Dilni nga vendi ynë) para se të gjuante me armë zjarri ndaj njerëzve në një Qendër Islamike në Zyrihun qendror; dhe

Mbretëria e Bashkuar Më 29 prill 2013, një i moshuar 82-vjeçar u ther me thikë për vdekje gjatë rrugës për në shtëpi nga një xhami në Birmingham. Autori i krimit më vonë deklaroi se arsye se pse e kishte vrarë ishte se viktima “ishte mysliman dhe nuk kishte pasur dëshmitarë”.

b. Sulme të tjera të dhunshme

Sulme të tjera të dhunshme anti-myslimane ndodhin shpesh në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Sulmet e tilla mes tjerash janë:

- Përdorim i armëve, si armë zjarri, mjete shpërthyes, thika dhe shkopinj bejsbolli;

³⁷ Të gjithë shembujt në këtë seksion janë marrë nga faqja e internetit e ODIHR-it për Raportimin e Krimit të Urrejtjes. Për më shumë informacion dhe shembuj, shiko: <<http://hatecrime.osce.org/what-hate-crime/bias-against-muslims>>.

- Tentim për t'i shtypur viktimat me automjet;
- Rrahje;
- Tërheqja ose përpjekja për t'ia zhveshur rrobat viktimës;
- Grabitjet, shtyrjet, shuplakat, pështyrja ose sulme të ngjashme; dhe
- Sulmi i turmave në objektet myslimane, si xhamitë, kur njerëzit ndodhen brenda ose pranë tyre.

Sulmet e dhunshme anti-myslimane mund të shkaktojnë lëndime të rënda fizike dhe psikologjike, si pasojë e të cilave viktimat kanë nevojë për t'u shtrirë në spital, trajtim mjekësor dhe këshillim. Shembujt në vijim janë nga rajoni i OSBE-së:

Bosnjë dhe Hercegovinë Në vitin 2015 në Republika Srpska, një i kthyer boshnjak mysliman u sulmua nga autorë të panjohur, të cilët gdhendën “katër shkronja S cirilike” (kryqi serb) në stomakun e tij;

Kanada Në vitin 2017, një burrë dhe një grua myslimane u sulmuan fizikisht pasi kishin ndërhyrë kur po kërcënohej me vdekje një grua myslimane, e cila mbante shami në një qendër tregtare;

Francë Më 11 shtator 2019, një burrë theri një grua me thikë dhe hoqi vellon e saj para dy vajzave të saj të reja. Pas ngjarjes, sulmuesi bërtiti: “Kjo është shtëpia jonë” dhe “Nuk ka mbaruar”.

Irlandë Në maj 2016, dy burra afganë dhe një adoleshent u ofenduan dhe u sulmuan fizikisht nga një grup, dy prej viktimave u alivanosën; dhe

Norvegji Në gusht të vitit 2019, një person i armatosur me uniformë dhe helmetë hyri në një xhami në periferi të Oslos duke qëlluar në drejtim të derës së mbyllur. Kishte dy pushka dhe një pistoletë dhe hapi zjarr në faltoren kryesore. Gjithashtu filloi të transmetonte sulmin drejtpërdrejt, që më vonë u hoq nga interneti.

c. Kërcënimet

Kërcënimet anti-myslimane kanë qenë të drejtuara ndaj individëve, udhëheqësve të bashkësisë, institucioneve myslimane dhe bizneseve në pronësi të myslimanëve. Kërcënimet e dhunës mund të përfshijnë forma të ndryshme të sjelljes kërcënuese, kërcënimeve me vdekje dhe kërcënimeve me bombë. Këto kërcënime mund të përcillen me postë, postë elektronike ose media sociale, përmes telefonit, personalisht, përmes grafitëve në institucione myslimane ose në forma të tjera. Kërcënimet mund të përbajnë slogane dhe simbole anti-myslimane si shkurtesë për dhunën, vrasjen dhe shkatërrimin anti-mysliman.

- Kërcënimet anti-muslimane gjithashtu mund të komunikohen përmes objekteve, për shembull:
- Kokë e derrat e vendosur përpara pronës së një personi apo institucioni mysliman;
- Proshutë e vendosur në dorezat e dyerve të një institucioni mysliman, qendre islamike ose në shtëpinë apo makinën e një familjeje muslimane;
- Materiale të ekstremit të djathtë të vendosura në kuti postare dhe xhami; dhe
- Pluhur i bardhë i dërguar xhamive.

Informacionet në vijim janë shembuj realë nga rajoni i OSBE-së:

Austri Në vitin 2017, një grua tuniziane në mënyrë të përsëritur iu është nënshtuar kërcënimeve me shkrim dhe fyerjeve anti-muslimane të lëna në kutinë e saj postare;

Kanada Në vitin 2017, një avokat mysliman dhe mbrojtës i të drejtave të njeriut u fye dhe u kërcënua me vdekje nëpërmjet mediave sociale.

Republika Çeke Në qershor të vitit 2016, një ambasador u kërcënua për shkak të besimit të tij mysliman.

Francë Në shkurt të vitit 2016, një grua muslimane me shami në kokë u abuzua verbalisht dhe u kërcënua me thikë jashtë shkollës së fëmijëve të saj.

Gjeorgji Në një qytet të vogël në vitin 2014, një grup demonstrues protestuan në oborrin e një objekti ku planifikoheshin të jetë një shkollë lokale islamike. Demonstruesit therrën një derr në atë vend dhe e gozhduan kokën e tij në dyert e përparme të ndërtesës;

Greqi Në mars të vitit 2016, një kokë derri u hodh brenda një autobusi që po transportonte refugjatë.

Holandë Shtatë herë brenda vitit 2018 një kokë derri është vendosur brenda ose pranë një xhamie, gjithashtu në shkurt 2016, një xhami mori letra kërcënuese që përmbanin faqe të djegura të Kuranit; dhe

Shtetet e Bashkuara të Amerikës Në shkurt të vitit 2016, një familje muslimane u kërcënua me armë ndërsa po shikonte një shtëpi në shitje.

Sulme kundër pronës

Çdo rast kur një slogan apo simbol anti-musliman përdoret për të dëmtuar dhe vandalizuar një pronë, mund të konsiderohet si incident anti-musliman, pavarësisht nëse prona në fjalë është apo jo e lidhur me bashkësinë muslimane, një institucion mysliman

apo një individ. Për shembull, ka pasur sulme kundër *gurdvarave* sikhe ose vendeve të tjera të adhurimit, prej njerëzve që kanë kujtuar se këto institucione janë vende adhurimi për myslimanët.

Shënjestrat e zakonshme të sulmeve të pronës mund të jenë:

- Xhamitë;
- Shkollat dhe çerdhet myslimane;
- Organizatat myslimane (bëmirëse);
- Varrezat myslimane
- Qendrat kulturore islame ose institucionet kërkimore;
- Dyqane ushqimore hallall, restorante hallall dhe biznese të tjera në pronësi ose të frekuentuara nga myslimanët;
- Shtëpitë private dhe makinat e myslimanëve;
- Vendet dhe aktivitetet përkujtimore (p.sh., ngjarjet përkujtimore për Srebrenicën); dhe
- Artefaktet myslimane.

Sulmet anti-myslimane të pronës mund të marrin format e mëposhtme:

- Zjarrvënie;
- Hedhja e objekteve djegëse dhe shpërthyes, (p.sh., kokteje Molotov);
- Hedhja e gurëve përmes dritareve;
- Vizatimi i grafitëve në mure, dyer ose varre;
- Dëmtimi i xhamive, varrezave ose vendeve përkujtimore;
- Vendosija e posterave dhe etiketave anti-myslimanë në pronën që mendohet të jetë pronë myslimani; dhe
- Shkatërrimi i gurëve të varreve ose dëmtimi i varreve në forma të tjera.

Informacionet në vijim janë shembuj realë të sulmeve të pronës nga rajoni i OSBE-së:

Bosnjë dhe Hercegovinë Në shtator 2016, një xhami u vandalizua me grafitë agresive nacionaliste;

Bullgari Në vitin 2018, u përdhos një varrezë myslimane në Dobriç. Gurët e rreth 40 varreve u përmbysën dhe u dëmtuan;

Estoni Në vitin 2018, në fasadën e një qendre islamike në Talin u shkrua një slogan anti-islam. Slogani përmbante mesazhin “Bombardoje!” Islami i izoluar, a nuk i mban mend mëkatet e tij? Besojmë në Zot. Pse?”;

Greqi Në vitin 2017, dritaret e një shoqate arsimore dhe kulturore myslimane u dëmtuan me gurë një ditë pas hapjes së zyrës;

Poloni Në nëntor 2017, një grup vandalësh sulmuan një qendër kulturore myslimane dhe xhami, duke shkatërruar mbi dhjetë dritare;

Rusi Në shtator 2016, një varrezë myslimane u vandalizua dhe 100 varreza u dëmtuan; dhe

Shtetet e Bashkuara Në janar të vitit 2016, një xhami u vandalizua nga një grup që thërritinin fyerje racore, duke hedhur shishe alkooli dhe mbeturina të tjera në parkingun.

III. KRIMET E URREJTJES NDAJ MYSLIMANËVE NË RAJONIN E OSBE-SË: NDIKIMI

Çdo krim i urrejtjes anti-muslimane është një rikujtim për përhapjen e urrejtjes dhe paragjytimeve anti-muslimane në një shoqëri të caktuar. Meqenëse çdo krim anti-musliman i urrejtjes motivohet nga paragjykimi, çdo sulm gjithashtu shkon kundër parimeve të të drejtave të njeriut të mosdiskriminimit dhe dinjitetit të të gjitha qenieve njerëzore. Kështu, miratimi, pranimi ose injorimi i manifestimeve të intolerancës ndaj muslimanëve nuk është në pajtim me zotimet e OSBE-së për tolerancë dhe mosdiskriminim.

Çdo incident anti-musliman dërgon një mesazh urrejtjeje dhe përjashtimi drejt individëve dhe bashkësive myslimane. Krimet e urrejtjes anti-muslimane gjithashtu krijojnë një ndjenjë frike dhe pasigurie si në nivel individual ashtu edhe në atë të bashkësisë. Veçanërisht, incidentet e urrejtjes anti-muslimane kundër xhamive dhe institucioneve islame dërgojnë një mesazh më të gjerë intolerance dhe mospranimit për të gjithë anëtarët e bashkësisë dhe anëtarët e bashkësive të tjera minoritare. Prandaj, viktimat e incidenteve dhe krimeve të urrejtjes duhen informuar vazhdimisht në lidhje me hetimet e autoriteve policore, pasi kjo është një mënyrë për t'i siguruar bashkësitë lokale.

Krimet e urrejtjes kundër muslimanëve, në kombinim me faktorë të tjerë, të tillë si mungesa e mbështetjes nga qeveria ose mungesa e fondeve adekuate për masa sigurie, mund të krijojnë sfida më të mëdha të sigurisë për bashkësinë myslimane. Muslimanët që duan

ta tetojnë përditshmërinë e tyre – të shkojnë në shkollë, të shkojnë në punë, të shkojnë në pushime – dhe adhuruesit që duan të praktikojnë fenë e tyre lirisht – të veshin veshjet e tyre islame, të shkojnë në xhami, t’i festojnë festat islame, shqetësohen për krimet e urrejtjes ndaj myslimanëve dhe sfidat e sigurisë të shkaktuara nga intoleranca ndaj myslimanëve.

Frika dhe pasiguria e tillë mund të çojnë gjithashtu në pikëpamje të polarizuara rreth bashkësive jomyslimane, ndoshta duke krijuar mendime përçarëse, duke dëmtuar kohezionin social dhe duke izoluar bashkësitë, herë pas here duke shkaktuar hakmarrje dhe përkallëzim të mëtejshëm.

Shembulli i rastit të mëposhtëm thekson këtë pikë:

*“Pas një vizite te berberi im lokal. U largova nga dyqani dhe hasa një grup djemsh zezakë adoleshentë që kishin rrethuar një njeri të bardhë. Mes tyre po zhvillohej një debat i nxehtë. Ndërhyra dhe iu thashë djemve që ta lënë rehat ua bëra me shenjë që të shkonin në një drejtim, ndërsa tërhoqa burrin në drejtimin tjetër. Teksa po e largoja nga vendi i telashit, ai filloi t’i mallkonte djemtë dhe të ulëriste fjalë ofenduese. U përpoqa ta qetësoja, por nuk dëgjonte dhe filloi të shqiptonte fjalë antifetare, p.sh., ‘Q***a Allahun’. Aty i thashë se unë jam vetë mysliman dhe ai u përgjigj: ‘Epo, unë kam mjetet e duhura për të fshirë sojin tënd nga faqja e dheut.’ Pastaj tha: ‘Do pak nga kjo?’, dhe më goditi në fytyrë. Iu thashë kalimtarëve që ta thërrisnin policinë dhe e mbaja për jake që të mos ikte. Në këtë çast, përmendi se kishte një armë të mprehtë dhe u detyrova ta lëshoja. Kjo përvojë e hidhur më ka bërë të frikësuar dhe të dëshpëruar. Më parë, kisha pasur një situatë të ngjashme, ku një klient në McDonalds doli jashtë me një grup miqsh dhe filloi një bisedë. Tema e bisedës së tyre ishte rreth nivelit të urrejtjes që ata kishin për myslimanët dhe se si nëse do të shihnin ndonjë mysliman, do ta vrisnin atë. Isha në afërsi nga ku munda ta dëgjoja bisedën dhe u ndjeva shumë në siklet. E raportova këtë rast në polici, e cila pas hetimit, më tha se nuk kishte pamje ose dëshmi të kamerave. Kjo mu duk shumë e pazakontë pasi rasti kishte ndodhur jashtë një McDonalds me shumë njerëz në një rrugë kryesore të populluar dhe të rrethuar nga gjashtë kamera. U ndjeva sikur policisë nuk i bëhej vonë dhe për fat të keq, nga ajo ditë humba besimin te policia.*

Këtë incident të fundit nuk e kam denoncuar në polici dhe me siguri nuk do ta raportoj. Kjo përvojë e fundit ka shkaktuar që depresioni im të kthehet dhe që nga ajo kohë nuk kam fjetur shumë mirë. Gjithashtu, ndjem sikur nuk i përkas këtë vendi, pavarësisht se kam jetuar këtu për gati 30 vjet, që kur isha fëmijë. Nuk mund ta kuptoj se si dikush mund të fyejë besimin e dikujt. Unë kurrë nuk do të mund të ofendoja fenë apo besimin e dikujt ose ta diskriminoja personin në këto baza, edhe nëse besimi im do të ishte plotësisht i kundërt nga i tiji.”³⁸

38 Raportuar tek “Tell MAMA”, një projekt kombëtar i monitorimit të krimit të urrejtjes anti-myslimane me bazë në Mbretërinë e Bashkuar nga një mysliman britanik me origjinë somaleze në vitin 2017.

Ndikimi i sfidave të sigurisë në jetën fetare dhe të bashkësisë

Disa krime të urrejtjes janë problem i izoluar, ndërsa të tjera ndodhin brenda zonës së kontrollit të bashkësive të organizuara myslimane. Incidentet e tilla paraqesin një sfidë të sigurisë për këto bashkësi, që kërkon zhvillimin e politikave për të parandaluar, për t'u përgatitur për këto incidente dhe për t'u përgjigjur atyre. Këto mund të ndikojnë në jetën fetare myslimane dhe atë të bashkësisë në shumë mënyra:

- Meqenëse myslimanët janë në shënjestër të sulmeve edhe rrugës për në xhami ose në rastet kur janë mbledhur aty, frika ose vetë përvoja me krimet e urrejtjes kundër myslimanëve, ndikon në ndjenjën e tyre të sigurisë kur ata marrin pjesë në shërbiemet ose ngjarjet fetare;
- Frika mund t'i bëjë familjet të shmangin vendin e adhurimit ose të refuzojnë të marrin pjesë në tubime, veçanërisht me fëmijët e tyre, për shkak të rreziqeve të larta të sigurisë.
- Duke pasur frikë nga urrejtja dhe sulmet, krerët e bashkësive mund të zgjedhin ta fshehin ose të mos e bëjnë publike kohën dhe vendin e ngjarjeve me rastin e festave ose rasteve të tjera;
- Nga frika e një sulmi, myslimanët mund të përmbahen nga veshja islame, rritja e mjekrës ose pjesëmarrja në praktika të tjera, duke ndikuar kështu në të drejtën e tyre për të manifestuar fenë e tyre. Disa gra myslimane, të cilat veshin lloje të ndryshme të veshjeve që lidhen me Islamin, vetë-censurohen duke ndryshuar pamjen e tyre në forma të ndryshme ose duke veshur një kapelë për të fshehur identitetin e dukshëm mysliman.
- Frika nga krimet e urrejtjes mund të ketë ndikime kritike shëndetësore mendore dhe psikologjike në identitetin dhe besimin e një personi, duke krijuar një ndjenjë të izolimit mendor dhe fizik ose duke i bërë ata që të kufizojnë praktikimin e hapur të besimit të tyre. Kjo mund të shkaktojë që myslimanët të vënë në dyshim identitetin e tyre fetar dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën fetare myslimane;
- Ekspozimi afatgjatë ndaj krimeve dhe incidenteve të urrejtjes pa pasur një përgjigje të duhur nga autoritetet e qeverisë, mund të bëjë që individë ose bashkësi të tëra të konsiderojnë migrimin ose largimin nga vendet ose shtetet e tyre aktuale; dhe
- Një tjetër reagim i mundshëm është atëherë kur bashkësia vendos të konsiderojë ndonjë lloj të vetëmbrojtjes, siç është blerja e armëve për vetë-izolim të bashkësisë.

Ndikimi i sfidave të sigurisë në shprehjen e identitetit mysliman

Myslimanët mund të përmbahen nga shfaqja e identitetit të tyre fetar në një sërë mënyrash në kontekste të caktuara. Disa njerëz ndjejnë se nuk mund:

- Të pranojnë në biseda se janë myslimanë ose ndjekin praktikat islame si agjërimin ose faljen.
- Të veshin veshje islame, të rrisin mjekrën, të mbajnë një gjë që lidhet me Islam;in;
- Të bëhen pjesë e një organizate myslimane.
- Të gjejnë një punë ose të regjistrohen në një institucion arsimor me një emër që tregon identitetin mysliman;
- Të marrin pjesë në një ngjarje publike islame; dhe
- Të falsin arabisht, urdu ose ndonjë gjuhë tjetër që mund ta ekspozojë prejardhjen e tyre myslimane.

Frika e të qenët i identifikuar si mysliman dhe pasojat e mundshme që mund të mendojë individi, bëjnë që potencialisht të ndër marrë sjellje të tilla shmangëse.

Sipas *Sondazhit të dytë për pakicat dhe diskriminimin në Bashkimin Evropian për myslimanët*, nga raporti i vitit 2017 nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA).³⁹

- „Objekt i ngacmimeve të motivuara nga urrejtja më shumë kanë qenë të anketuarit e brezit të dytë gjatë 12 muajve para sondazhit (36%), sesa të anketuarit e brezit të parë (22%)“;
- “Rreth 39% e grave myslimane që mbajnë shami ose niqab në publik thonë se kanë përjetuar, në 12 muajt para sondazhit, shikime të papërshtatshme ose gjeste fyese për shkak të këtij simboli fetar; 22% kanë përjetuar ofendime verbale ose komente fyese; dhe 2% janë sulmuar fizikisht”.

Raporti gjithashtu thekson ndërthurjen midis “racës” dhe motivimeve të tjera të paragjykitimit, duke deklaruar se “Në përgjithësi, rreth një në katër të anketuar myslimanë (27%) kanë raportuar se kanë përjetuar ngacmime për shkak të prejardhjes së tyre etnike ose emigrante, të paktën një herë gjatë 12 muajve para sondazhit. Kjo shtrihet nga pothuajse gjysma e të gjithë të anketuarve myslimanë nga Afrika nën-Sahariane në Gjermani (48%) dhe Finlandë (45%), deri në 13% -14% të të anketuarve myslimanë nga Afrika nën-Sahariane në Mbretërinë e Bashkuar dhe Maltë.”⁴⁰

39 “Sondazhi i dytë i Bashkimit Evropian për Pakicat dhe Diskriminimin e Myslimanëve – Gjetje të zgjedhura”, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, 2017, <https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2017-eu-mi-norities-survey-muslims-selected-findings_en.pdf>.

40 *Ibid.*

Ndikimi i sfidave të sigurisë në institucionet fetare dhe kulturore myslimane

Për shkak të sulmeve, disa shërbime myslimane të mbështetjes dhe institucione fetare i kanë konsideruar gjithnjë e më tepër masat e sigurisë dhe disa i kanë zbatuar ato. Sulmet e profilit të lartë kundër xhamive që përfshijnë mjete shpërthyes kanë bërë që shqetësimet lidhur me sigurinë të jenë ndër çështjet e para për t'u konsideruar.

Pas sulmit në Christchurch të Zelandës së Re, shumë bashkësi myslimane në gjithë rajonin e OSBE-së kishin frikë dhe disa prej tyre morën mbrojtje të përkohshme nga policia. Për shembull, pas një sulmi të një xhamie në Hungari, asaj iu dha mbrojtje afatshkurtër nga policia. Bashkësia myslimane hungareze pastaj vendosi të fillojë punësimin e rojeve të sigurisë për të mbrojtur xhaminë në vazhdimësi.⁴¹

Ndikimi i sfidave të sigurisë tek të rinjtë

Myslimanët e rinj ndjejnë intolerancën ndaj myslimanëve në mënyrën e tyre. Ndonjëherë ata besojnë se duhet të kërkojnë falje për gjëra të cilat nuk i ndikojnë dot, dhe ndihen të përjashtuar për shkak të fesë ose kulturës së tyre. Mund të ndjejnë se duhet të heshtin përballë urrejtjes anti-myslimane dhe të vetëcensurohen. Kjo gjë është një traumë emocionale dhe mund të ketë ndikim të madh në shëndetin mendor.⁴²

Në një studim mbi “Islamofobinë në Dublin: Përvojat dhe si të reagojmë”, myslimanët e rinjë kujtonin përvojat e tyre të përjashtimit dhe abuzimit përmes praktikave diskriminuese nga mësimmthënësit, ligjëruesit dhe shokët e klasës. Këto u manifestuan si përvoja të abuzimit verbal nga shokët e klasës dhe stafit; praktika përjashtuese ndaj nxënësve për mbajtjen e mbulesës; dhe mosadresimi i racizmin anti-mysliman brenda klasës.

„Isha në orën e frëngjishtes [tavolina e arsimtarit ishte afër]... dhe vajza [në bankën time] më drejtohet: ‘A është e vërtetë që babi yt është terrorist?’ Unë them, jo nuk është, ç’kujton ti? Dhe vajza pranë meje fillon të flasë ... ‘po, arabët myslimanë janë terroristë’ dhe kështu me radhë... kështu që pas kësaj... mësuesja ime e frëngjishtes është kujdestarja ime... unë shkoj tek ajo dhe i them kështu, kështu, kështu ka ndodhur. [Ajo u përgjigj] „më fal, s’mund të bëj asgjë [??]“ ... Çfarë?!?! Kështu që unë u largova nga shkolla dhe shkova në një shkollë private... dhe atje më trajtonin shumë më mirë...“

41 Përgjigja ndaj pyetësorit të ODHR-it në lidhje me nevojat e sigurisë së bashkësive myslimane dhe shembuj të praktikave të mira, në 23 shtator 2019 nga Lidhja Hungareze e Mbrojtjes Myslimane (Magyar Iszlám Jogvédő Egyesület)

42 „Të ndihmojmë nxënësit të përballen me traumat e lidhura me dhunën gjeopolitike dhe islamofobinë: Një udhëzues për edukatorët“, Shoqata e Shërbimeve Sociale Islamike dhe Këshilli Kombëtar i Muslimanëve Kanadezë, <<https://www.toronto.ca/wp-content/uploads/2019/04/97e4-Geopolitical-Violence-and-Islamophobia.pdf>>.

„Një fëmijë në klasën e djalit tim kishte një tingull shpërthimi [në telefon]... dhe ndërsa [djali im] hyri në klasë [ky djali tjetër] ai e kishte lëshuar bombën [tingull] dhe kur [djali im] shkoi te kujdestari i tij dhe i tha se ky veprim ishte racist [kujdestari] tha, 'Kjo nuk është raciste'... [prind].“⁴³

Ndikimi i jotolerancës ose urrejtjes ndaj myslimanëve mund t'i çojë të rinjtë myslimanë që:

- Të përjetojnë abuzim verbal dhe fyerje anti-muslimane, bullizëm në shkolla, si dhe ngacmime fizike dhe sulme në internet;
- Të jenë dëshmitarë të incidenteve dhe krimeve të urrejtjes anti-muslimane, si dhe të përjetojnë intolerancë kundër myslimanëve në internet - forume, platforma të mediave sociale dhe faqe interneti;
- Të marrin komente raciste dhe seksiste, ku autorët e krimeve përdorin një qasje të tillë si mjet për t'i poshtëruar dhe abuzuar gratë e reja myslimane ose për t'i stereotipizuar burrat si „terroristë“, „grabitqarë seksualë“ ose „të shtypur“;
- Të reduktojnë lëvizjen në zona të caktuara dhe të kufizojnë periudhat kohore kur udhëtojnë për në punë apo pazar dhe pas – veçanërisht nëse janë femra dhe/ose vetëm (gjithashtu mund të zvogëlojë lëvizshmërinë e tyre ekonomike ose sociale);
- Të kenë më shumë gjasa që të vuajnë nga intoleranca dhe paragjyqimi në transportin publik, si në autobusë dhe tramvaje, apo në stacionet nëntokësore dhe trena;
- Ta kenë më të vështirë ballafaqimin me identitetin e tyre mysliman në krahasim me gjeneratat e mëparshme, për shkak të klimës aktuale gjeopolitike; dhe
- Ta izolojnë veten nga shoqëria më e gjerë dhe të integrohen me myslimanë të tjerë për të pasur një ndjesi mbrojtjeje.

Kjo letër e gjetur në një autobus të Londrës përshkruan se si është ndërë një vajzë adoleshente myslimane pas sulmit terrorist në Uestminster.

“I dashur i huaj

Të lutem, lexo letrën time – Nga – një myslimane

E dashur Londër Unë jam një londineze 14 vjeçe. Gjithashtu kam fatin që të jem një myslimane zezake. Pas tragjedive në sulmin e Uestminsterit, arrita në përfundimin se

43 James Carr, “Islamofobia në Dublin: Përvojat dhe si të përgjigjemi”, Këshilli i Imigrantëve të Irlandës, Dublin, 2016.

doja të bëja diçka. Një gjë shumë e tmerrshme ndodhi mu në zemër të Londrës, në këtë vend që e dua shumë. Pasi dëgjova për sulmin, isha shumë e shqetësuar dhe e frikësuar për qytetarët e Londrës dhe për viktimat. Të nesërmen u zgjova herët dhe po shihja lajmet dhe papritmas u vetëdijesova se do të shkoja në shkollë dhe njerëzit do të prisnin përgjigje nga unë. Ndërsa po dilja nga dera në orën 8.15, siç bëj zakonisht dhe ndërsa shihja fytyrat e njohura të përditshmërisë sime, pyesja veten se çfarë po mendonin. U përpoqa të dukeshja sa më mirë dhe ecja duke buzëqeshur, duke shpresuar për një buzëqeshje në këmbim. Disa ma kthyen e disa jo. Ndërsa po flisnim për çështjet aktuale ndjeva që të gjitha shikimet po më drejtoheshin mua. Papritmas fillova të skuqem dhe më hypi i nxehti - pothuajse po ndihesha fajtores? Për çfarë duhet të jem fajtores? Nuk i jepja dot hall nëse isha unë paranojake apo me të vërtetë shikimet po turreshin drejt cepit të dhomës ku isha ulur. U futa në mësimin tim të parë dhe një vajzë më pyeti se ku kisha qenë mbrëmë, unë qesha sepse e dija se ajo po bënte shaka, sepse kështu bëjnë kur nuk dinë se çfarë të thonë. Nuk ke nevojë t'i thuash asgjë shokut apo kolegut tënd mysliman. Mund të jemi myslimanë, por nuk duam t'ju lëndojmë. Ne nuk jemi terroristë. Çdo të shtunë unë kaloj nëpër Uestminster por kësaj here mu desh ta mendoja dy herë. Kisha frikë se ndoshta do të sulmohesha për shkak të etiketave të shumta që vijjnë me veshjen e hixhabit... Kam shumë tendenca digresioni kur shkruaj, andaj po dal drejt e në temë. Jam punëtores e palodhur dhe nuk ka asgjë që dua më tepër sesa të përfundoj arsimin tim dhe të bëhem avokate, por Londra është shtëpia ime dhe unë dua që kjo të ndodhë këtu. Ndonjëherë pyes veten nëse kjo do të ndodhë dhe nëse do të jem në gjendje të gjej një punë pas 10 vjetësh. Shpresoj se do të mundem. Është e frikshme të jesh mysliman në një kohë kur ndodhin këto akte të tmerrshme terrori dhe shpresoj që unë të mund të jetoj ende këtu pas 50 vjetësh dhe që fëmijët e mi të mund të shohin bukurinë e Londrës dhe njerëzit e mrekullueshëm që jetojnë këtu. Ajo që ndjej është e tepërt për t'u shprehur në letër dhe shpresoj se kam arritur ta komunikoj mirë mesazhin tim për këdo që është duke e lexuar. "Shpresa ime e fundit - si shpresa e shumë të tjerëve - është paqja." Faleminderit që e lexove këtë. Kam shpenzuar kohë duke shkruar këtë letër dhe ti mund të vendosësh që ta zhubrosësh, ta mbash ose t'ia lësh një personi tjetër për ta lexuar. Gjithçka që kërkoj është që dikush të mësojë diçka nga kjo letër edhe nëse gjithçka që mund të mësojë është se unë kam një shkrim dore të tmerrshëm."⁴⁴

Rritja e cenueshmërisë së grave ndaj krimeve të urrejtjes

Sipas projektit Gratë e Harruara të ENAR-it, në shumicën e vendeve të anketuara (Belgjikë, Francë, Gjermani, Itali, Holandë, Suedi dhe Mbretëria e Bashkuar), gratë myslimane kishin më shumë gjasa, në krahasim me burrat myslimanë, që të vuanin dhunën e motivuar nga paragjykimet, e cila zakonisht ndodh në hapësira publike. Këto sulme përfshijnë abuzimin verbal, gjuhën e urrejtjes, kërcënimet dhe dhunën fizike. Për shembull, në Holandë, gratë përbënin mbi 90 përqind të viktimave nga incidentet anti-myslimane

44 "I dashur i huaj, të lutem lexoje letrën time". – "Nga – një myslimane", 3 prill 2017, raportuar në Metro.co.uk, <<https://metro.co.uk/2017/04/03/dear-stranger-please-read-my-letter-from-a-muslim-6551982/?ito=cbshare>>.

të raportuara në organizatën e shoqërisë civile *Meld Islamophobie* në vitin 2015.⁴⁵ Në mënyrë të ngjashme, në vitin 2014, 81.5 përqind e dhunës anti-muslimane, të regjistruar nga organizata Kolektivi kundër islamofobisë (*Le Collectif contre l'islamophobie*) në Francë, ka synuar gratë, shumica e të cilave kishin veshur rroba dukshëm myslimane.⁴⁶ Dëshmitë sugjerojnë se autorët e abuzimit anti-musliman i synojnë gratë myslimane për shkak të veshjes dukshëm islame, por edhe për shkak të ndjeshmërisë së perceptuar të grave, duke i bërë ato një „objektiv të lehtë“ për abuzim.

Llojet e abuzimit të përjetuar nga burrat dhe gratë mund të jenë të ndryshme. Siç u përmend më parë në lidhje me ndikimin e intolerancës ose urrejtjes tek myslimanët e rinj, retorika përçarëse rreth myslimanëve është gjithashtu gjinore. Për shembull, perceptimi i ndërtuar për myslimanët është se janë “mizogjenë”, “me tendencë drejt ekstremizmit” dhe “seksualisht devijues”.⁴⁷

Këto ndikime të ndryshme e bëjnë të qartë arsyen se të dhënat e krimit të urrejtjes duhet të ndahen jo vetëm sipas motivimit nga paragjykimi anti-musliman, por edhe sipas seksit dhe gjinisë së viktimës, për të pasur një pamje më të mirë dhe më të saktë, jo vetëm të prevalencës, por edhe të tendencave në krimet e urrejtjes. Për fat të keq, kjo ende nuk është një praktikë standarde në shumë vende të OSBE-së.

45 Gratë e harruara: ndikimi i islamofobisë tek gratë muslimane, ENAR, 2016, <http://www.enar-eu.org/IMG/pdf/factsheets9-european_lr_1_.pdf>

46 *Ibid.*; gjithashtu shih *Abu-Lughod, Lila, Do Muslim Women Need Saving?*, (Cambridge, Mass: Harvard University Press, 2013) pg. 336.

47 A. Gil and K. Harrison, *Child Grooming and Sexual Exploitation: Are South Asian Men the United Kingdom Media's New Folk Devils?*, International Journal for Crime, Justice and Social, 2015.

Pjesa e dytë:

Standardet ndërkombëtare
për intolerancën ndaj myslimanëve

I. ZOTIMET DHE DETYRIMET E TJERA NDËRKOMBËTARE

Zotimet e dimensionit njerëzor të OSBE-së

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë dënuar në mënyrë të përsëritur dhe janë zotuar të adresojnë „totalitarizmin, urrejtjen racore dhe etnike, ksenofobinë dhe diskriminimin ndaj kujtdo, si dhe persekutimin mbi baza fetare dhe ideologjike“ duke filluar me Dokumentin e Kopenhagës të Konferencës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë në 1990 – para se OSBE-ja të krijohet zyrtarisht si organizatë.⁴⁸

OSBE ka theksuar rëndësinë e monitorimit të krimeve të urrejtjes, duke përfshirë krimet e motivuara nga intoleranca ndaj myslimanëve:

- Në Mاستriht në vitin 2003, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u inkurajuan që: „të mbledhin dhe të mbajnë shënime mbi informacionin dhe statistikave të besueshme për krimet e urrejtjes, përfshirë format e manifestimeve të dhunshme të racizmit, ksenofobisë, diskriminimit“;⁴⁹ dhe
- Në Lubjanë në vitin 2005, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut u ngarkua për të „ndihmuar shtetet pjesëmarrëse sipas kërkesës së tyre në zhvillimin e metodologjive dhe kapaciteteve të përshtatshme për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e informacionit dhe statistikave të besueshme për krimet e urrejtjes dhe manifestimet e dhunshme të intolerancës dhe diskriminimit, me qëllim që t’i ndihmojë të mbledhin të dhëna dhe statistika të krahasueshme“.⁵⁰

Këto thirrje u nxitën nga nevoja për të monitoruar dhe matur krimet e urrejtjes në shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.

Vendimet shpesh të Këshillit Ministror të miratuara në vitin 2006 dhe 2007, në lidhje me tolerancën dhe mosdiskriminimin, janë:

- Riafirmoi „nevojën për vendosmëri nga shtetet pjesëmarrëse në luftimin e të gjitha akteve dhe manifestimeve të urrejtjes, përfshirë krimet e urrejtjes, duke pranuar se përpjekjet që nevojiten për t’i adresuar ato shpesh nënkuptojnë një qasje të përbashkët, duke njohur njëkohësisht veçantinë e manifestimeve dhe prapavijën historike të çdo forme“;⁵¹ dhe

48 “Dokumenti i Takimit të Kopenhagës të Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të OSBE-së”, 29 qershor 1990, paragrafi 40, <<http://www.osce.org/odihr/elections/14304?download=true>>.

49 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi nr. 4/03, “Toleranca dhe mosdiskriminimi”, 2 dhjetor 2003, Mاستriht, <<https://www.osce.org/mc/19382?download=true>>.

50 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi nr. 10/05, “Toleranca dhe mosdiskriminimi: Promovimi i respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë”, 6 dhjetor 2005, Ljubljana, <<https://www.osce.org/mc/17462?download=true>>.

51 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi nr. 13/06, Bruksel, *op. cit.*, shënimi 4.

- „Përgjegjësia kryesore për adresimin e akteve të intolerancës dhe diskriminimit u takon shteteve pjesëmarrëse, përfshirë përfaqësuesit e tyre politikë”.⁵²

Vendime të ndryshme të Këshillit Ministror kanë pranuar nevojën për të zhvilluar përgjigje gjithëpërfshirëse për gamën e gjerë të krimeve të urrejtjes, duke përfshirë krimet e urrejtjes kundër myslimanëve.

- Vendimi i Këshillit Ministror Nr. 13/06 u bëri thirrje „shteteve pjesëmarrëse të adresojnë shkaqet rrënjësore të intolerancës dhe diskriminimit duke inkurajuar zhvillimin e politikave dhe strategjive gjithëpërfshirëse të arsimit të brendshëm, si dhe përmes masave për rritjen e ndërgjegjësimit që [...] synojnë të parandalojnë intolerancën dhe diskriminimin, përfshirë atë kundër të krishterëve, hebrenjve, myslimanëve dhe anëtarëve të feve të tjera”.⁵³
- Vendimi i Këshillit Ministror Nr. 10/07 bëri thirrje për “përpjekje të vazhdueshme nga përfaqësuesit politikë, përfshirë parlamentarët, për të kundërshtuar dhe dënuar fuqimisht manifestimet e racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit, diskriminimit dhe intolerancës, përfshirë ato kundër të krishterëve, hebrenjve, myslimanëve dhe besimtarëve të feve të tjera, si dhe manifestimet e dhunshme të ekstremizmit që lidhen me nacionalizmin agresiv dhe neo-nazizmin, duke vazhduar të respektojnë lirinë e shprehjes”.⁵⁴

Për shembull, në vitin 2009, shtetet pjesëmarrëse u zotuan që:

- „Të mbledhin, mirëmbajnë dhe bëjnë publike të dhëna dhe statistika të besueshme për krimet e urrejtjes dhe manifestimet e dhunshme të intolerancës në detaje të mjaftueshme, duke përfshirë numrin e rasteve të raportuara tek personeli i policisë, numrin i rasteve të përndjekura dhe numrin e dënimeve të shqiptuara;
- Të miratojnë, aty ku është e përshtatshme, legjislacion specifik dhe të përshtatur për të luftuar krimet e urrejtjes, duke parashikuar dënime efektive që marrin parasysh peshën e krimeve të tilla;
- Të marrin masat e duhura për të inkurajuar viktimat që të raportojnë krimet e urrejtjes, duke pranuar se raportimi i pamjaftueshëm i krimeve të urrejtjes i pengon shtetet në hartimin e politikave efikase. Në këtë drejtim, si masa plotësuese, të eksplorojnë metoda për lehtësimin e kontributit të shoqërisë civile për të luftuar krimet e urrejtjes;
- Të prezantojnë ose zhvillojnë më tej trajnime profesionale dhe aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve për personelin e policisë, zyrtarët e prokurorisë dhe gjyqësorit që merren me krimet e urrejtjes;

52 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi nr. 10/07, Madrid, *op. cit.*, shënimi 9.

53 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi nr. 13/06, Bruksel, *op. cit.*, shënimi 4.

54 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi nr. 10/07, Madrid, *op. cit.*, shënimi 9.

- Në bashkëpunim me aktorë relevantë dhe të besuar, të eksplorojnë mënyrat për t'iu siguruar viktimave të krimeve të urrejtjes qasje në këshillim, ndihmë ligjore dhe konsullore, si dhe qasje efektive në drejtësi;
- T'i hetojnë në mënyrë të menjëhershme krimet e urrejtjes dhe të sigurohen se motivet e të dënuarve për krime të urrejtjes njihen dhe dënohen publikisht nga autoritetet përkatëse dhe nga udhëheqja politike;
- Të sigurojnë bashkëpunim aty ku është e përshtatshme, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë me organet përkatëse ndërkombëtare dhe mes policisë, për të luftuar krimin e dhunshëm të organizuar të urrejtjes; dhe
- Të bëjnë përpjekje për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit, veçanërisht me autoritetet policore, drejtuar bashkësive dhe grupeve relevante të shoqërisë civile që i ndihmojnë viktimat e krimeve të urrejtjes.⁵⁵

Udhëzimet për Edukatorët për Luftimin e Intolerancës dhe Diskriminimit Kundër Myslimanëve 2011 nga OSBE, UNESCO dhe Këshilli i Evropës konfirmoi nevojën që personat në institucionet arsimore dhe pozitat e ndikimit të punojnë drejt kuptimit të manifestimeve të intolerancës ndaj myslimanëve në këto institucione dhe të përdorin metoda për të reduktuar dhe për ta luftuar intolerancën, në mënyrë që ndryshimi aktiv pozitiv të mund të zbatohet për ta sfiduar këtë fenomen.⁵⁶

Në takimin e Këshillit Ministror të Kievit në vitin 2013, shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së theksuan “lidhjen midis sigurisë dhe respektit të plotë për lirinë e mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit” dhe shprehën shqetësimin e tyre të thellë për “aktet e vazhdueshme të intolerancës dhe dhunës kundër individëve dhe bashkësive fetare ose të besimit në bazë të mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit në mbarë botën”. Këshilli Ministror u bëri thirrje shteteve pjesëmarrëse që:

- “Të synojnë parandalimin e intolerancës, dhunës dhe diskriminimit në bazë të fesë ose besimit, duke përfshirë të krishterët, hebrenjtë, myslimanët dhe pjesëtarët e feve të tjera, të dënonjë dhunën dhe diskriminimin për shkak të fesë dhe të përpiqen të parandalojnë dhe të mbrojnë nga sulmet e drejtuara ndaj personave ose grupeve për shkak të mendimit, ndërgjegjes, fesë ose besimit.
- Të promovojnë dialogun midis bashkësive fetare ose bestimare dhe organeve qeveritare, duke përfshirë, kur është e nevojshme, dialogun për çështjet që lidhen me përdorimin e vendeve të adhurimit dhe pronës fetare; dhe

55 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi nr. 9/09, Athinë, op. cit., shënimi 20.

56 Udhëzime për Edukatorët për Luftën kundër Intolerancës dhe Diskriminimit e Muslimanëve, op. cit., shënimi 14.

- Të miratojnë politika për të promovuar respekt dhe mbrojtje për vendet e adhurimit dhe vendet fetare, monumentet fetare, varrezat dhe faltoret kundër vandalizmit dhe shkatërrimit.⁵⁷

Bashkimi Evropian

Vendimi Kuadër i Bashkimit Evropian (BE) për Luftimin e Racizmit dhe Ksenofobisë⁵⁸ i detyron të gjitha shtetet anëtare të BE-së të rishikojnë legjislacionin e tyre dhe të sigurojnë pajtueshmëri me vendimin. Ai synon të harmonizojë ligjin penal në të gjithë BE-në dhe të sigurojë që shtetet të reagojnë me dënime efektive dhe proporcionale për krimet raciste dhe ksenofobike. Edhe pse pjesa më e madhe e vendimit ka të bëjë me krimet e gjuhës së urrejtjes, Neni 4 thotë se, në të gjitha llojet e tjera të krimeve, të gjitha shtetet duhet „të marrin masat e nevojshme për t’u siguruar që motivimi racist dhe ksenofobik të konsiderohet një rrethanë agravuese, ose që motivimi i tillë të mund të merret parasysh nga gjykatat në përcaktimin e dënimeve“. Neni 8 kërkon që fillimi i hetimeve ose ndjekjeve penale të veprave raciste dhe ksenofobike të mos varet nga raportimi ose akuza e viktimës. Kështu, ndërsa vendimi nuk kërkon miratimin e ndonjë legjislacioni specifik, ai kërkon që sistemet e drejtësisë penale të njohin dhe denoncojnë në mënyrë të përshtatshme krimet e motivuara nga paragjykimi, duke vënë përgjegjësinë mbi hetuesit dhe prokurorët për t’i çuar këto çështje në gjykatë.

Sa iu përket viktimave të krimeve të urrejtjes, Direktiva e Viktimave i sheh viktimat e krimet të urrejtjes si veçanërisht të rrezikuara nga viktimizimi sekondar ose i përsëritur.⁵⁹ „Ky rrezik duhet vlerësuar nga zbatimi i ligjit në fazën më të hershme të mundur të procedurës penale si pjesë e vlerësimit individual të viktimës. Masat e veçanta të mbrojtjes të ofruara në Direktivën e Viktimave duhen zbatuar sipas nevojës, krahas mbrojtjes që i jepet viktimës së çfarëdolloj krimi.“⁶⁰

E drejta ndërkombëtare të drejtave të njeriut, standardet e Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut përcakton të drejtat themelore të njeriut për mbrojtje të përgjithshme.⁶¹ Manifestime të ndryshme të intolerancës kundër myslimanëve sfidojnë, nënçmojnë ose shkelin parimet themelore të të drejtave të njeriut të

57 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi nr. 3/13, Kiev, *op. cit.*, shënimi 3.

58 Vendimi Kuadër i Këshillit, „Luftimi i disa formave dhe shprehjeve të racizmit dhe ksenofobisë me mjete të së drejtës penale, 28 nëntor 2008, 2008/913/JHA, <https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/combating-discrimination/racism-and-xenophobia/combating-racism-and-xenophobia_en>.

59 Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimet dhe zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA, <<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32012L0029>>.

60 Ndjekja e krimeve të urrejtjes: Një udhëzues praktik, (Varshavë: OSCE/ODIHR, 2014) <<https://www.osce.org/odihr/prose-cutorsguide?download=true>>.

61 Asambleja e Përgjithshme e KB, “Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut”, 10 dhjetor 1948, 217 A (III), <http://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/eng.pdf>.

përcaktuara në Deklaratë, si dinjiteti i të gjitha qenieve njerëzore, liria e fesë ose besimit, dhe mosdiskriminimi.

Sipas të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, qeveritë kanë detyrim të respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtat e njeriut. Këto detyrime i kanë marrë përsipër përmes ratifikimit të traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, siç është Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP)⁶² dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).⁶³ Detyrimi për të respektuar nënkupton që vetë shtetet nuk duhet të shkelin të drejtat e njeriut. Detyrimi për të mbrojtur do të thotë se shtetet kanë një detyrë pozitive për të mbrojtur individët dhe grupet nga abuzimet e të drejtave të njeriut. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që qeveritë duhet të ndërmarrin veprime pozitive për të lehtësuar sigurimin e të drejtave të njeriut për të gjithë.⁶⁴ Këto detyrime lidhen drejtpërdrejt me përgjegjësitë shtetërore në adresimin e intolerancës ndaj myslimanëve dhe antisemitizmit, si vetëm dy shembuj të urrejtjes ndaj bashkësive fetare.

Traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut përmbajnë një numër dispozitash që janë të rëndësishme për adresimin e intolerancës ndaj myslimanëve. Preambula e KNDCP, për shembull, thekson „dinjitetin e lindur të qenies njerëzore“ dhe të drejtën e „lirisë nga frika“, të cilat shkelen nga sulmet anti-myslimane.⁶⁵ KNDCP dhe KEDNJ inkuadrojnë parimin e mosdiskriminimit, duke përfshirë njohjen specifike të diskriminimit në bazë të fesë, që është një element kyç në adresimin e urrejtjes ndaj bashkësive fetare, si intoleranca ndaj myslimanëve ose antisemitizmi.

Si KNDCP (neni 6), ashtu edhe KEDNJ (neni 2) i detyrojnë shtetet të mbrojnë të drejtën e jetës. Këto dispozita janë veçanërisht të rëndësishme për llojet më të këqija të sulmeve anti-myslimane – ato që marrin jetën e individëve ose e kërcënojnë atë.

Shtetet gjithashtu kanë një detyrim sipas KNDCP (nenet 18 dhe 27) dhe KEDNJ (neni 9) për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtën e lirisë së fesë ose besimit për të gjithë. Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, organi mbikëqyrës i KNDCP, ka pohuar qartë se liria e fesë përfshin një gamë të gjerë aktesh, duke përfshirë lirinë për të ndërtuar vende adhurimi, për të përdorur formula rituale dhe objekte, për të shfaqur simbole, për të pasur festa dhe për të veshur rroba dalluese ose mbulesa koke.⁶⁶ Detyrimet e shteteve për të përmbushur këto të drejta, natyrisht, i referohen Islamit, si dhe feve të tjera.

62 Asambleja e Përgjithshme e KB, “Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike”, 16 dhjetor 1966, <<http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>>.

63 Këshilli i Evropës, “Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, 4 Nëntor 1950, <<http://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/0900001680063765>>.

64 Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, “E Drejta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut”, ohchr.org, <<http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/InternationalLaw.aspx>>.

65 Asambleja e Përgjithshme e KB, “Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike”, 16 dhjetor 1966, <<http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>>.

66 Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, “Komenti i Përgjithshëm 22, Neni 18 (sesioni i dyzet e tetë, 1993)”, umn.edu, <<http://hrlibrary.umn.edu/gencomm/hrcom22.htm>>.

Në Deklaratën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Intolerancës dhe të Diskriminimit Bazuar në Fe ose Besim, thuhet: “Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të luftuar intolerancën në bazë të fesë ose besimeve të tjera“, që nënkupton përgjegjësinë për të luftuar intolerancën ndaj myslimanëve.⁶⁷

Sipas ligjit ndërkombëtar, të drejtat për lirinë e fesë ose besimit dhe lirinë e shprehjes nuk japin të drejtën për të avokuar për besimet që nxisin diskriminimin, armiqësinë ose dhunën ndaj të tjerëve. Neni 19(2) i KNDCP-së thotë se ushtrimi i së drejtës për lirinë e shprehjes „mbart me vete detyra dhe përgjegjësi të veçanta“ dhe radhit respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve dhe mbrojtjen e sigurisë kombëtare, rendit publik ose shëndetit dhe moralit publik si baza legjitime për kufizimin e tij. “Liria e shprehjes ndikohet edhe nga Neni 20(2), i cili u kërkon palëve të ndalojnë avokimin e urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje të diskriminimit, armiqësisë ose dhunës.“ Pra, standardet ndërkombëtare nuk ndalojnë të gjithë avokimin e urrejtjes. Neni 4(a) i Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD) dhe Neni 20(2) i KNDCP u kërkojnë shteteve të kufizojnë avokimin e urrejtjes që nxit diskriminimin, armiqësinë ose dhunën. Për më tepër, Neni 4(a) i CERD-it gjithashtu ndalon thjesht „përhapjen e ideve të bazuara në superioritet racor ose urrejtje“ pa iu referuar nxitjes.⁶⁸

Komiteti i të Drejtave të Njeriut, në Komentin e tij të Përgjithshëm 22 mbi KNDCP, deklaroi se kjo dispozitë 20(2) është një mbrojtje e rëndësishme kundër shkeljes së të drejtave të pakicave fetare dhe kundër akteve të dhunës ose persekutimit të drejtuar ndaj këtyre grupeve.⁶⁹ Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara për Lirinë e Fesë ose Besimit vuri në dukje se „Shtetet kanë një detyrim sipas ligjit dhe jurisprudencës ndërkombëtare... që të garantojnë të drejtën e pakicave për lirinë e fesë dhe praktikimin e fesë, brenda kufijve ndërkombëtarë për të cilët kanë rënë dakord. Shteti mbetet përgjegjës edhe kur abuzimet kryhen ndaj pakicave nga entitete joshitetore si grupet ekstremiste. Shteteve gjithashtu u kërkohet të krijojnë kushte për promovimin e identitetit të pakicave, përfshirë identitetin fetar.“⁷⁰

„Plani i Veprimit i Rabatit për ndalimin e avokimit të urrejtjes kombëtare, racore ose fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë, nuk është një tekst i detyrueshëm, i cili megjithatë ka marrë miratim të gjerë nga bashkësia ndërkombëtare.“⁷¹

67 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rezoluta 36/55, „Deklarata e OKB-së mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Intolerancës dhe Diskriminimit të Bazuar në Religjion ose Besim“ paragrafi 4, 25 nëntor 1981, <<http://www.un.org/documents/fga/res/36/a36r055.htm>>. Si rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme, deklarata nuk është ligjërisht e detyrueshme për shtetet, edhe pse krijon një standard ndërkombëtar për veprim.

68 *Liria e fesë ose besimit dhe siguria: Udhëzime për politika*, (Varshavë: OSBE/ODIHR, 2019) <<https://www.osce.org/odihr/429389?download=true>>.download=true>.

69 Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, „Komenti i Përgjithshëm 22, Neni 18 (Sesioni i Dyzetë e tetë, 1993)“, umn.edu, <<http://hrlibrary.umn.edu/gencomm/hrcom22.htm>>.

70 Raportuesi Special i OKB-së për Lirinë e Fesë ose Besimit, „Raport i ndërmjetëm nga Raportuesi Special i Komisionit për të Drejtat e Njeriut mbi eliminimin e të gjitha formave të intolerancës dhe të diskriminimit të bazuar në fe ose besim“, 8 shtator 2000, paragrafi 138, f. 29, <<https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N00/637/11/PDF/N0063711.pdf?OpenElement>>.

71 *Liria e fesë ose besimit dhe siguria: Udhëzime për politika*, op. cit., note 69.

Ai rendit gjashtë faktorë për të përcaktuar nëse fjalimi përbën „nxitje për diskriminim, armiqësi ose dhunë“ dhe është mjaft serioz për të garantuar masa ligjore kufizuese.

Këto gjashtë kritere janë: konteksti, folësi (përfshirë qëndrimin e individit ose organizatës), qëllimi, përmbajtja ose forma, shtrirja e fjalimit dhe gjasat që të shkaktojë dëm.⁷²

Ndërsa e drejta për të pasur një mendim dhe liria për të pasur ose adoptuar një fe ose besim sipas zgjedhjes së dikujt nuk duhet t'i nënshtrohet asnjë kufizimi, manifestimet e besimeve fetare ose manifestimet e tjera mund të kufizohen nga shtetet pjesëmarrëse, por vetëm kur këto kufizime kanë një qëllim legjitim, p.sh. mbrojtja e sigurisë publike, rendit, shëndetit ose moralit, ose të drejtave dhe lirive të tjerëve. Këto kufizime, megjithatë, nuk duhen drejtuar kundër një feje të veçantë.⁷³ Kriteri i „qëllimit legjitim“ nënkupton që kufizimet mund të zbatohen vetëm për ato qëllime, për të cilat janë vendosur në dispozitat që kanë të bëjnë me lirinë e fesë ose besimit, dhe nuk lejohet që të zbatohen për arsye që nuk janë specifikuar në instrumentet ndërkombëtare, edhe nëse ato baza do të lejoheshin si kufizime për të drejta dhe liri të tjera themelore të njeriut. Në këtë drejtim, „siguria“ ose „siguria kombëtare“ nuk njihen nga e drejta ndërkombëtare si baza të lejueshme për kufizimin e manifestimit të lirisë së fesë ose besimit.⁷⁴

Sipas nenit 2.3 të KNDKP dhe nenit 13 të KEDNJ, shtetet gjithashtu janë të detyruara të sigurojnë që mjetet juridike efektive të jenë në dispozicion për njerëzit, të cilëve u shkelen të drejtat e njeriut. Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Shpërdorimit të Pushtetit thotë se viktimat e krimeve, që përfshijnë viktimat e krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve, duhet:

- Të trajtohen me dhembshuri dhe respekt për dinjitetin e tyre;
- Të kenë të drejtën për qasje në mekanizmat e drejtësisë dhe të drejtën për të marrë dëmshpërblim të menjëhershëm për dëmin që kanë pësuar, siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar; dhe
- T'u ofrohet ndihma e duhur gjatë gjithë procesit ligjor.⁷⁵

Përveç kësaj, Deklarata përcakton se viktimat duhet të marrin kompensim. Kur kompensimi nuk mund të merret në tërësi nga autori ose burime të tjera, shtetet duhet të përpiqen të sigurojnë kompensim financiar për viktimat dhe familjet e tyre. Deklarata përfshin dispozita të tjera të rëndësishme për adresimin e sulmeve anti-myslimane, duke vënë në dukje se:

⁷² *Ibid.*

⁷³ *Parandalimi i terrorizmit dhe kundërshtimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm: Një Qasje Policimi në Komunitet*, (Varshavë: OSBE/ODIHR, 2014) <<https://www.osce.org/atu/111438>>.

⁷⁴ *Ibid.*

⁷⁵ Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rezoluta 40/34, „Deklarata e parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit“, 29 nëntor 1985, <<http://www.un.org/documents/ga/res/40/a40r034.htm>>.

- Policia, drejtësia, shëndetësia, shërbimet sociale dhe personeli tjetër i interesuar duhet të trajnohen për t'u sensibilizuar rreth nevojave që kanë viktimat dhe udhëzimeve për të siguruar ndihmën e duhur dhe të shpejtë; dhe
- Gjatë ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës për viktimat, duhet t'i kushtohet vëmendje atyre që kanë nevoja të veçanta për shkak të natyrës së dëmit të shkaktuar, veçanërisht pasi në një krim të urrejtjes në shënjestër është një pjesë thelbësore e identitetit të personit.

Shtetet gjithashtu kanë përgjegjësi të caktuara në lidhje me parandalimin e krimit, edhe pse shumica e këtyre detyrimeve nuk ndodhen në traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit parashetrojnë rekomandime për parandalimin efektiv të krimit:

- „Është përgjegjësi e të gjitha niveleve të qeverisjes të krijojnë, mirëmbajnë dhe promovojnë një kontekst brenda të cilit institucionet përkatëse qeveritare dhe të gjitha segmentet e shoqërisë civile mund të luajnë më mirë rolin e tyre në parandalimin e krimeve.
- „Parandalimi i krimit” përfshin adresimin e frikës nga krimet;
- Përfshirja e bashkësisë dhe bashkëpunimi/partneritetet përfaqësojnë elemente të rëndësishme të konceptit të parandalimit të krimit;
- Strategjitë e parandalimit të krimit duhet të marrin në konsideratë nevojat e veçanta të shtresave të cënueshme të shoqërisë;
- Pjesëmarrja aktive e bashkësive dhe segmenteve të tjera të shoqërisë civile është një pjesë thelbësore e parandalimit efektiv të krimit;
- Strukturat qeveritare duhet të nxisin partneritete me organizatat joqeveritare për parandalimin e krimit; dhe
- Qeveritë duhet të promovojnë kapacitetin e bashkësive për t'iu përgjigjur nevojave të tyre.”⁷⁶

76 Rezoluta e ECOSOC 2002/13, “Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e krimit, Këshilli Ekonomik dhe Social”, 2002, aneks, <https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/crimeprevention/resolution_2002-13.pdf>.

II. PARIMET KRYESORE

Parimet e mëposhtme duhet të mbështesin përgjigjet qeveritare ndaj krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve dhe të kujdesen për nevojat në rritje të sigurisë së bashkësive myslimane. Qasjet e shteteve pjesëmarrëse ndaj krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve dhe sfidave të sigurisë duhet të jenë:

1. E BAZUAR NË TË DREJTA

Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut është një kornizë konceptuale e bazuar në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, e fokusuar drejt promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.⁷⁷

Sa i përket intolerancës ndaj myslimanëve, një qasje e bazuar në të drejta do të pranonte se manifestimet e një intolerance të tillë sfidojnë, nënçmojnë ose shkelin parimet themelore të të drejtave të njeriut, si dinjiteti i të gjitha qenieve njerëzore, liria e fesë ose besimit, mosdiskriminimi dhe e drejta për mjet efektiv ligjor. Trajtimi i intolerancës ndaj myslimanëve është pjesë integrale e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut të individëve dhe bashkësive të prekura.

Një qasje e bazuar në të drejta është gjithashtu një mënyrë themelore për të siguruar kohezionin social dhe integrimin e të gjitha bashkësive, disa prej të cilëve janë myslimane. Për më tepër, lidhjet midis viktimizimit të vazhdueshëm të myslimanëve dhe marginalizimit dhe pranueshmërisë së tyre nga grupet e tjera mund të rrisin ndarjen e mëtejshme. Një studim i kohëve të fundit i kryer në Francë tregon se myslimanët që i janë nënshtruar diskriminimit kanë më shumë gjasa të ndryshojnë sjelljen e tyre si përgjigje ndaj masave kundër terrorizmit. Tendenca më e madhe e myslimanëve për të ndryshuar sjelljen e tyre si përgjigje ndaj masave kundër terrorizmit nuk është për shkak të qenët myslimanë, por nga fakti se myslimanët janë në numër më të madh në mesin e viktimave të diskriminimit.⁷⁸

Zvogëlimi i krimeve të urrejtjes anti-myslimane dhe mbështetja e viktimave sa më shpejt të jetë e mundur, ndihmon në zbutjen e ndikimit mbi kohezionin social dhe, në disa raste, zvogëlon ndikueshmërinë nga retorika ekstremiste që funksionon me „ne kundër atyre“ dhe ushqehet nga cënueshmëria e viktimave.

Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut për të adresuar sfidat e sigurisë me të cilat përballen bashkësitë myslimane nga krimet e urrejtjes anti-myslimane, duhet të bazohet në dijeninë se shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë të detyruara që të mbrojnë bashkësitë fetare nga sulmet dhe t'u nënshtrohen dispozitave të ndryshme ligjore ndërkombëtare,

77 Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, „Pyetjet e bëra shpesh mbi një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut ndaj bashkëpunimit për zhvillim“, Nju Jork dhe Gjenevë, 2006, f.15, <<http://www.ohchr.org/Documents/Publications/FAQen.pdf>>.

78 Francesco Ragazzi, Stephan Davidshofer, Sarah Perret and Amal Tawfik, *The Effects of Counter-Terrorism and Counter-Radicalisation Policies on Muslim Populations in France: A Quantitative Study*; (Paris: CCLS, 2019).

siç u theksua më lart. Një qasje e tillë siguron që të gjitha masat e hartuara për të adresuar sulmet anti-myslimane të jenë plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe normat që lidhen me to.

Është e rëndësishme të theksohet se qeveritë dhe autoritetet policore kanë për detyrë të mbrojnë të drejtat e njeriut, qoftë përmes parandalimit të krimit ose adresimit të krimit. Kjo detyrë themelore duhet t'u shpjegohet dhe të kuptohet nga praktikuesit brenda institucioneve kryesore.

2. E FOKUSUAR TE VIKTIMA

Vendimi i Këshillit Ministror Nr. 9/09 për Luftimin e Krimeve të Urrejtjes pranoi se viktimat e krimeve të urrejtjes mund t'i përkasin si bashkësive pakicë, ashtu dhe atyre shumicë dhe këshillon:

Në bashkëpunim me aktorë relevantë dhe të besuar, të eksplorojnë mënyrat për t'iu siguruar viktimave të krimeve të urrejtjes qasje në këshillim, ndihmë ligjore dhe konsullore, si dhe qasje efektive në drejtësi; dhe

Të bëhen përpjekje për rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimit, veçanërisht me autoritetet policore, drejtuar bashkësive dhe grupeve relevante të shoqërisë civile që i ndihmojnë viktimat e krimeve të urrejtjes.“

Ndërsa shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë përqafuar zyrtarisht një qasje të fokusuar te viktimat për adresimin e krimit të urrejtjes dhe diskriminimit,⁷⁹ mbetet ende shumë për t'u bërë që ky zotim të bëhet realitet. Një qasje e fokusuar te viktimat e vendos viktimitë e një krimi anti-mysliman të urrejtjes në qendër, duke njohur perceptimin dhe përvojën e viktimës, si dhe duke iu dhënë rëndësi të veçantë të drejtave dhe nevojave të viktimës. Një qasje e fokusuar te viktimat mund:

- Të ndihmojë në mbështetjen e një bashkëpunimi më të madh me policinë përmes angazhimit më të mirë dhe ndërtimit të besimit me bashkësitë myslimane dhe rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat e viktimave;
- Të përmirësojë marrëdhëniet me bashkësinë myslimane dhe organizatat e bashkësisë për të rritur besimin sa i përket raportimit të sulmeve;
- T'i marrë në konsideratë ndjenjat, emocionet, mendimet dhe ndikimin mbi viktimitë;

79 Vendimi i Këshillit Ministror të OSBE-së 9/09, Athinë, *op. cit.*, shënimi 20.

- Të sigurohet që “zërat e viktimave” të dëgjoen në një kohë, e cila mund të jetë e frikshme dhe kaotike për shumë individë që kanë qenë në shënjestër, dhe t’i inkurajojë ata të raportojnë krimin;
- T’u ofrojë viktimave të krimeve të urrejtjes besimin për t’i raportuar incidentet, duke u mbështetur në mënyrë adekuate nga agjencitë dhe grupet e shoqërisë civile që punojnë si agjenci të raportimit të krimit të urrejtja nga palët e treta;
- Të lehtësojë pjesëmarrjen e viktimave në procedimet penale dhe të sigurojë që viktimave t’u ofrohet një informacion minimal në lidhje me të drejtat dhe procedurat, që nga kontakti i tyre i parë me një autoritet kompetent;
- Të sigurojë mbrojtje efektive për viktimat e krimeve të urrejtjes duke i shmangur viktimizimet dytësore, duke mbrojtur dinjitetin e viktimës dhe duke siguruar vlerësimin individual në kohë për të identifikuar mbrojtjen specifike; dhe
- Të punojë me autoritetet për të ofruar shërbime mbështetëse adekuate, të cilat synojnë nevojat e viktimës.

Ligji Kanadez i të Drejtave të Viktimave përkufizon viktimën si „një individ që ka pësuar dëm fizik ose emocional, dëmtim të pronës ose humbje ekonomike si rezultat i kryerjes së një veprë penale ose dyshimin për kryerjen e saj”.⁸⁰ I jep çdo viktimit të drejtën për informacion, mbrojtje, pjesëmarrje dhe të drejtën për të kërkuar kompensim. Pas gjetjes së fajit, viktimat kanë të drejtë të paraqesin një deklaratë për ndikimin e viktimës që gjykata ta marrë në konsideratë gjatë dënimit (neni 722 i Kodit Penal). Deklarata e ndikimit të viktimës është një deklaratë me shkrim e hartuar nga viktimat, ku ajo përshkruan dëmin fizik ose emocional, dëmtimin e pronës ose humbjen ekonomike që ai ose ajo ka pësuar si rezultat i veprës penale. Gjykata duhet të marrë parasysh deklaratën e ndikimit të viktimës kur dënon një shkelës.⁸¹

Qasja e fokusuar te viktimat thekson ndërgjegjësimin për ndikimin që krimet anti-muslimane të urrejtjes kanë tek individët dhe bashkësitë. Edhe nëse objektivi i një krimi anti-musliman të urrejtjes është prona, mesazhi i dërgohet të gjithë bashkësisë. Shtyllat e tjera të qasjes së fokusuar te viktimat përfshijnë marrjen parasysh të nevojave të çdo viktimë gjatë gjithë procesit të drejtësisë penale ose procedurave të tjera, si dhe njohjen e motivit të paragjyqimit nga autoritetet (p.sh., në regjistrimin e krimit të urrejtjes, në ngritjen e akuzave, në gjykim, në kompensim).

Një qasje me fokus viktimën nuk duhet të ndodhë vetëm kur merret raporti ose kur flitet për herë të parë me viktimën. Viktimat duhet të angazhohen gjatë gjithë hetimit dhe

80 Ligji kanadez i të drejtave të viktimave: <https://laws-lois.justice.gc.ca/eng/acts/C-23.7/page-1.html>

81 Qeveria e Kanadasë, Kodi Penal, shih: <https://laws-lois.justice.gc.ca/eng/acts/c-46/section-722-20150723.html>.

duhet të njoftohet në mënyrë të përditësuar dhe të mbështetet rregullisht, edhe pasi të jetë finalizuar rasti ose kur evidencimi të mos jetë i disponueshëm, pasi mbështetja e ofruar gjatë gjithë procesit mund të ndihmojë në krijimin e marrëdhënieve më të mira me bashkësinë dhe ta bëjë viktimën të ndihet plotësisht e mbështetur.

ODIHR Viktimat e krimit të urrejtjes në sistemin e drejtësisë penale: Një Udhëzues Praktik synon të mbështesë viktimat e krimit të urrejtjes gjatë gjithë procesit të drejtësisë penale. Udhëzuesi synon autoritetet e zbatimit të ligjit dhe ato gjyqësore, si dhe organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë ndihmë për viktimat e krimit. Udhëzuesi paraqet nevojat e viktimave të krimit të urrejtjes dhe prezanton parimet kryesore të cilave shtetet duhet t'u përmbahen kur kanë të bëjnë me viktima të tilla. Udhëzuesi kërkon t'i fuqizojë viktimat e krimit të urrejtjes dhe t'i bëjë ato një partner solid të autoriteteve të ndjekjes penale, duke respektuar dhe përmbushur nevojat e tyre për mbrojtje dhe mbështetje. ODIHR do të punojë me shtetet pjesëmarrëse dhe shoqërinë civile në mënyrë që të zbatohen rekomandimet e Udhëzuesit në të gjithë rajonin, për të mirën e viktimave të krimit të urrejtjes.⁸²

Kombet e Bashkuara kanë njohur gjithashtu rëndësinë e një qasjeje të fokusuar te viktimat për parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Për shembull, Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut ka rekomanduar zbatimin e dispozitave për të siguruar mjete efektive për viktimat, duke theksuar rëndësinë e krijimit të mekanizmave efektive të monitorimit për t'i kontrolluar shkeljet aktuale dhe potenciale.⁸³

Për më tepër, Direktiva e Bashkimit Evropian 2012 përcaktoi standarde minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, përfshirë krimin e urrejtjes, dhe urdhëron që viktimat e krimit duhen trajtuar me respekt dhe duhen pasur mbrojtjen e duhur, mbështetjen dhe qasjen në drejtësi.⁸⁴ Në thelb të kësaj Direktive ndodhet mirëqenia e viktimës; ajo qartësisht thekson se viktimat e krimeve të urrejtjes janë veçanërisht të cënueshme, duke deklaruar se nevojat e tyre duhen vlerësuar në bazë individuale dhe duhet t'i referohen në mënyrë efektive një ofruesi të specializuar të mbështetjes.

3. JODISKRIMINUESE

Sipas traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, shtetet janë të detyruara të sigurojnë që të gjithë individët brenda territoreve të tyre dhe në varësi të juridiksioneve të tyre

82 *Viktimat e krimit të urrejtjes në sistemin e drejtësisë penale: një udhëzues praktik*, do të publikohet në fillim të vitit 2020 nga OSBE/ODIHR, <<https://www.osce.org/odihr>>.

83 Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, „Roli i parandalimit në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut“, A/HRC/30/20, 16 korrik 2015, <<https://digitallibrary.un.org/record/801293?ln=en>>.

84 „Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 tetorit 2012 për vendosjen e standardeve minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit dhe zëvendësimin e Vendimit Kua-dër të Këshillit 2001/220/JHA“, 25 tetor 2012, <<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX-%3A32012L0029>>.

Duhet t'i kushtohet vëmendje ndërseksionalitetit. Prandaj, duhet të bëhen përpjekje për të arritur si tek gratë ashtu dhe tek burrat në bashkësi dhe te myslimanët që përfaqësojnë aspekte të ndërlidhura të bashkësive të shumta – si myslimanët që identifikohen si LGBTI ose kanë ndonjë aftësi të kufizuar.

5. E PËRBASHKËT

Pika fillestare për çdo përgjigje qeveritare ose të shoqërisë civile ndaj krimit të urrejtjes anti-muslimane është pranimi se ky problem është një shqetësim i përbashkët. Ndërsa ndikimi më i madh ndihet në bashkësitë myslimane, problemi duhet të njihet dhe të adresohet nga shoqëritë në tërësi, dhe jo thjesht nga bashkësia e synuar. Adresimi i intolerancës kundër myslimanëve gjithashtu ndikon drejtpërdrejt në kohezionin social brenda shteteve dhe redukon narrativat ekstremiste. Ndikime më të gjera sociale mund të ndodhin nëse urrejtja anti-muslimane nuk monitorohet, sfidohet dhe luftohet përmes edukimit, përpjekjeve të policisë dhe metodave të tjera.

Adresimi i incidenteve dhe krimeve të urrejtjes anti-muslimane në të gjitha manifestimet e ndryshme është, në thelb, një çështje e të drejtave të njeriut. Ndërtimi i koalicioneve ndërmjet institucioneve dhe grupeve të shoqërisë civile mund të ndihmojë në luftimin e krimit të urrejtjes anti-muslimane, bashkë me forma të tjera të racizmit, fanatizmit dhe paragjykimëve. Për shembull, organizatat që punojnë për të adresuar intolerancën ndaj myslimanëve, mund të konsiderojnë partneritetet dhe koalicionet me organizatat e grave, grupet që luftojnë racizmin, antisemitizmin dhe ata që punojnë për LGBTI ose të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Një shembull është një projekt i filluar në vitin 2010 nga Këshilli Ndërfetar në Bosnjë dhe Hercegovinë për “Monitorimin e sulmeve ndaj vendeve fetare dhe vendeve të tjera me rëndësi për kishat dhe bashkësitë fetare në Bosnjë dhe Hercegovinë, ose Mbrojtja e vendeve të shenjta”. Zhvilluar në kuadrin e një projekti më të madh që kërkon një deklaratë apo rezolutë të OKB- së për të mbrojtur vendet e shenjta anembanë botës, objektivi kryesor është të përmirësojë mbrojtjen e vendeve fetare apo të shenjta dhe vendeve të tjera me interes për bashkësitë fetare të të gjitha besimeve në Bosnjë dhe Hercegovinë. Projekti regjistron sulmet në vendet fetare dhe analizon informacionin në lidhje me metodën e sulmeve, motivin e sulmeve, identifikimin e autorëve, fushat e sulmeve, etj. Pas analizës së sulmeve të vendeve fetare çdo periudhë raportuese, projekti bën propozime për autoritetet kompetente për të përmirësuar mbrojtjen e vendeve fetare në zona të veçanta. Përveç kësaj, pas çdo sulmi, përfaqësues të bashkësive të ndryshme fetare lokale mblidhen së bashku, organizojnë një konferencë për shtyp dhe të bashkuar dënojnë sulmin.⁸⁸

88 Monitorimi i sulmeve ndaj objekteve fetare dhe vendeve të tjera me rëndësi për kishat dhe komunitetet fetare në Bosnje dhe Hercegovinë, <<https://www.mrv.ba/lat/clanci/projekti/monitoring-napada-na-vjerske-objekte>>.

6. BASHKËPUNUESE

Parimi i partneritetit është një mjet jetik në adresimin e paragjytimeve dhe përgjigjeve ndaj krimeve të urrejtjes. Palët e ndryshme të interesit, veçanërisht ekspertët e qeverisë dhe të bashkësisë myslimane, mund të zhvillojnë dhe të ofrojnë ekspertizë plotësuese për të trajtuar kolektivisht problemin nga këndvështrime të ndryshme, duke marrë parasysh faktorët vendor, kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Vendosja e kanaleve të komunikimit, koordinimit dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile duhet të jetë diçka thelbësore për çdo politikë qeveritare të krijuar për t'iu përgjigjur krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve dhe për t'i adresuar nevojat dhe shqetësimet e sigurisë të bashkësisë myslimane.

Si policia, ashtu edhe organizatat e bashkësisë mund të krijojnë partneritete të rëndësishme duke njohur më mirë punën e njëri-tjetrit. Është gjithashtu e rëndësishme që palët kryesore të interesit të punojnë së bashku për të krijuar një kuptim inteligjent gjithëpërfshirës mbi atë se ku, kur dhe si ndodhin krimet. Kjo mund të bëhet vetëm nëse të gjitha palët punojnë së bashku për të shkëmbyer informacione me njëra-tjetrën dhe për të ndihmuar në ndërtimin e një pasqyrë të inteligjencës, nga e cila mund të përfitojnë të gjitha palët e interesuara.

7. EMPATIKE

Një përgjigje empatike ndaj krimeve anti-myslimane të urrejtjes njihet cenueshmërinë e individëve dhe bashkësisë, duke vlerësuar përvojën e tyre si viktime. Një rrugë që duket e sigurt për një person jomysliman, mund të jetë sfidë për sigurinë e një personi që perceptohet si mysliman.

Empatia nënkupton pranimin dhe dëshirën për të kuptuar ndjenjën e cenueshmërisë që kanë myslimanët pas sulmeve anti-myslimane, veçanërisht ndjenjat e grave dhe të rinjve myslimanë. Sulme të tilla kanë një ndikim emocional mbi viktimat, familjet dhe bashkësitë e tyre. Andaj, autoritetet dhe zyrtarët qeveritarë duhet të marrin parasysh perspektivat e viktimave dhe të kuptojnë se një krim anti-mysliman i urrejtjes mund të jetë një prej disa mënyrave, me të cilat viktimat është përballur me intolerancën dhe diskriminimin anti-mysliman.

Masat e trajnimit dhe ndërgjegjësimit për zyrtarët qeveritarë janë mjete për të mësuar rreth ndikimeve individuale dhe kolektive që krimi i urrejtjes anti-myslimane ka në jetën e të prekurve. Gjithashtu mundëson një rritje në mbledhjen e provave që kanë të bëjnë me ndikimin e viktimës, që mund të përdoren në çdo ndjekje penale. Sigurisht, trajnimi duhet të zhvillohet me qëllim njohjen dhe rritjen e ndërgjegjësimit për krimin e urrejtjes anti-myslimane, duke pajisur zyrtarët qeveritarë me një kuptim më të mirë të diversitetit të bashkësisë dhe duke i mbështetur ata më mirë në kryerjen e detyrave të tyre.

8. E NDJESHME NDAJ GJINISË

Masat e qeverisë për të adresuar krimet e urrejtjes kundër myslimanëve dhe për të identifikuar nevojat e sigurisë së bashkësive myslimane, duhet të jenë të vetëdijshme për gjininë dhe të ndjeshme ndaj saj. Të gjitha incidentet e krimit të urrejtjes duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese, pavarësisht seksit/gjinisë së viktimës. Konsiderimi i implikimeve të masave qeveritare dhe përshtatja e duhur e tyre në një mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë, do të forconte përgjigjet ndaj krimeve të urrejtjes që kanë në fokus viktimën.

Viktimat e krimeve të urrejtjes, përfshirë edhe ato të bashkësive myslimane, përballen me forma të ndryshme të marginalizimit dhe e konsiderojnë veten e tyre si anëtarë të grupeve të ndryshme. Për këtë arsye, qeveritë duhet të kujtojnë se identitetet përbëhen nga elemente të ndryshme kur shqyrtojnë masat dhe politikat për të adresuar krimin e urrejtjes ndaj një bashkësie të caktuar dhe anëtarëve të saj. Ndërkohë që një masë mund të jetë e dobishme për dikë në bazë të fesë, ajo mund të jetë e dëmshme në bazë të identitetit gjinor. Kjo lloj dileme kërkon një qasje holistike dhe ndërseksionale në adresimin e krimeve të urrejtjes.

9. TRANSPARENTE

Qeveritë duhet të jenë transparente për mënyrën se si synojnë të adresojnë intolerancën, diskriminimin dhe krimet e urrejtjes kundër myslimanëve. Masat duhet të marrin parasysh nevojat e sigurisë të të gjitha bashkësive, përfshirë ato të bashkësive myslimane, që mund të jenë subjekt i krimeve të urrejtjes anti-muslimane për një periudhë të gjatë kohore.

Për shembull, një incident i rëndë në Mbretërinë e Bashkuar me kamera të instaluar në një lagje myslimane:

Në prill të vitit 2010 u instaluan 218 kamera në zonat e Birminghamit me shumicë myslimane. Kamerat në Washwood Heath dhe Sparkbrook, disa prej të cilave ishin të fshehura, u paguan me 3 milionë funta të fondeve qeveritare të ndara për luftën kundër terrorizmit. Një raport i pavarur ishte shumë kritik për skemën e Project Champion dhe policinë West Midlands.

Burimet e policisë thanë se iniciativa, me emrin e koduar Project Champion, që synon të mbikëqyrë një popullsi që konsiderohet “e rrezikuar” nga ekstremizmi, është e para e këtij lloji në Mbretërinë e Bashkuar.

Policia ra dakord në dhjetor se kamerat duheshin hequr dhe tha se asnjëra prej 218 kamerave nuk ishte përdorur ndonjëherë.⁸⁹

Një praktikë e mirë mund të jetë ndarja e planeve të veprimit dhe raporteve përkatëse kombëtare, rajonale ose lokale me bashkësitë e prekura dhe publikun e gjerë. Mundësi- mi që të dhënat e krimit të urrejtjes të jenë të aksesueshme për publikun është një formë tjetër e transparencës.

Partneritetet që përfshijnë konsultime të rregullta midis policisë, agjencive të tjera dhe bashkësive myslimane (veçanërisht në nivel lokal) i mbajnë të informuara palët e inter- suara relevante dhe bashkësitë e prekura dhe sigurojnë transparencën e aktiviteteve. Kjo mund të shkojë deri te ndarja e vlerësimeve relevante të kërcënimeve dhe madje edhe deri te marrëveshjet për ndarjen e të dhënave.

Në Greqi, me mbështetjen e ODIHR-it, autoritetet hartuan një marrëveshje për përmirë- simin e bashkëpunimit ndërinstitucional për regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave për krimet raciste. Në këtë diskutim morën pjesë disa institucione, duke përfshirë Policinë Helenike, Ministrinë e Mbrojtjes së Qytetarëve, Ministrinë e Transportit dhe Politikës së Ishujve, Ministrinë e Drejtësisë, Transparencës dhe të Drejtave të Njeriut dhe Prokurorin e Gjykatës së Lartë. Në të njëjtën kohë, Marrëveshja për Bashkëpunimin Ndërinstitucio- nal për Adresimin e Krimeve Raciste në Greqi urdhëron që koalicioni i shoqërisë civile, Rrjeti i Regjistrimit të Dhunës Raciste, të ndajë të dhëna për krimet raciste me autoritetet kombëtare përmes raporteve të tij kombëtare dhe sipas rregullave të tij të funksionimit.⁹⁰

89 “Kamerat ‘spiune’ të Projektit Kampion në Birmingham po hiqen”, lajmet e BBC: <<https://www.bbc.com/news/uk-england-birmingham-13331161>>; për një analizë më të thellë konsultoni: ‘Një mungesë katastrofike kuresh- tje: Një studim kritik i ndikimit dhe narrativës së projektit të mbikëqyrjes së Kampion në Birmingham, <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.835.7387&rep=rep1&type=pdf>

90 Marrëveshja mbi bashkëpunimin ndërinstitucional për trajtimin e krimeve raciste në Greqi, <<https://www.osce.org/odihr/402260?download=true>>.

Në përgjithësi, konsultimet dhe bashkëpunimi u ofrojnë palëve të interesuara dhe publikut të gjerë një platformë për të ofruar komente dhe për të përmirësuar përgjigjet ndaj krimeve të urrejtjes. Puna transparente mund të rrisë raportimin e krimit të urrejtjes, të përmirësojë besimin në institucionet publike, si dhe të adresojë ose të luftojë çdo keqkuptim.

10. HOLISTIKE

Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së e kanë njohur rëndësinë e një qasjeje gjithëpërfshirëse për adresimin e intolerancës, përfshirë atë kundër myslimanëve.⁹¹ Nisur nga kjo, kujdesi për nevojat e sigurisë së bashkësive myslimane dhe adresimi i krimit të urrejtjes anti-myslimane është vetëm një pjesë e zgjidhjes. Intoleranca ndaj myslimanëve është një problem kompleks që kërkon përgjigje holistike dhe gjithëpërfshirëse, e cila duhet të jetë një model në adresimin e të gjitha formave të intolerancës, paragjykitimit dhe urrejtjes. Fokusi në krimin e urrejtjes anti-myslimane nuk është braktisja ose privilegjimi i një forme të urrejtjes; një politikë efektive ndaj këtij manifestimi të urrejtjes mund të zbatohet edhe për krime të tjera të urrejtjes. Përgjigjet ndaj elementeve të ndryshme të krimeve të urrejtjes mund të jenë të fuqishme, vetëm atëherë kur përgjigja e përgjithshme e qeverisë ndaj të gjitha krimeve të urrejtjes është e fuqishme. Një qasje e tillë holistike duhet të adresojë të gjitha elementet e përbashkëta të krimit të urrejtjes dhe gjithashtu të pranojë dhe adresojë specifikat e elementeve të ndryshme, duke përfshirë krimin e urrejtjes anti-myslimane.

Pasqyrimi i diversitetit të bashkësisë të forca policore është një element i rëndësishëm në adresimin e krimit të urrejtjes anti-myslimane. Inteligjenca dhe bashkëpunimi i bashkësisë janë të rëndësishme, jo vetëm në adresimin e krimit të urrejtjes anti-myslimane, por edhe të krimit në përgjithësi. Prandaj, një përfaqësues i forcave policore të bashkësive të cilave u shërben, ndihmon në mbështetjen e përpjekjeve për të përmirësuar angazhimin dhe mirëkuptimin midis bashkësive dhe policisë.

91 Këshilli Ministror i OSBE-së, Vendimi Nr. 10/07, Madrid, *op. cit.*, shënimi 9.

PJESA E TRETË:

Reagimi ndaj krimeve të urrejtjes
anti-muslimane dhe sfidat e sigurisë
së bashkësive muslimane

Ky segment ofron zgjidhje praktike që janë të rëndësishme për disa grupe çështjesh të ndërlidhura dhe të mbivendosura, por megjithatë të veçanta. Disa nga hapat praktikë të mëposhtëm do të ndihmojnë në adresimin e çdo manifestimi të intolerancës ndaj myslimanëve, ndërsa disa të tjerë kanë të bëjnë në mënyrë specifike me përgjigjet e drejtësisë penale ndaj krimeve të urrejtjes dhe disa adresojnë sfidat e sigurisë, siç ato perceptohen dhe përjetojnë nga bashkësitë dhe organizatat myslimane.

HAPA PRAKTIKË

1. PRANIMI I PROBLEMIT

Pika fillestare në trajtimin e krimit të urrejtjes anti-myslimane është pranimi se kjo çështje përbën kërcënim për sigurinë dhe stabilitetin e viktimave dhe ka ndikime më të gjera mbi kohezionin dhe kërkon përgjigje të menjëhershme. Një pranim i tillë vjen nga të kuptuarit e mënyrave të shumta në të cilat shfaqen krimet e urrejtjes anti-myslimane dhe kërcënimet e sigurisë. Qarqet akademike dhe hulumtuesit luajnë rolin e tyre duke ofruar ekspertizë dhe këshilla në lidhje me manifestimet e ndryshme të intolerancës kundër myslimanëve, si dhe mënyra për t'iu përgjigjur atyre. Njohja zyrtare e problemit i bën qeveritë të shohin se përgjegjësia për ta menaxhuar këtë çështje nuk bie vetëm mbi shpinën e atyre që janë prekur më së shumti. Kjo pastaj do t'i inkurajojë bashkësitë myslimane që t'i shprehin shqetësimet e tyre.

Rekomandim:

Edhe pse qeveritë mund ta njohin problemin, shpeshherë ato nuk kanë të dhëna. Nevoja për të monitoruar dhe matur nivelet e intolerancës ndaj myslimanëve mund të sigurojë një bazë efektive, mbi të cilën do të mund të krijohen struktura për të sfiduar urrejtjen, fanatizmin dhe paragjykimin. Sfidimi i intolerancës ndaj myslimanëve forcon përpjekjen më të gjerë kombëtare për të adresuar të gjitha format e krimit të urrejtjes dhe për të siguruar një sistem efektiv matës dhe monitorues, duke u siguruar shteteve aftësinë për të zbatuar sisteme efektive kombëtare të monitorimit. Kjo siguron në vazhdim që shtetet të mund të jenë proaktive dhe reaktive në përgjigjen ndaj krimit të urrejtjes dhe në monitorimin e çështjeve, ndërsa policia dhe autoritetet policore mund të mobilizohen në pika specifike atëherë kur është e nevojshme.

Prandaj, financimi i duhur për një sistem kombëtar monitorimi që mbështet viktimat e veprave kundër myslimanëve është pjesë thelbësore e një strategjie për mbështetjen e viktimave, matjen e krimeve të urrejtjes dhe zvogëlimin e krimeve të urrejtjes me kalimin e kohës. Pa mbështetje të centralizuar, nuk mund të mbahet një sistem efektiv i mbështetjes dhe monitorimit të viktimave.

Shembull i praktikës së mirë:

Plani Kombëtar i Qeverisë Suedeze për të Luftuar Racizmin, Format e Ngjashme të Armiqësisë dhe Krimet e Urrejtjes rendit disa aktivitete për të sfiduar intolerancën ndaj myslimanëve. Këto përfshijnë një program edukativ përmes Living History Forum që angazhon të rinjtë për t'i shikuar çështjet historike të racizmit duke hapur një dialog me ta për të diskutuar mendimet dhe besimet e tyre. Kjo përputhet me iniciativat e ndërgjegjësimit të Agjencisë Kombëtare Suedeze për Arsim dhe i ndihmoi të rinjtë të reflektojnë, të flasin dhe të angazhohen me çështje të tilla.⁹²

Qeveria ka siguruar fonde për projekte që adresojnë këto pesë fusha strategjike dhe plani i veprimit gjithashtu pranon se mbështetja e Qeverisë Suedeze do të nxisë, „Më shumë njohuri, edukim dhe hulumtim, koordinim dhe monitorim më të mirë, shoqëria civile: rritje e mbështetjes dhe dialogut, fuqizim i punës parandaluese në internet dhe një gjyqësor më aktiv.“⁹³

Pranimi se krimi nga urrejtja anti-muslimane është një sfidë mund të shërbejë gjithashtu si bazë për një rishikim dhe vlerësim kritik të mekanizmave ekzistues të parandalimit dhe reagimit. Matja, monitorimi dhe mbështetja e viktimave për të pasur qasje në drejtësi ose edhe për të përmirësuar përvojat e tyre siguron që viktimat të ndiejnë se zërat e tyre janë dëgjuar dhe përvojat e tyre janë njohur. Kjo ndodh vetëm atëherë kur individët të cilët kanë qenë të targetuar për shkak të intolerancës ndaj myslimanëve mund të marrin mbështetje, këshilla dhe qasje në një shërbim për avokim, i cili gjithashtu mund të regjistrojë dhe monitorojnë rastet e intolerancës ndaj myslimanëve. Meqenëse autoritetet policore janë, në fund të fundit, të vetmet që hetojnë këto çështje, është shumë e rëndësishme që viktimat e incidenteve dhe krimeve të urrejtjes të marrin një shërbim që është mbështetës dhe që regjistron dhe komunikon rregullisht me to. Edhe nëse incidenti nuk kalon kufijtë penalë brenda shteteve të caktuara, viktimat duhet të informohen sa më shpejt që të jetë e mundur për rezultatet, në mënyrë që të mund të marrin vendime të informuara.

Prandaj, është e rëndësishme të theksohet se adresimi i intolerancës ndaj myslimanëve, ashtu si menaxhimi i antisemitizmit ose ndonjë problemi tjetër të ngjashëm, do të thotë pranimi i çështjes, marrja e një qasje me fokus te viktimat, demonstrimi i rezultateve (përfshirë në nivel politik) dhe sigurimi i kornizave ligjore dhe shoqërore për një urrejtje dhe intolerancë të tillë që ajo të sfidohet dhe luftohet kudo që gjendet. Ndërsa oficeri i policisë në vijë të parë ka të ngjarë të përgjigjet i pari ndaj një sulmi anti-musliman, një përgjigje

92 *Një qasje gjithëpërfshirëse për të luftuar racizmin dhe krimin e urrejtjes: Plani kombëtar për të luftuar racizmin, forma të ngjashme të armiqësisë dhe krimin të urrejtjes*, (Stokholm: Zyrat Qeveritare të Suedisë, 2017), <<http://www.regeringen.se/492382/contentassets/173251a50a5e4798bcafc15ba871a411/a-comprehensive-approach-to-combat-racism-and-hate-crime>>.

93 Për më tepër, shiko: Plani kombëtar për të luftuar racizmin, format e ngjashme të armiqësisë dhe krimet e urrejtjes në internet, <<http://www.regeringen.se/pressmeddelanden/2016/11/nationell-plan-for-att-motverka-rasism-liknande-former-av-fientlighet-och-hatbrott-pa-natet/>>.

efektive dhe holistike do të kërkonte angazhim nga oficerët e lartë, nëpunësit civilë dhe udhëheqësit politikë për të dërguar një mesazh të fortë që urrejtja nuk do të tolerohet.

Në disa shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, deputetët kanë vendosur sfidat lidhur me intolerancën ndaj myslimanëve në axhendën kombëtare, përfshirë këtu shqetësimet që lidhen me sigurinë. Një numër i paktë vendesh e kanë bërë këtë çështje prioritet, me anë të krijimit të grupeve ndërqeveritare të punës për të adresuar aspekte të ndryshme të çështjes, për të siguruar koordinim dhe për të ndërtuar besim mes bashkësive të ndryshme myslimane, përfaqësuesve politikë dhe nëpunësve civilë. Disa vende krijojnë forume të përhershme që përfshijnë zyrtarë qeveritarë, shërbimet e sigurisë, si dhe shoqërinë civile dhe udhëheqësit e bashkësive, për të identifikuar shqetësimet që lidhen me intolerancën ndaj myslimanëve. Çdo opsion ka përfitime, megjithëse është e rëndësishme të theksohet se vullneti dhe angazhimi politik është thelbësor në nivel kombëtar për t'iu kundërvënë urrejtjes dhe intolerancës së tillë.

Ekzistojnë metoda të ndryshme që qeveritë dhe parlamentarët të pranojnë sfidat që lidhen me intolerancën ndaj myslimanëve. Këto përfshijnë:

- Duke demonstruar se jotoleranca ndaj myslimanëve mund të shprehet në mënyra të subtile dhe të koduara dhe duke siguruar që manifestime të tilla të njihen, ekspozohen dhe dënohen;
- Duke kërkuar mendime dhe rekomandime eksperte nga akademikë dhe hulumtues, për të përmirësuar të kuptuarit e problemit nga ana e qeverisë, online dhe offline;
- Duke pranuar se bashkësitë myslimane janë në shënjestër nga ekstremistët ose terroristët e dhunshëm dhe duke i përfshirë bashkësitë dhe institucionet myslimane në listat e objektivave të lehtë potencialë të ekstremistëve të dhunshëm ose sulmeve terroriste;
- Duke krijuar një kuadër ligjor që i mundëson qeverisë, në bashkëpunim me bashkësitë myslimane, të trajtojë në mënyrë efektive sfidat e sigurisë me të cilat përballen bashkësitë myslimane brenda një kuadri më të gjerë çështjesh që mund t'i ndikojnë këto komunitete;
- Angazhimi me mediat për t'i luftuar narrativet e paragjyqimeve dhe për të lëshuar deklarata të forta për dënimin e incidenteve dhe krimeve të urrejtjes; dhe
- Përdorimi i mediave sociale për të dërguar mesazhe të qarta mbështetjeje për bashkësinë myslimane dhe për të adresuar ndjenjat anti-myslimane në internet, duke përdorur kanale zyrtare.

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

Të sigurohen që bashkësitë myslimane nuk diskriminohen në lidhje me mënyrën se si ata e organizojnë dhe e praktikojnë fenë e tyre;

T'i kushtojnë vëmendje të veçantë situatës së grave myslimane, të cilat mund të vuajnë si nga diskriminimi ndaj grave në përgjithësi, ashtu edhe nga diskriminimi ndaj myslimanëve; dhe

Të nxisin debat brenda profesioneve mediatike dhe reklamuese mbi imazhin që përdoret për të paraqitur Islamin dhe bashkësitë myslimane, dhe mbi përgjegjësinë e tyre për të shmangur vazhdimin e paragjytimeve dhe informacionit të njëanshëm.⁹⁴

Një mënyrë tjetër që qeveritë mund të përdorin për të bërë të ditur pranimin e tyre se institucionet dhe bashkësitë myslimane janë shënjestër e sulmeve dhe kanë nevojë për mbrojtje, është angazhimi në një dialog me bashkësitë myslimane lidhur me kërcënimet e sigurisë dhe sfidat me të cilat ata përballen.

“Shqetësohem për faktin se urrejtja ndaj myslimanëve është një fenomen global, duke përfshirë Bashkimin Evropian. Agjencia e të Drejtave Themelore e di këtë gjë. (...) Ne e dimë se një në tre myslimanë është përballur së fundi me një akt diskriminimi. E dimë se një në katër myslimanë është përballur së fundi me një akt ngacmimi, qoftë në internet apo në realitetin fizik. Gjithashtu e dimë se myslimanët investojnë më shumë besim në institucionet e shteteve tona sesa popullata e përgjithshme.“ – **Drejtori i Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore Michael O’Flaherty**, 2019.⁹⁵

2. RRITJA E VETËDIJES

Në afat të gjatë, krimet e urrejtjes kundër myslimanëve dhe nevojat e sigurisë së bashkësive myslimane do të trajtohen në mënyrë efektive vetëm nëse racizmi dhe paragjykimet themelore që nxisin sulme ndaj bashkësive dhe vendeve myslimane trajtohen në mënyrë holistike. Kjo kërkon një fokus jo vetëm mbi efektet e paragjyqimit anti-mysliman, por edhe mbi dijeninë për atë se si autorët e krimit ekspozohen ndaj intolerancës kundër myslimanëve dhe se pse pajtohen me të. Ndërgjegjësimi rreth mekanizmave dhe

94 Rekomandimi i politikës së përgjithshme Nr. 5: „Lufta kundër intolerancës dhe diskriminimit kundër myslimanëve“, Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), <https://www.coe.int/t/dghl/monitoring/ecri/activities/GPR/EN/Recommendation_N5/Recommendation_5_en.asp>.

95 Agjencia e të Drejtave Themelore të BE-së, Drejtori Michael O’Flaherty, video blogu i Drejtorit, <<https://youtu.be/7zYMlyttjQo>>.

narrativave themelore të urrejtjes që shkaktojnë një sjellje të tillë është, pra, një element kyç i adresimit të sulmeve anti-muslimane.

Ndërgjegjësimi mund të marrë shumë forma. Programet arsimore mund të synojnë të rinjtë, zyrtarët qeveritarë dhe publikun e gjerë për të ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë, zbërthejnë dhe refuzojnë paragjykimet anti-muslimane. Për më tepër, rritja e angazhimit në media sociale nga grupmoshat më të reja brenda bashkësive do të thotë që online fushatat për promovim të informacionit mund të shpërndahen gjerësisht përmes rrjeteve dhe grupeve në internet të krijuara nga muslimanët e rinj. Angazhimi me këto grupe është gjithashtu thelbësor për të reduktuar tensionet sociale dhe për të luftuar dezinformimin. Në një nivel më të lartë, seancat parlamentare mbi paragjykimet anti-muslimane mund të rrisin ndërgjegjësimin duke e vënë problemin në axhendën kombëtare.

Rekomandim:

Zhvillimi i programeve që synojnë zyrtarët qeveritarë, të rinjtë dhe publikun e gjerë për të rritur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit e intolerancës ndaj muslimanëve. Këto mund të jenë programe që lidhin grupe të ndryshme të bashkësisë me muslimanët për të punuar në projekte sociale me qëllim fuqizimin e të drejtave të njeriut dhe angazhimin kolektiv me audienca më të gjera përmes përdorimit të historisë, programeve rinore dhe pikave të angazhimit kulturor.

Mundësoni një prezencë zyrtare të policisë ose qeverisë në internet që ndihmon në adresimin e ndjenjave anti-muslimane, për t'i luftuar lajmet e rreme që krijojnë frikë dhe paragjykim ndaj bashkësisë muslimane, duke i mbështetur dhe siguruar muslimanët në internet.

Shembull i praktikës së mirë:

“Fqinjët e rinj” është një projekt që nxjerr në pah kontributet pozitive sociale dhe ekonomike që bëhen nga emigrantët dhe refugjatët në bashkësitë në të gjithë Evropën. Duke promovuar pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në prodhimin mediatic dhe dinamikën ndërkulturore, ky projekt synon të nxisë tolerancën dhe pranimin për emigrantët dhe refugjatët në vendet anëtare të BE-së. Projekti zbatohet nga mediat e shërbimit publik, nga nëntë vende të ndryshme të BE-së në të gjithë Evropën (Belgjika, Kroacia, Republika Çeke, Gjermania, Italia, Portugalia, Holanda, Sllovenia dhe Spanja) së bashku me mediat e bashkësisë dhe organizatat e shoqërisë civile.⁹⁶

96 Për të mësuar më shumë rreth projektit Fqinjët e rinj, vizitoni faqen e tij në: <<https://newneighbours.eu/about-the-project/>>.

Mediat mund të jenë partnerë kryesorë në rritjen e ndërgjegjësimit për paragjykimet anti-myslimane. Mediat janë të vendosura në mënyrë unike për të informuar dhe mobilizuar publikun e gjerë mbi mbizotërimin e intolerancës ndaj myslimanëve dhe ndikimin e saj në bashkësitë myslimane. Partneriteti strategjik me mediat në përpjekjet e qeverisë për të kundërshtuar dhe dënuar intolerancën ndaj myslimanëve mund të sjellë përfitime të konsiderueshme në drejtim të ndërgjegjësimit publik për problemin.

Për më tepër, programet e synuara të trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve, si dhe tryezat e rrumbullakëta të organizuara në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, mund të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit.

Fushatat dhe masat ndërgjegjësuese mund të synojnë:

- Sigurim të kuptimit të tipareve specifike të manifestimeve bashkëkohore të paragjykimeve anti-myslimane. Ndërsa masat e ndërgjegjësimit që synojnë oficerët e policisë mund të përqendrohen në aspekte specifike të identifikimit dhe adresimit të krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve, ato që synojnë publikun e gjerë mund të përqendrohen në spektrin e gjerë të manifestimeve të paragjykimeve anti-myslimane;
- Përcjellje të mesazhin se krimet e urrejtjes kundër myslimanëve nuk ndodhin në vakum. Në vend të kësaj, zyrtarët e qeverisë duhet të komunikojnë se tensionet politike dhe sociale, si dhe ndjenjat anti-myslimane (online dhe offline) në diskursin publik të politikanëve dhe opinionistëve, në vendin e punës dhe në situatat e përditshme janë prapavijë e shumë sulmeve. Një mesazh kyç mund të jetë që të gjithë mund të kontribuojnë në ndërtimin e një klime, për të siguruar që shprehjet anti-myslimane të sfidohen; kjo mund të ndodhë përmes fushatave që inkurajojnë njerëzit pasivë të mbështesin viktimat duke i sfiduar autorët e krimit (nëse ata ndjehen rehat me këtë dhe nëse nuk janë në rrezik të drejtpërdrejt nga kjo gjë);
- Theksimin e asaj se manifestimet e paragjykimeve anti-myslimane sfidojnë vlerat kryesore dhe parimet thelbësore të të drejtave të njeriut për shoqëri të lira dhe demokratike. Një mesazh kyç mund të jetë që t'u bëhet thirrje shoqërive në përgjithësi që të marrin përsipër punën për t'iu dhënë fund paragjykimeve anti-myslimane, në vend që ta shohin atë si një problem që do të zgjidhet vetëm nga bashkësitë myslimane. Një pikë e rëndësishme do të sinjalizonte se fushatat anti-myslimane ndikojnë në sigurinë e çdo qytetari – duke u përqendruar në tregimet personale për të ilustruar ndikimin që paragjykimi anti-mysliman ka në jetën e përditshme të të rinjve, burrave, grave dhe të moshuarve myslimanë;
- Theksimin e rrëfimeve njerëzore jo shumë të njohura që mund të shërbejnë si shembuj frymëzues se si të ndërmerren veprime kundër incidenteve anti-myslimane; dhe
- Tërheqjen e vëmendjes drejt jetës së gjallë kulturore, fetare dhe arsimore të bashkësisë lokale myslimane, si dhe kontributet e saj pozitive në shoqëri, duke theksuar nevojën për zhvillim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm.

3. NJOHJA DHE REGJISTRIMI I MOTIVIMIT TË KRIMEVE TË URREJTJES NGA PARAGJYKIMI ANTI-MYSLIMAN

Siç shpjegohet në Pjesën e parë të këtij Udhëzuesi, të gjitha krimet e urrejtjes janë të motivuara nga paragjykimi. Njohja dhe regjistrimi i motivimit specifik nga paragjykimi të një krimi të urrejtjes, duke përfshirë paragjykimin anti-musliman, siguron që krimi të klasifikohet si krim i urrejtjes, si dhe si „vepër e zakonshme“. Mbledhja e të dhënave të sakta është diçka thelbësore për veprimin efektiv kundër krimeve të urrejtjes, duke iu mundësuar autoriteteve policore të kuptojnë shtrirjen e problemit, të dallojnë modelin, të shpërndajnë burime dhe të hetojnë rastet në mënyrë më efektive. Politikëbërësit gjithashtu mund të përdorin të dhëna për të marrë vendime të shëndosha dhe për t'i mbajtur bashkësitë të informuara për kërcënimet dhe tendencat e krimit të urrejtjes.⁹⁷

Mbledhja e të dhënave të krimit të urrejtjes

Viktimat e krimit të urrejtjes me prejardhje të ndryshme kanë të njëjtën përvojë të dëmit emocional nga të qenët në shënjestër për shkak të përkatësisë reale apo të perceptuar të tyre në një grup të caktuar. Megjithatë, grupe të ndryshme gjithashtu ka të ngjarë të përjetojnë modele të ndryshme të krimit dhe nivele të ndryshme të besimit në raportimin e veprave penale. Prandaj, është e dobishme të mblidhen dhe analizohen të dhënat për motivet e ndryshme të paragjykimeve si kategori të veçanta në mënyrë që secila të mund të adresohet në mënyrë më efektive në aspektin e pranisë policore dhe alokimit të burimeve për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e krimit. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë njohur një sërë motivesh paragjykimi që mund të formojnë bazën e krimeve të urrejtjes, duke përfshirë krimet e urrejtjes kundër myslimanëve.⁹⁸

Njohja dhe regjistrimi i krimeve në bazë të motivimit anti-musliman është një mënyrë e rëndësishme që qeveritë të njohin shkallën e problemit dhe të vlerësojnë eksperiencën e viktimave të synuara për shkak të identitetit të tyre real ose të perceptuar mysliman. Policia, si reagues i parë ndaj krimeve, në përgjithësi luan rolin më të rëndësishëm për të siguruar që krimet e urrejtjes të klasifikohen dhe regjistrohen si të tilla, duke bërë përcaktimin fillestar se si të regjistrohet një krim dhe nëse duhet të përfshihet paragjykimi anti-musliman si një motivim i mundshëm paragjykimi.

97 *Mbledhja dhe monitorimi i të dhënave të krimit të urrejtjes: Një udhëzues praktik*, (Warsaw: OSCE/ODIHR, 2014), <<https://www.osce.org/odihr/datacollectionguide>>.

98 *Ibid.*

Rekomandim:

Në përputhje me zotimet e tyre ndaj OSBE-së, qeveritë duhet të mbledhin të dhëna për krimet e urrejtjes, përfshirë ato të motivuara posaçërisht nga paragjykimet anti-myslimane, dhe t'i bëjnë të dhënat të disponueshme për publikun. Policia, si reagues i parë ndaj krimeve, duhet të sigurojë që krimet e urrejtjes kundër myslimanëve të klasifikohen dhe regjistrohen si të tilla.

Duhen konsideruar trajnime për oficerët e policisë, që mund të bëhen në partneritet me agjencitë e ndjekjes penale ose avokatët, për t'i ndihmuar ata të kuptojnë më mirë se si t'i klasifikojnë krimet e urrejtjes kundër myslimanëve,

Shembull i praktikës së mirë:

Në rajonin e OSBE-së në vitin 2017, 16 shtete kishin një mekanizëm të mbledhjes së të dhënave për policinë për regjistrimin e incidenteve anti-myslimane dhe i paraqitën ato të dhëna në ODIHR: Austria, Kanadaja, Republika Çeke, Kroacia, Danimarka, Finlanda, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Greqia, Islanda, Holanda, Polonia, Sllovakia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.

Që nga viti 2001, Gjermania regjistron të dhëna për “krime të motivuara politikisht” duke përfshirë një paragjykim të quajtur krime të urrejtjes ksenofobike. Në vitin 2017, Gjermania implementoi nënkategorinë “Islamofobia” në katalogun e saj të të dhënave federale për një kuptim më të qartë të krimeve të urrejtjes.⁹⁹

Informacioni që policia mbledh dhe klasifikon mund të jetë vendimtar për të siguruar që një krim të hetohet dhe ndiqet penalisht si një krim anti-mysliman i urrejtjes. Mënyra si reagon policia në vendin e krimit të urrejtjes mund të ndikojë në rimëkëmbjen e viktimave, perceptimin e bashkësisë për angazhimin qeveritar në drejtim të adresimit të krimeve të urrejtjes dhe rezultatin e hetimit.¹⁰⁰ Cilësia e informacionit të mbledhur nga policia është gjithashtu shumë e rëndësishme në zhvillimin e politikave afatgjata dhe veprimtarisë parandaluese të qeverisë. Pra, ndërtimi i kapaciteteve të autoriteteve policore për të njohur dhe regjistruar krimet e urrejtjes është shumë e rëndësishme. ODIHR posedon një program asistues që synon përmirësimin e sistemeve për monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave për krimet e urrejtjes – INFAHCT (Pako e informacionit kundër krimit të urrejtjes) – i cili ndihmon në ndërtimin dhe forcimin e politikave dhe kapaciteteve të institucioneve kombëtare dhe strukturave të tjera për të mbledhur të dhëna për krimet e urrejtjes.¹⁰¹

99 Përgjigja ndaj pyetësorit të ODIHR-it në lidhje me nevojat e sigurisë së komuniteteve myslimane dhe shembuj të praktikave të mira, marrë më 26 shtator 2018 nga një efektiv policie në Gjermani.

100 *Parandalimi dhe reagimi ndaj krimeve të urrejtjes*, op. cit., shënimi 19.

101 Informata kundër krimeve të urrejtjes (INFAHCT), Përshkrimi i programit, <<https://www.osce.org/odih/INFAHCT>>.

Raportimi i krimit të urrejtjes anti-myslimane në rajonin e OSBE-së në 2018¹⁰²

Në vitin 2018, shtetet e mëposhtme pjesëmarrëse zyrtarisht dhe në mënyrë specifike raportuan të dhëna të shqyrtuara për krimet e urrejtjes kundër myslimanëve:

Austria	Franca	Suedia
Kanada	Gjermania	Ukraina
Kroacia	Greqia	Mbretëria e Bashkuar
Republika Çeke	Irlanda	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Danimarka	Holanda	
Finlanda	Polonia	

Gjithsej: 16 shtete

Në vitin 2018, nga shtetet e mëposhtme u raportuan incidente anti-myslimane:

Shqipëria	Finlanda	Polonia
Austria	Franca	Rumania
Belgjika	Gjermania	Federata Ruse
Bosnja dhe Hercegovina	Greqia	Slovakia
Bullgaria	Hungaria	Slovenia
Kanada	Italia	Spanja
Kroacia	Moldavia	Zvicra
Republika Çeke	Holanda	Turqia
Danimarka	Maqedonia e Veriut	Ukraina
Estonia	Norvegjia	Mbretëria e Bashkuar

Gjithsej: 30 shtete

Për të regjistruar një motivim nga paragjykimi anti-mysliman të krimeve të urrejtjes, mund të merren disa hapa praktikë:

- Miratim dhe zbatim i ligjeve për krimin e urrejtjes dhe vendosje e sistemeve, rutinës dhe trajnimeve për të siguruar që zyrtarët përkatës të njohin dhe t'i regjistrojnë krimet e urrejtjes kundër myslimanëve;

102 Lista përfshin të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së që dorëzuan informacione rreth krimit të urrejtjes në ODIHR në vitin 2018, <https://hatecrime.osce.org/what-hate-crime/bias-against-muslims>.

- Vendosje e një sistemi për mbledhjen e të dhënave për të regjistruar krimet e urrejtjes kundër myslimanëve në formularët e raportimit të incidenteve dhe sigurimi i të dhënave të zberthyerë për secilin lloj të krimit të urrejtjes anti-myslimane, gjë që mund të kërkojë ndryshime në format aktuale të raportimit të incidenteve dhe sistemet e TI-së;
- Demonstrim i udhëheqjes politike në nivelin më të lartë të qeverisë duke miratuar politika që kërkojnë nga efektivet e policisë të njohin dhe regjistrojnë motivimet antimyslimane të paragjykit të krimeve të urrejtjes;
- Të siguruarit që autoritetet policore përdorin një sërë treguesish specifike (të njohur si „treguesit e paragjykit“, shih më shumë nën titullin „Krimet e urrejtjes kundër myslimanëve në rajonin e OSBE-së: veçoritë kryesore“) që mund të ndihmojnë në identifikimin e motivimit të krimeve të urrejtjes nga paragjykimi anti-mysliman, duke pranuar se ekzistenca e treguesve të tillë nuk provon në vetvete se një incident ka qenë krim i urrejtjes; dhe
- Organizimi i trajnimeve dhe ngjarjeve për ngritjen e vetëdijes për efektivet e policisë me qëllim ndërtimin e kapacitetit e tyre për të kuptuar tiparet specifike të krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve, gjatë punës së tyre me raste studimore dhe skenare relevante.¹⁰³

Rekomandim:

Qeveritë duhet të ofrojnë trajnim për personelin e policisë për të rritur kapacitetin dhe kuptimin e tyre për krimet e urrejtjes kundër myslimanëve, se si të regjistrohen krimet e urrejtjes dhe si t'u përgjigjen krimeve të urrejtjes.

Shembull i praktikës së mirë:

ODIHR ka zbatuar Trajnimin për Krimet e Urrejtjes për Prokurorë (PAHCT) dhe Trajnimin kundër Krimeve të Urrejtjes për Institucionet Ligjzbatuese (TAHCLE) në shumë vende.¹⁰⁴

PAHCT është zbatuar në tetë shtete pjesëmarrëse: Bullgaria, Republika Çeke, Gjeorgjia, Islanda, Malta, Maqedonia e Veriut, Polonia dhe Sllovakia. TAHCLE është zbatuar në 17 shtete pjesëmarrëse: Bullgaria, Kroacia, Estonia, Finlanda, Gjeorgjia, Islanda, Italia, Letonia, Lituania, Malta, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Polonia, Rumania,

103 *Mbledhja dhe monitorimi i të dhënave të krimit të urrejtjes*, op. cit., shënimi 97 dhe *Parandalimi dhe reagimi ndaj krimeve të urrejtjes*, op. cit., shënim 19.

104 Mësoni më shumë në: Trajnimi për prokurorët dhe krimet e urrejtjes (PAHCT), përshkrimi i programit: <<https://www.osce.org/odihr/pahct>>; dhe Trajnimi rreth krimeve të urrejtjes për organet ligjzbatuese (TAHCLE), përshkrimi i programit: <<https://www.osce.org/odihr/tahcle>>.

Slovakia, Spanja dhe Turqia. Përveç kësaj, TAHCLE u zbatua në Kosovë* dhe në komunën e Valencias, Spanjë.

PAHCT është krijuar për të rritur aftësitë e prokurorëve në njohjen, hetimin dhe ndjekjen penale të gamës së plotë të krimeve të urrejtjes, përfshirë ato të motivuara nga paragjykimi anti-mysliman. Trajnimi u lejon pjesëmarrësve të rrisin të kuptuarit e tyre të konceptit, kontekstit dhe ndikimit të krimeve të urrejtjes, të konsolidojnë njohuritë e standardeve ndërkombëtare dhe ligjeve vendore të krimit të urrejtjes, dhe të përmirësojnë aftësinë e tyre për të dëshmuar krimet e urrejtjes në gjykatë. TAHCLE është krijuar për të përmirësuar aftësitë e policisë në njohjen, kuptimin dhe hetimin e krimeve të urrejtjes.

Mbledhja e të dhënave gjithmonë mund të përmirësohet dhe fuqizohet. Siç u tha më parë, ka ende shtete pjesëmarrëse të OSBE-së që nuk mbledhin ose raportojnë të dhëna. Disa mënyra për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave:

- Organizimi i takimeve të fokusuara në mbledhjen e të dhënave, mbledhjen e palëve relevante të interesit qeveritarë dhe joqeveritarë, me qëllim përmirësimin e mbledhjes së të dhënave dhe sigurimin e kuptimit të përbashkët dhe kategorizimit të të dhënave në dispozicion;
- Qarkullimi dhe ndarja e raporteve të zhvilluara nga organizatat e shoqërisë civile rreth krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve, për të rritur ndërgjegjësimin midis zyrtarëve qeveritarë rreth asaj se si manifestohet paragjykimi bashkëkohor anti-mysliman;
- Mos stëranalizohet vlefshmëria e të dhënave, duke e përdorur atë si një pasqyrë për një çështje potencialisht më të gjerë dhe krim të nënraportuar;
- Të kërkohet të bëhen studime, bazuar në të dhënat e mbledhura, që mund të ofrojnë njohuri rreth asaj se si manifestohet paragjykimi anti-mysliman;
- Të inkurajohen efektivet e të policisë që të marrin parasysh perceptimin e viktimës kur regjistrojnë dhe hetojnë krimet të urrejtjes (p.sh., kur viktimat perceptojnë një krim si të motivuar nga paragjykimi anti-mysliman, policia automatikisht e regjistron atë si krim të urrejtjes);¹⁰⁵
- Lehtësimi i raportimit të krimeve të urrejtjes ndaj myslimanëve përmes ofrimit të mekanizmave të raportimit të aksesueshëm dhe konfidencial;

¹⁰⁵ *Mbledhja dhe monitorimi i të dhënave të krimit të urrejtjes*, op. cit., shënimi 97, faqe 15.

* Nuk ka konsensus midis shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së për statusin e Kosovës dhe si rrjedhojë, Organizata nuk ka një qëndrim për këtë çështje. Të gjitha referencat për Kosovën në këtë tekst, qoftë për territorin, institucionet apo popullin, duhet të kuptohen në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

- Ngritja e vetëdijes brenda bashkësisë myslimane se ku dhe si të raportohen incidentet; dhe

Rekomandim:

Kur regjistrohen krimet, zyrtarët e policisë duhet të marrin parasysh perceptimin e viktimës, duke pranuar se nëse viktimat perceptojnë një krim si të motivuar nga paragjykimi anti-musliman, ky motivim i perceptuar i paragjykit duhet të jetë i regjistruar dhe duhet të jetë pjesë e hetimit.

- Vendosja e pikave shtesë për regjistrimin e krimit të urrejtjes anti-muslimane duke punuar me qendrat e bashkësisë lokale, institucionet fetare dhe mekanizmat e tjerë të raportimit të palëve të treta për të krijuar kanale të mëtejshme raportimi.

Programi i ODIHR-it për mbështetjen e mbledhjes së të dhënave

ODIHR gjithashtu ka zhvilluar një program të titulluar INFAHCT (Pako e informacionit kundër krimit të urrejtjes), që synon përmirësimin e sistemeve për monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave për krimet e urrejtjes INFAHCT e arrin këtë duke ndihmuar në ndërtimin dhe forcimin e politikave dhe kapaciteteve të institucioneve kombëtare dhe strukturave të tjera për të mbledhur të dhëna për krimet e urrejtjes.¹⁰⁶

4. SIGURIMI I PROVAVE TË NEVOJAVE TË SIGURISË TË BASHKËSISË MYSLIMANE DUKE PUNUAR ME TA PËR TË MBLEDHUR TË DHËNA PËR KRIMIN E URREJTJES

Politika e bazuar në prova

Të dhënat e sakta dhe të besueshme janë thelbësore për veprim efektiv kundër krimeve të urrejtjes. Mekanizmat e mirëdizajnuar për regjistrimin dhe përpilimin e të dhënave u mundësojnë autoriteteve policore të mbledhin inteligjencë rreth modeleve lokale të krimit të urrejtjes, të ndihmojnë në shpërndarjen e burimeve dhe të mbështesin hetimin më efektiv të llojeve specifike të rasteve. Politikëbërësit pastaj mund të mbështeten në këtë informacion për të marrë vendime të shëndosha dhe për të komunikuar me bashkësitë e prekura dhe publikun e gjerë në lidhje me shkallën e krimeve të urrejtjes dhe përgjigjen.¹⁰⁷

¹⁰⁶ Për më shumë informacion mbi INFAHCT, shih, <<https://www.osce.org/odihr/INFAHCT>>.

¹⁰⁷ *Mekanizmat e mbledhjes dhe monitorimit të të dhënave të krimit të urrejtjes, op. cit.*, shënimi 97.

Mbledhja e të dhënave për krimet e urrejtjes kundër myslimanëve është një mënyrë vendimtare që qeveritë të vlerësojnë sfidat që lidhen me intolerancën ndaj myslimanëve dhe të mbledhin prova për nevojat e sigurisë të bashkësive myslimane. Mos grumbullimi i këtyre të dhënave mund të perceptohet si nënvlerësim i problemit ose mohim i ekzistencës së tij.

Rekomandim:

Të dhënat për krimet e urrejtjes kundër myslimanëve duhet të mbledhen për t'u mundësuar qeverive të vlerësojnë më saktë nevojat e sigurisë të bashkësive myslimane dhe të shpërndajnë burimet në mënyrë më efektive. Kanalet e mëtejshme të mbledhjes së të dhënave duhet të hulumtohen dhe duhet të bëhet çdo përpjekje për të kapur sa më shumë të dhëna të jetë e mundur në mënyrë që të ofrohet një vlerësim dhe kuptim i saktë i çështjes.

Shembull i praktikës së mirë:

Byroja Federale e Hetimeve të Shteteve të Bashkuara ka mbledhur dhe publikuar statistika të krimit të urrejtjes që nga viti 1992. Byroja heton qindra raste çdo vit dhe punon për të zbuluar dhe parandaluar incidente të mëtejshme përmes trajnimit për zbatimin e ligjit, shtrirjes publike dhe partneriteteve me grupet e bashkësisë. Tradicionalisht, hetimet e FBI-së për krimet e urrejtjes kufizoheshin në krime ku autorët e krimit veprojnë në bazë të paragjykimit ndaj racës, ngjyrës, fesë ose origjinës kombëtare të viktimës. Me miratimin e Aktit të Parandalimit të Krimeve të Urrejtjes të vitit 2009 nga Matthew Shepard dhe James Byrd, Jr., Byroja u autorizua që të hetonte gjithashtu krimet e kryera në bazë të paragjyqimeve të orientimit seksual aktual ose të perceptuar, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar ose gjinisë.¹⁰⁸

Në shumë shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, organizatat e shoqërisë civile kanë zhvilluar ekspertizë të konsiderueshme në fushën e mbledhjes së të dhënave të krimit të urrejtjes. Ndërsa të dhënat zyrtare në disa vende mund të sugjerojnë se krimet e urrejtjes ndaj myslimanëve nuk janë problem, të dhënat e shoqërisë civile bëjnë të ditur se krimet e urrejtjes ndaj myslimanëve janë një fenomen i vërtetë dhe jashtëzakonisht i rrezikshëm.¹⁰⁹

Në disa vende, agjencitë qeveritare bashkëpunojnë me komunitetet myslimane në ndarjen, kontrollin dhe mbledhjen e të dhënave për krimet e urrejtjes kundër myslimanëve, bazuar në një përkufizim të qartë të asaj çka përbën një krim të urrejtjes. Nëse policia dhe organizatat e bashkësisë shkëmbejnë të dhëna, ato zakonisht anonimizohen për të siguruar mbrojtjen e informacionit personal.

108 Byroja Federale e Hetimeve, faqja e internetit e FBI-së, <<https://www.fbi.gov/investigate/civil-rights/hate-crimes>>.

109 Shiko, „Studimi i ri zbulon shkallën e nënraportimit të incidenteve të urrejtjes në Poloni“, 13 maj 2019 OSBE/ODIHR, <<http://hatecrime.osce.org/infocus/new-study-reveals-scale-underreporting-hate-incidents-poland>>.

Publikimi i të dhënave qeveritare dhe joqeveritare jo vetëm që i bën të dhënat më të sakta dhe lejon një pamje më të plotë; por gjithashtu adreson denoncimin dhe regjistrimin e pamjaftueshëm. Ndarja e të dhënave është edhe më efektive nëse bashkëpunimi midis qeverisë dhe aktorëve joqeveritarë formalizohet përmes memorandumeve ose protokolleve. Ekspertët qeveritarë dhe joqeveritarë që punojnë së bashku mund të maksimizojnë përdorimin e efektiv të të dhënave të mbledhura për të analizuar tendencat dhe formulimin e politikave. Ndarja e të dhënave gjithashtu ndihmon në rritjen e besimit të bashkësive tek autoritetet.

Rekomandim:

– me shoqërinë civile, duke përfshirë organizatat myslimane, në ndarjen, kontrollin dhe mbledhjen e të dhënave për krimet e urrejtjes kundër myslimanëve, për të zhvilluar statistika më të sakta dhe për të shmangur raportimin dhe regjistrimin e pamjaftueshëm.

Puna me organizatat e bashkësisë myslimane për të mbledhur të dhëna mund të ndihmojë gjithashtu për:

- Të adresuar mungesën e raportimit, pasi përfaqësuesit e bashkësisë myslimane mund të inkurajojnë bashkësinë të përdorë mekanizma të tillë si raportimi i një incidenti në internet, përmes telefonit ose përmes një pale të tretë në polici. Gjithashtu mund të punojnë si ndërmjetës midis autoriteteve dhe zyrtarëve qeveritarë për të kuptuar më mirë kontekstin në të cilin ndodhin krimet e urrejtjes dhe ndikimin që ato kanë në komunitetet myslimane. Dëgjimi i rrëfimeve të dorës së parë për gamën e incidenteve që bashkësitë myslimane regjistrojnë, mund të përmirësojë kuptimin që zyrtarët qeveritarë kanë për përhapjen e sulmeve anti-myslimane dhe të kontribuojnë në përmirësimin e përgjigjeve të qeverisë ndaj problemit; dhe
- Kur të dhënat anonimizohen nga organizatat e bashkësisë, para se të ndahen me agjencitë qeveritare, ato mund ende të përdoren për të ndërtuar një pamje të inteligjencës në mënyrë që të mbështesin zbatimin e masave parandaluese në adresimin e krimit të urrejtjes anti-myslimane.

5. NDËRTIMI I BESIMIT MIDIS QEVERISË DHE BASHKËSIVE MYSLIMANE

Disa nga hapat e theksuar në seksionet e mëparshme – pranimi i problemit të paragjykitimit anti-mysliman, vlerësimi i rreziqeve të sigurisë në bashkëpunim me bashkësinë myslimane dhe rritja e ndërgjegjësimit publik – janë gjithashtu të rëndësishme në ndërtimin e besimit midis bashkësive myslimane dhe qeverive. Njëkohësisht, shumë hapa të tjerë mund të kontribuojnë në ndërtimin e besimit. Krijimi i kanaleve të konsultimit dhe koordinimit mund të jetë veçanërisht i rëndësishëm. Institucionalizimi formal i një

bashkëpunimi të tillë, p.sh., përmes një Memorandumi të Mirëkuptimit, mund të jetë një mënyrë efektive për të ndërtuar besimin.

Të qenët i hapur dhe transparent dhe të dhënit e informacionit kyç, kur është e nevojshme, është një element i rëndësishëm i ndërtimit të besimit midis qeverisë dhe bashkësive myslimane. Qeveritë mund të zbulojnë më shumë informacion rreth autorëve të kriminit dhe grupeve të organizuara sesa më parë dhe të pranojnë gabimet dhe barrierat e mëparshme në punën e tyre.

Rekomandim:

Ndërtoni besimin duke vendosur kanale formale bashkëpunimi midis bashkësive myslimane dhe qeverive. Jini transparentë dhe të sinqertë, duke u angazhuar me bashkësitë myslimane më gjerësisht, duke siguruar pjesëmarrjen e grave dhe burrave, në vend që të angazhoheni vetëm me disa kontakte kryesore, udhëheqës të bashkësisë apo miq. Angazhimi më i gjerë është kritik për të siguruar ndërtimin e besimit me të gjithë bashkësinë, jo vetëm me një pjesë të vogël të njerëzve.

Shembull i praktikës së mirë:

Në Berlin, kontaktet midis policisë dhe shoqatave të xhamive po zhvillohen përmes “marrëveshjeve të bashkëpunimit”. Policia lokale në rrethin e Neukölln, së bashku me shoqatën lokale të xhamive, filluan një program të quajtur “TiK” (Transferimi i Kompetencave Ndërkulturore). Me synimin për të vënë në kontakt xhamitë dhe efektivet e policisë nga rrethe të ndryshme, TiK ndihmoi në hartimin e udhëzimeve kombëtare për policinë, se si të ndërveprojnë me kontaktet, xhamitë dhe myslimanët.¹¹⁰

Një nga hapat më të rëndësishëm që zyrtarët qeveritarë mund të ndërmarrin për të ndërtuar besimin është të vizitojnë institucionet myslimane dhe të mbajnë lidhje të rregullta me përfaqësuesit dhe ekspertët e bashkësisë myslimane. Një kontakt i tillë do t’u mundësojë zyrtarëve të mësojnë më shumë rreth sfidave që lidhen me krimin anti-mysliman të urrejtjes dhe të mund të verifikojnë se politikat dhe shërbimet qeveritare janë relevante për bashkësinë. Kontaktet e rregullta krijojnë besim në gatishmërinë e qeverisë për të trajtuar problemet më shqetësuese brenda bashkësive. Vizita e një bashkësie myslimane pas një sulmi të dhunshëm anti-mysliman ose pas përdhosjes së një vendi islamik mund të jetë një shenjë e rëndësishme solidariteti, por kjo nuk duhet të jetë hera e parë që një politikan ose zyrtar qeveritar nga niveli kombëtar ose lokal kontakton bashkësinë myslimane.

Konsultimi, bashkëpunimi dhe koordinimi janë veçanërisht të rëndësishme kur bëhet fjalë për autoritetet policore, si në nivelin kombëtar ashtu dhe në atë lokal. Zyrtarët

110 *Muslimanët në Evropë: Një raport mbi 11 qytete të BE-së*, (Nju Jork, Londër, Budapest: Instituti i Shoqërisë së Hapur, 2010), <https://www.opensocietyfoundations.org/sites/default/files/a-muslims-europe-20110214_0.pdf>.

e policisë, që nga drejtuesit e lartë e deri tek oficerët e policisë së vijës së parë, kanë një rol jetësor në krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme dhe bashkëpunuese me bashkësitë myslimane, duke përfshirë udhëheqjen dhe pikat fokale të sigurisë. Krijimi i këtyre kanaleve të komunikimit jo vetëm që ndërton besimin, por gjithashtu mund të sigurojë që strategjitë dhe operacionet e përditshme të jenë më efektive dhe të përafuara me nevojat e viktimave, veçanërisht në nivel lokal. Frekuenca e një komunikimi të tillë është vendimtare në ndërtimin e besimit; kontakti i rrallë nuk do të mjaftojë. Marrja seriozisht e veprave penale të nivelit të ulët dhe puna e përditshme me bashkësinë për t'u siguruar që krimet e urrejtjes kundër myslimanëve po adresohen, mund të ndihmojnë në krijimin e procedurave efektive dhe përforcimin e lidhjeve. Për ndërtimin e besimit midis organeve qeveritare dhe bashkësive myslimane mund të zbatohen edhe disa masa të tjera:

- Agjencitë e drejtësisë penale mund të caktojnë një oficer ndërlidhës për të vepruar si një pikë e veçantë kontakti për bashkësinë dhe për të ndjekur shqetësimet lidhur me krimin anti-mysliman të urrejtjes. Një oficer i tillë ndërlidhës mund të ketë objektivin për ndërtimin e besimit pjesë të përshkrimit të punës së tij/saj dhe të jetë përgjegjës për zhvillimin e strategjive posaçërisht për këtë qëllim;

Rekomandim:

Agjencitë e drejtësisë penale mund të caktojnë një oficer ndërlidhës në bashkësinë myslimane si një pikë kontakti. Zyrtaari ndërlidhës mund të ndjekë shqetësimet në lidhje me krimin e urrejtjes anti-myslimane dhe të jetë një pikë kontakti për stafin tjetër të drejtësisë penale, kur nevojiten këshilla.

- Kryetarët e bashkive dhe përfaqësuesit e policisë mund të vizitojnë xhaminë lokale ose qendrën kulturore islame për t'u njohur me anëtarët dhe përfaqësuesit e bashkësisë si dhe vendet kryesore islame;

Rekomandim:

Përfaqësuesit e policisë dhe figurat politike mund të ndërtojnë besim duke vizituar institucionet lokale myslimane dhe duke takuar anëtarët e bashkësisë për të diskutuar çështje të rëndësishme. Organizatat e bashkësisë që kanë të bëjnë me bashkësitë myslimane gjithashtu duhet të merren parasysh për vizita në mënyrë që të zgjerohet shtrirjen brenda bashkësisë.

Shembull i praktikës së mirë:

Policia në Amsterdam dhe Rotterdam, Holandë, ishte aktive në uljen e tensioneve në javët para lëshimit të filmit të Geert Wilders, "Fitna". Në Amsterdam, policia organizoi një takim para lëshimit të filmit për të siguruar që bashkësia lokale myslimanë kupton pozicionin e saj ligjor, përfshirë të drejtën për të paraqitur një ankesë.¹¹¹

111 *Ibid.*

- Agjencitë e drejtësisë penale mund të ftojnë bashkësitë myslimane që të zhvillojnë seminare për oficerët e policisë;

Rekomandim:

Organet e drejtësisë penale mund të marrin pjesë në punëtoritë e zhvilluara nga bashkësia myslimane të fokusuara në nevojat specifike të sigurisë së bashkësisë dhe përmirësimin e njohurive dhe të kuptuarit të diversitetit dhe kulturave të bashkësisë.

Shembull i praktikës së mirë:

Grupi i Rrjeteve Islamike (ING) me seli në San Jose, Kaliforni në Shtetet e Bashkuara ofron Seminare të specializuara të Zbatimit të Ligjit të dizajnuara për shefat e policisë, sherifët dhe anëtarët e tjerë të personelit të nivelit të komandës dhe administratorëve të lartë. Këto sesione synojnë të rrisin ndërgjegjësimin dhe aftësitë e kompetencës kulturore, si dhe të ndërtojnë një marrëdhënie pozitive midis zbatimit të ligjit dhe bashkësisë myslimane amerikane.¹¹²

- Organet e drejtësisë penale mund të organizojnë trajnime dhe ngjarje që ndihmojnë oficerët e policisë të njihen me bashkësinë, historinë e saj dhe traditat fetare, si dhe sfidat me të cilat ballafaqohet bashkësia në lidhje me paragjykimet anti-myslimane;
- Organet qeveritare, për shembull ministria e punëve të brendshme dhe e drejtësisë, mund të kërkojnë këshilla dhe komente të pavarura nga bashkësitë myslimane mbi reagimet e qeverisë ndaj krimeve të urrejtjes, përfshirë sa iu përket kurrikulave kombëtare për trajnim për të adresuar krimet e urrejtjes; dhe
- Qeveritë mund të organizojnë grupe kombëtare të punës për krimin e urrejtjes të përbërë nga përfaqësues të shoqërisë civile, akademikë, oficerë ndërlidhës të policisë dhe prokurorë, të cilët takohen rregullisht për të diskutuar incidentet e motivuara nga paragjykimi brenda bashkësisë. Grupe të tilla pune mund të organizohen edhe në nivel lokal.

6. Vlerësimi i rreziqeve të sigurisë dhe parandalimi i sulmeve

Bashkësitë myslimane duhet të konsiderojnë krijimin e grupeve këshilluese të sigurisë dhe/ose hartimin e planeve të sigurisë së bashkësisë, që do të mundësojnë vlerësimi më sistematik të situatës. Këto mund të jenë gjithashtu pjesë e një procesi bashkëpunimi me palët e interesuara shtetërore, pasi kjo mund të jetë qasja më efektive për të vlerësuar rreziqet e sigurisë së bashkësisë dhe për t'i parandaluar sulmet. Krijimi i kanaleve të hapura dhe të qëndrueshme të komunikimit jo vetëm që siguron një shkëmbim efektiv të informacionit në lidhje me kërcënimet e mundshme, por gjithashtu zhvillon strategji afatgjata.

¹¹² Uebfaqja e ING, edukim rreth aspekteve kulturore dhe respektin e ndërsjellë, Përmbledhje e seminarit për organet ligjzbatuese, <<https://ing.org/law-enforcement-overview/>>.

Kanale të tilla komunikimi janë gjithashtu shumë të nevojshme në kohë krize. Ato ndihmojnë në njohjen dhe vlerësimin e niveleve të frikës dhe tensionit brenda bashkësive. Këto vlerësime gjithashtu mund të ndihmojnë në nxitjen e veprimit në nivel politik dhe praktik – për kontroll më të madh policor në pikat kryesore në qytete dhe rajone dhe masa risigurimi për bashkësitë myslimane që tashmë mund të kenë pësuar incidente dhe krime të urrejtjes pas sulmeve të mëdha terroriste.

Kanalet mirëvendosura të komunikimit mund të jenë gjithashtu jetike në rastet e përgjigjes ndaj emergjencave. Transparenca në shkëmbimin e informacionit mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit midis zyrtarëve dhe anëtarëve të bashkësive të prekura. Informacioni nga bashkësia mund të ndihmojë shërbimet e sigurisë së qeverisë të përmirësojnë vlerësimet e rrezikut dhe të përqendrohen në çështje me interes të veçantë. Në të njëjtën kohë, informacioni i ndarë nga policia dhe shërbimet e inteligjencës mund të ndihmojnë bashkësinë të ndër marrë hapat e duhur parandalues.

Rekomandim:

Qeveritë duhet të konsiderojnë krijimin e një procesi bashkëpunues dhe të vazhdueshëm që përfshin bashkësitë myslimane, me qëllim vlerësimin e nevojave të sigurisë dhe formulimin e mënyrave për parandalimin e incidenteve dhe sulmeve të urrejtjes, por edhe zvogëlimin e frikës dhe pasigurisë që mund të rritet pas krimeve të mëdha kombëtare, siç janë sulmet terroriste.

Qeveritë dhe policia duhet të punojnë me bashkësitë myslimane për krijuar grupe këshilluese që mund të përdoren në raste të ndonjë sulmi ose kur policia kërkon mbështetje gjatë një operacioni, ngjarjeje ose kërcënimi për bashkësinë. Grupet këshilluese mund të mbështesin qeverinë dhe policinë duke siguruar inteligjencë në kohë reale dhe mund të përdoren gjithashtu për t'ia komunikuar mesazhet bashkësisë.

Shembull i praktikës së mirë:

Në Sllovaki, Agjencia Kombëtare Penale (NAKA) organizoi një takim joformal me një përfaqësues të Fondacionit Islamik në Sllovaki, ku shprehu interesin e saj për rastet e krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve. Iu siguroi përfaqësuesve kontakt të drejtpërdrejtë telefonik me zyrtarin e bashkësisë që do të merrej me raste të tilla, nëse ato do të ndodhnin. Për fat të keq, nuk është vendosur asnjë bashkëpunim i mëtejshëm.¹¹³

Krijimi i platformave formale ose joformale për përfaqësuesit e bashkësisë myslimane për të artikuluar nevojat dhe shqetësimet e tyre të sigurisë në baza të rregullta mund ta

113 Përgjigja ndaj pyetësorit të ODIHR-it në lidhje me nevojat e sigurisë së bashkësive myslimane dhe shembuj të praktikave të mira, marrë më 20 shtator 2019 nga Fondacioni Islamik në Sllovaki.

sigurojë bashkësinë dhe t'i ndihmojë autoritetet e sigurisë. Mund të jetë gjithashtu një hap drejt përmbushjes së detyrimeve qeveritare për të mbrojtur të drejtat e njeriut të individëve dhe bashkësive. Duke punuar së bashku, zyrtarët qeveritarë dhe përfaqësuesit e bashkësisë myslimane mund të vlerësojnë më mirë nevojat e sigurisë së bashkësisë dhe institucioneve të tij, siç janë shkollat dhe xhamitë, dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të siguruar mbrojtje adekuata për të targetuarit potencialë.

Qeveritë mund të ndërmarrin hapa të ndryshëm praktikë për të siguruar një rrjedhë komunikimi me bashkësitë myslimane për çështjet e sigurisë:

- Të përdorin të dhënat e disponueshme të krimit të urrejtjes për të identifikuar modellet e krimit dhe „pikat e nxehta“ për sulme, si online ashtu dhe offline;
- Të këshillohen me bashkësitë myslimane për të monitoruar tensionet me qëllim parandalimin e dhunës anti-myslimane – në përgjithësi, është praktikë e mirë për politikanët dhe/ose nëpunësit civilë që t'i thërrasin udhëheqësit kryesorë të bashkësive fetare, si bashkësitë myslimane, kur ka ngjarje të mëdha krize kombëtare;
- Të vendosin një oficer ndërlidhës të bashkësisë në të gjitha departamentet relevante të policisë;
- T'i informojnë bashkësitë myslimane sa herë që identifikohet një kërcënim specifik dhe kur niveli i kërcënimit ka ndryshuar; për shembull, të krijojnë një buletin javor rreth tensioneve të bashkësisë, i cili do të qarkullojë mes partnerëve të besuar ose të sigurojnë një profil rreziku për bashkësitë me një skemë të koduar me ngjyra;
- Të angazhohen në dialog me organizatat e bashkësisë myslimane për të siguruar që masat e sigurisë kuptohen nga bashkësia dhe informohen nga kontributi i tyre;
- Të hartojnë dhe përditësojnë analizë të kërcënimeve dhe rrezikut për objektet e bashkësive myslimane sipas nevojës, për t'u përdorur si bazë për policinë;
- Të mbështesin zhvillimin e planit të sigurisë, ekspertizës, specialistëve dhe sistemeve për bashkësinë myslimane. Përgjegjësitë e sistemeve të tilla të sigurisë së bashkësisë përfshijnë: hartëzimin dhe vlerësimin e kërcënimit dhe rrezikut, zhvillimin e planeve të sigurisë, planifikim për emergjencat (reagimi ndaj incidenteve), planifikim për menaxhimin e krizave, lidhjen dhe koordinimin me partnerët e jashtëm, përfshirë policinë. Ajo që duhet bërë të paktën është të identifikohet një pikë kontakti sigurie për bashkësinë; dhe
- Krijimi i grupeve këshilluese të bashkësisë myslimane që mund të këshillojnë policinë gjatë një çështjeje ose operacioni që ndikon bashkësinë në kohë reale.

Autoritetet policore, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel rajonal, duhet të punojnë me bashkësitë lokale myslimane, si dhe me personelin dhe ekipet e tyre të caktuara të

sigurisë, për të rekomanduar, vlerësuar dhe ndihmuar në zbatimin e masave parandaluese të sigurisë sipas nivelit të vlerësuar të kërcënimit, si për shembull duke siguruar që:

- Godinat e bashkësisë (si xhamitë, shkollat islame ose zyrat) të kontrollohen para përdorimit; brenda xhamisë dhe ndërtesës së institucionit islam dhe brenda kufijve më të gjerë të godinës;
- Shkollat e besimit islam dhe institucionet islame të kenë një prezencë të dukshme të jashtme të sigurisë atëherë kur janë në përdorim;
- Personeli i sigurisë së bashkësisë dhe policia të jenë në gatishmëri për individët, objektet dhe aktivitetet e dyshimta në afërsi të ndërtesave të bashkësisë;
- Qasja e automjeteve për parkim të kontrollohet dhe kufizohet vetëm për automjetet e njohura, të cilat kyçen kur nuk janë në përdorim.
- Të gjitha dyert e jashtme të jenë të mbyllura dhe të siguruara nga qasja e paautorizuar, duke siguruar qasje të lehtë në rast të evakuimit emergjent;
- Dyert e brendshme të jenë të mbyllura dhe të siguruara kur nuk janë në përdorim, duke siguruar dalje të lehtë në rast të evakuimit emergjent;
- Stafi dhe vizitorët të udhëzohen që të mos mblidhen jashtë godinave të bashkësisë;
- Procedurat e kyçjes të sigurojnë që të gjitha dritaret dhe dyert të jenë të mbyllura në mënyrë të sigurt;
- Pajisjet e sigurisë – alarmet, ndriçimi i jashtëm dhe kamerat televizive me qark të mbyllur (CCTV) – të kontrollohen rregullisht, lentet e kamerave të jenë të pastra dhe pajisjet për video të jenë duke regjistruar;
- kamerat të monitorohen kur godinat të jenë në përdorim;
- Posta dhe dërgesat të kontrollohen me kujdes para hapjes, duke përfshirë përdorimin e rrezeve X dhe pajisjeve të tjera të zbulimit të metaleve; dhe
- Të ofrohet mbështetje gjatë ngjarjeve fetare ose periudhave më aktive.

Aktivitete të tilla duhet të bëhen rutinë brenda jetës së përditshme dhe javore të stafit në xhami dhe institucione islame. Ekziston një vijë e hollë midis ofrimit të sigurisë ndaj atyre që përdorin institucionin për lutje dhe kultivim të jetës së tyre brenda bashkësisë dhe nga ana tjetër të mundësuarit që këto objekte të mbeten të hapura dhe mikpritëse ndaj të gjitha bashkësive. Në vitin 2015, u realizua një studim mbarëkombëtar i Shteteve të Bashkuara mbi kongregacionet fetare dhe përvojat e tyre në lidhje me krimin. Sondazhi zbuloi se sinagogat dhe xhamitë kishin shumë më shumë gjasa që të kishin kamera

sigurie, pika hyrëse të kufizuara, roje të sigurisë dhe masa të tjera sigurie, krahasuar me kongregacionet e tjera fetare. Sondazhi gjithashtu zbuloi në vazhdimësi se vendet e adhurimit i shohin masat e sigurisë si një kërcënim potencial të misionit të tyre për krijimin e një hapësire të shenjtë, që është e hapur për bashkësitë e tyre.¹¹⁴

Procedurat themelore të sigurisë ofrojnë siguri dhe mirëqenie ndaj të gjithë atyre që përdorin dhe kanë të bëjnë me xhamitë dhe institucionet islame, por institucionet e mbyllura dhe të ruajtura nuk janë të dobishme ose një zgjidhje e mirë.

Një shembull i një kuadri të përgjithshme për sigurinë institucionale përshtatur nga „Praktikat më të mira për xhamitë dhe sigurinë e bashkësisë“ një komplet burimesh, Këshilli për Marrëdhëniet Amerikano-Islamike:

Kini kujdes: Një mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin për sigurinë në xhaminë tuaj është të zhvillon, si pjesë të planit tuaj të sigurisë, një program ndërgjegjësimi sigurie, duke i angazhuar të gjithë anëtarët e xhamisë që ta ndihmojnë ekipin menaxhues dhe të raportojnë aktivitete të dyshimta ose të pazakonta, njerëz ose sende pranë xhamisë ose qendrës së bashkësisë.

Vlerësoni cenueshmërinë tuaj: Ndërgjegjësimi fillon të konkretizohet kur ka një plan sigurie për objektin – edhe nëse bëhet fjalë për një objekt i vogël me një plan një apo dy faqesh (p.sh., se kush e kyç derën natën dhe vendos alarmin). Është e rëndësishme që drejtuesit të kryejnë një vlerësim të rrezikut të cenueshmërisë para se të fillohet një program sigurie.

Parandaloni: Në mënyrë që të menaxhohen krimet kundër xhamive, është e rëndësishme të përpiqeni që ato të mos ndodhin fare. Kështu, parandalimi dhe kufizimi nëpërmjet metodave politike, kulturore dhe sociale është po aq i rëndësishëm sa metodat e sigurisë.

Përgjigjuni dhe lehtësoni: Vlerësoni planin tuaj aktual të sigurisë: A ka qendra juaj një plan? Shumica e vendeve nuk kanë një plan të shkruar të sigurisë. Kush di për planin? Në një skenar ideal, plani i sigurisë për një xhami ose institucion tjetër duhet të jetë i shkruar, duke përcaktuar procedura të gjera të arsyeshme dhe të zbatueshme. Është fort e rekomandueshme që të ketë një person përgjegjës në çdo zinxhir komandues të sigurisë.

Rimëkëmbuni: Shpresojmë që “rimëkëmbja” të mos jetë e nevojshme në një krizë kritike. Megjithatë, faktorët e zhvilluar dhe të përfshirë në procesin e rimëkëmbjes mund të jenë të dobishëm për shumë lloje ngjarjesh, nga incidentet e vogla deri te krizat e rënda.¹¹⁵

114 Christopher P. Scheitle, “Religious Congregations’ Experiences with, Fears of, and Preparations for Crime: Results from a National Survey”, *Review of Religious Research*, March 2018, Volume 60, Issue 1, pp 95-113, <<https://doi.org/10.1007/s13644-017-0316-3>>.

115 Përshtatur nga “Praktikat më të mira për xhaminë dhe sigurinë e komunitetit” komplet burimesh, Këshilli për Marrëdhëniet Amerikano-Islamike, <https://nj.cair.com/images/Mosque_Safety_Guide.pdf>.

7. SIGURIMI I MBROJTJES PËR BASHKËSITË MYSLIMANE DHE LOKACIONET ISLAME, PËRFSHIRË EDHE ATË GJATË NGJARJEVE TË VEÇANTA

Me qëllim mbrojtjen e xhamive, qendrave kulturore islamike, shkollave islamike dhe vendeve të tjera të rrezikuara nga sulmet anti-myslimane, mund të ndërmerren disa hapa praktikë nga shtetet pjesëmarrëse:

- Mbrojtja policore duhet të sigurohet për vendet që mund të jenë objekt i sulmeve anti-myslimane, duke përfshirë xhamitë dhe shkollat islamike, por edhe bizneset në pronësi të myslimanëve, siç janë supermarketet dhe restorantet hallall;
- Të dhënat e disponueshme të krimit të urrejtjes duhen përdorur për të identifikuar pikat e caktuara „të nxehta“ ku shpesh ndodhin sulme anti-myslimane. Kjo mund të përfshijë zona ose rrugë specifike, por edhe lloje specifike të hapësirës publike, siç janë rrjetet e transportit publik ose qendrat tregtare. Këto fusha duhet të jenë prioritet i patrullave policore apo i iniciativave të tjera parandaluese, siç janë fushata me postera ose trajnimi i fokusuar i stafit;
- Rritja e krimeve të raportuara të urrejtjes mund të ndodhë pas ngjarjeve specifike, siç janë sulmet terroriste ose tubimet agresive nacionaliste. Përveç vendeve ku ka më shumë gjasa të ndodhin incidente anti-myslimane, është gjithashtu e rëndësishme të investohet në rritjen e pranisë së sigurisë dhe policisë gjatë periudhave ku ka më shumë gjasa të ketë urrejtje anti-myslimane, si për shembull, fill pas sulmeve terroriste ose gjatë ngjarjeve të rëndësishme politike apo mediatike me debate publike dhe retorikë anti-myslimane. Gjatë periudhave të tilla, duhet pasur kujdes të veçantë dhe policia duhet urdhëruar që të patrullojë rregullisht në vende të tilla;
- Gjithashtu mund të jetë e dobishme që të sigurohen burime financiare që mund të ndihmojnë në adresimin e nevojave të sigurisë së bashkësive myslimane, për shembull, financimi i një roje sigurie ose instalimi i pajisjeve të sigurisë në xhami;
- Mbrojtje shtesë dhe masa të tjera adekuate të sigurisë dhe sigurimit (p.sh., trafiku dhe menaxhimi i turmës) mund të ndërmerren në momente të rëndësishme, si gjatë festave islame. Për shembull, anëtarët e bashkësisë islame mund të jenë më të rrezikuar gjatë Ramazanit për shkak të rritjes së frekuentimit të xhamive për falje, përfshirë edhe në orët e hershme të mbrëmjes; dhe
- Kryerja e një vlerësimi të sigurisë për të ndihmuar institucionet që të mbrohen më mirë mund të ndihmojë, jo vetëm në parandalimin e sulmeve, por gjithashtu të sigurojë që provat të jenë të disponueshme nëse ndodh një sulm.

Rekomandim:

Qeveritë duhet të konsiderojnë masa të shtuara sigurie për t'i mbrojtur institucionet islame në momente kyç, kur bashkësitë janë më së shumti të rrezikuara, si për shembull gjatë festave islame dhe pas ngjarjeve të rëndësishme, brenda dhe jashtë vendit.

Shembull i praktikës së mirë:

Pas një sulmi terrorist ndaj besimtarëve në Londër, u vendos polici e armatosur, si rrjedhojë e rritjes së masave të sigurisë. Një burrë u arrestua me dyshimin për vrasje dhe tentativë vrasje pasi një furgon u turr drejt këmbësorëve pranë Xhamisë së Finsbury Park në orët e para të mëngjesit të së hënës. Policia në Skoci tha se do të përforconte praninë e saj në 84 xhamitë e vendit për të ofruar siguri për bashkësitë lokale.¹¹⁶

8. PUNA ME BASHKËSITË MYSLIMANE PËR TË VENDOSUR SISTEME TË MENAXHIMIT TË KRIZAVE

Bashkësitë myslimane në rajonin e OSBE-së zakonisht nuk kanë një oficer të veçantë të sigurisë, një protokoll të përcaktuar të strategjisë së sigurisë dhe/ose një plan për menaxhimin e krizave. Zhvillimi i strukturave të tilla të sigurisë, megjithatë, duhet inkurajuar dhe mbështetur. Oficerët e sigurisë mund të jenë vullnetarë të bashkësisë, si dhe profesionistë të punësuar ose përfaqësues të bashkësisë mund të marrin përgjegjësi për çështjet e sigurisë. Përgjegjësitë e tyre do të varen nga burimet në dispozicion, por duhet të përfshijnë vlerësimin e kërcënimit dhe rrezikut dhe planifikimin e sigurisë, si dhe koordinimin dhe lidhjen me autoritetet.

Strukturat e specializuara brenda bashkësive myslimane gjithashtu mund të ndërmarin masa për të rritur ndërgjegjësimin midis anëtarëve të tyre lidhur me çështjet e sigurisë, duke përfshirë trajnime, botimet dhe ushtrime emergjence. Masa të tilla nuk duhet të përsërisin përpjekjet e ndërmarra nga qeveritë ose të zvogëlojnë përgjegjësinë e qeverive, e as nuk duhen interpretuar si një shenjë mosbesimi. Përkundrazi, ato duhet të plotësojnë përpjekjet e ndërmarra nga qeveritë, pasi kërkojnë bashkëpunim të ngushtë midis partnerëve.

Për të adresuar nevojat e tyre të sigurisë dhe për t'u përgatitur në mënyrë adekuate për skenarët e krizës, bashkësitë myslimane kanë nevojë për partnerë të fortë qeveritarë, veçanërisht në nivelin lokal. Masat e bashkësisë dhe ato të qeverisë duhet të punojnë së bashku dhe jo kundër njëra-tjetrës apo në drejtime të kundërta. Gjithashtu, bashkësitë myslimane duhet të bashkëpunojnë me bashkësitë e tjera që përballen me sfida të ngjashme dhe që tashmë kanë krijuar mekanizma reagimi, për shembull bashkësitë hebraike.

116 "Policia e Skocisë rrit sigurinë në xhami pas sulmit terrorist". The Scotsman, 19 qershor 2017, <<https://www.scotsman.com/news/police-scotland-steps-up-security-at-mosques-after-terror-attack-1-4480308>>.

Autoritetet qeveritare duhet të ofrojnë mbështetje për bashkësitë myslimane në krijimin e strategjive dhe mekanizmave për t'iu përgjigjur një sulmi dhe për të zhvilluar plane emergjente dhe sisteme të menaxhimit të krizave:

- Autoritetet qeveritare mund të ofrojnë ndihmë në planifikimin e sigurisë dhe emergjencave për bashkësitë myslimane duke kryer vlerësime dhe sondazhe të sigurisë dhe duke ndihmuar në zhvillimin ose ofrimin e këshillave mbi planet ekzistuese të sigurisë së bashkësisë;
- Përfaqësuesit qeveritarë mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në seminare dhe ngjarje për rritjen e ndërgjegjësimit që kanë për synim rritjen e kapacitetit të bashkësive myslimane për t'iu përgjigjur sulmeve;
- Autoritetet qeveritare mund të ndajnë përvoja dhe njohuri në lidhje me procedurat dhe rutinat; dhe
- Agjencitë qeveritare mund të organizojnë stërvitje të përbashkëta për pikat fokale të bashkësisë myslimane dhe punonjësit e ndihmës së parë për të siguruar përgjigjen më të mirë të mundshme ndaj skenarëve të ndryshëm të emergjencës.

Këshilla për mbrojtjen dhe sigurinë e xhamive, qendrave islame dhe medreseve¹¹⁷



117 Grafiket janë riprodhuar me leje nga Faith Associates, <<http://www.faithassociates.co.uk/2013/06/28/mosque-security-safety-tips/>>.

9. SIGURIMI I BASHKËSISË NË RAST TË NJË SULMI

“Çdo sulm anti-mysliman duhet njohur dhe dënuar nga zyrtarët qeveritarë dhe shoqëria civile, pavarësisht nga natyra ose niveli i krimit. Edhe krimet e nivelit të ulët shpejt mund të përshkallëzohen nëse injorohen. Shprehjet e urrejtjes anti-myslimane në diskursin publik gjithashtu mund të shkaktojnë ankth në bashkësitë myslimane nëse nuk dënohen dhe adresohen menjëherë.

Ndikimi i një sulmi anti-mysliman është edhe më i fortë nëse ka një përgjigje të përshtatshme nga qeveria. Në të kundërt, deklaratat nga zyrtarët publikë mund të kenë një ndikim të madh në besimin e bashkësisë. Për të siguruar që reagimi afatgjatë është i përshtatshëm, zyrtarët e qeverisë duhet të koordinohen dhe konsultohen me udhëheqësit e bashkësisë.

Për të siguruar bashkësinë myslimane pas një sulmi, zyrtarët qeveritarë dhe përfaqësuesit politikë mund:

- Të dënojnë sulmin anti-mysliman me një deklaratë për shtyp ose media sociale;
- Të marrin pjesë në një ngjarje përkujtimore ose vigjilje me bashkësinë myslimane;
- Të urdhërojnë rritjen e mbrojtjes policore dhe patrullave për të dërguar një mesazh sigurie drejt bashkësisë;
- Të konsultohen me bashkësinë myslimane për atë se çfarë lloj iniciativash mund të merren për të parandaluar sulmet e ardhshme, përfshirë përfaqësuesit e bashkësisë që përfaqësojnë në mënyrë të barabartë gratë dhe të rinjtë; dhe
- T’i dënojnë sulmet për të treguar mirëkuptim dhe mbështetje nga ana e udhëheqësve, veçanërisht nga udhëheqësit e lartë qeveritarë dhe/ose oficerët e policisë.

Shoqëria civile gjithashtu luan rol në menaxhimin e ndikimit të incidenteve të mëdha, mes tjerash nëpërmjet bashkëpunimit me deputetë he zyrtarë qeveritarë. Demonstrimi publik dhe i hapur i solidaritetit me bashkësitë myslimane, duke pranuar ndikimin që sulmet anti-myslimane kanë mbi bashkësitë myslimane dhe duke paraqitur një politikë me zero tolerancë ndaj të gjitha manifestimeve të paragjykitimit anti-mysliman, kanë rezultuar strategji efektive në disa vende.

Rekomandim:

Shoqëria civile mund të luajë një rol të rëndësishëm në sigurimin e bashkësisë myslimane pas një sulmi, përfshirë bashkëpunimin me deputetët dhe zyrtarët qeveritarë dhe bashkësitë e tjera, duke demonstruar publikisht solidaritetin dhe duke paraqitur një politikë me zero-tolerancë ndaj krimit të urrejtjes anti-myslimane.

Shembull i praktikës së mirë:

Në vitin 2011, para namazit të xhumasë në Bullgari, rreth 150 mbështetës të një partie politike organizuan protesta kundër një xhamie. Brohorisnin fjalë ofenduese kundër besimtarëve duke hedhur vezë, gurë dhe objekte të tjera të forta. Disa u përpoqën të hidheshin mbi gardhin e xhamisë dhe të vendosnin altoparlantët e tyre brenda. Kjo shkaktoi përlëshje midis protestuesve dhe besimtarëve. Pesë besimtarë u plagosën rëndë, ku njëri prej tyre kishte trauma të rënda në kokë. Udhëheqësi i partisë paraprakisht kishte bërë thirrje për urrejtje fetare dhe etnike. Mediat ndërkombëtare regjistruan të gjithë ngjarjen. Shumë institucione, shoqëri civile, organizata joqeveritare dhe bashkësi fetare e dënuan sulmin. Në Facebook u organizua një fushatë me titull “Një lule për çlirimin e Bullgarisë” e cila tërhoqi mijëra ndjekës. Një ditë pas këtij sulmi të përgjakshëm, qytetarët vendosën lule para xhamisë si shenjë solidariteti dhe mbështetjeje. Myftiu i Madh shprehu mirënjohjen e tij zyrtarisht për të gjithë qytetarët bullgarë që mbështetën iniciativën dhe treguan simpati.¹¹⁸

Publiku i gjerë mund të ndihmojë që të sigurojë bashkësinë myslimane pas një sulmi duke pranuar natyrën anti-myslimane të incidentit dhe duke dërguar një sinjal të fortë në mbështetje të diversitetit fetar dhe kulturor. Anëtarët e publikut mund të demonstronjë përkushtim për të punuar drejt një shoqërie ku njerëzit myslimanë ndihen të sigurt që të shprehin publikisht fenë dhe identitetin e tyre.

10. SIGURIMI I MBËSHTETJES PËR VIKTIMAT E SULMEVE ANTI-MYSLIMANE

Standardet minimale të Bashkimit Evropian për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit

„Viktimat e krimit duhet të njihen dhe trajtohen në mënyrë të respektueshme, të ndjeshme dhe profesionale pa diskriminim të çfarëdo lloji në bazë të racës, ngjyrës, origjinës etnike ose sociale, tipareve gjenetike, gjuhës, fesë ose besimit, mendimit politik ose ndonjë mendimi tjetër, anëtarësisimit në një pakicë kombëtare, pronës, lindjes, aftësisë së kufizuar, moshës, gjinisë, shprehjes gjinore, identitetit gjinor, orientimit seksual, statusit të banimit ose shëndetit. Situata personale dhe nevojat imediate, moshë, gjinia, aftësia e kufizuar potenciale, si dhe pjekuria e viktimave të krimit, duhen marrë parasysh në të gjitha kontaktet me një autoritet kompetent që vepron në kontekstin e procedurave penale dhe çdo shërbim që bie në kontakt me viktimat, siç është mbështetja e viktimave ose shërbimet e drejtësisë restauruese, duke respektuar plotësisht integritetin fizik, mendor dhe moral të viktimave. Viktimat e krimit duhet të mbrohen nga viktimizimi sekondar dhe i përsëritur, nga frikësimi dhe nga

118 Përgjigje ndaj kërkesës së ODIHR-it në lidhje me nevojat e sigurisë dhe shembujt e praktikave të mira, marrë më 9 tetor 2019 nga Muslim Denomination, Zyra e Myftiut të Madh.

hakmarrja, duhet të marrin mbështetjen e duhur për të lehtësuar rimëkëmbjen e tyre dhe duhet t'u sigurohet qasje e mjaftueshme në drejtësi¹¹⁹.

Për të përmirësuar zbatimin e Direktivës, në vitin 2017 Komisioni Evropian lëshoi një shënim udhëzues.¹²⁰

Agjencitë qeveritare mund të ofrojnë ndihmë të vyer për bashkësitë myslimane në minimizimin e dëmeve pas një ngjarjeje traumatike dhe t'i ndihmojnë bashkësitë t'i kthehen jetës së tyre të përditshme pas një sulmi.

Për të përmirësuar mbështetjen e tyre për viktimat e sulmeve anti-myslimane, qeveritë mund:

- Të punojnë me institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, qarqet akademike, OJQ dhe organizata ndërkombëtare për të kryer sondazhe që ndihmojnë në qartësimin e nevojave të viktimave të sulmeve anti-myslimane;
- Të konsultohen me bashkësitë myslimane dhe organizatat përkatëse për mbështetje të viktimave, në zhvillimin e strategjive efektive për mbështetje të viktimave;
- Të sigurohen që autoritetet policore të jenë të pajisura për të kuptuar strukturën e bashkësive myslimane dhe përgjegjësitë e anëtarëve të tyre;
- Të miratojnë qasje specifike pas çdo incidenti, bazuar në vlerësimin e individualizuar të nevojave të çdo viktimë (nganjëherë mund të mjaftojnë shërbimet sociale të mbështetjes psikologjike dhe përfshirja e policisë mund të mos jetë e nevojshme);
- Të sigurohen që ata që ofrojnë mbështetje për viktimat dhe të trajnohen për karakterin specifik të bashkësisë myslimane;
- Të jenë të vetëdijshëm për praktikën dhe nevojat fetare të viktimës, por para së gjithash për nevojën për të respektuar dinjitetin e tyre. Të jenë të vetëdijshëm dhe të ndërgjegjshëm për praktikën fetare dhe kulturore myslimane dhe për festat dhe traditat myslimane kur intervistojnë viktimat dhe dëshmitarët, kur regjistrojnë provat dhe kur kryejnë detyra të tjera policore;

119 Direktiva 2012/29/eu e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, <<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/txt/HTML/?uri=CELEX:32012L0029&from=EN>>.

120 Konkluzionet e Grupit të Nivelit të Lartë të Komisionit Evropian për luftën kundër racizmit, ksenofobisë dhe formave të tjera të intolerancës – Sigurimi i drejtësisë, mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat e krimit të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes: „10 parimet kryesore udhëzuese”, <http://ec.europa.eu/newsroom/just/document.cfm?doc_id=48874>. Informacione mbi burimet specifike në dispozicion të viktimave të krimit nga urrejtja në: <http://ec.europa.eu/newsroom/just/document.cfm?doc_id=48875>.

- Të zhvillojnë kontakte dhe të ofrojnë mbështetje në mënyrë të shpeshtë gjatë një hetimi për ta siguruar bashkësinë dhe të ndërmarrin hapa për të krijuar një plan të qartë për kontakt me viktimën; dhe
- Të konsiderojnë mbështetjen e bashkësisë më të gjerë myslimane që mund të jetë ndikuar nga një sulm dhe të bëjë përpjekje për ta siguruar bashkësinë dhe për të krijuar mekanizma mbështetës.

Shtojca

Shtojca 1: Raste studimore

Rastet studimore në vijim mund të përdoren në kontekstin e ndërtimit të kapaciteteve për të ushtruar të punuarit me treguesit e paragjykitimit.

Gjatë diskutimit të studimeve të rastit duhen parashtruar pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë do të pyesnit nëse do të ishit duke hetuar këtë incident?
- Çfarë kërkimi do të bënit?

Rasti studimor 1: Vrasje

Një burrë me prejardhje nga Afrika Veriore doli me makinë nga shtëpia e tij në orën 6:40 të mëngjesit. Gjatë rrugës, u ndoq dhe u godit nga një makinë tjetër. Në makinën tjetër, një 31-vjeçar, efektiv i polixisë që ishte në pushim mjekësor për shkak të dhimbjes së shpinës, po ngiste me armën e tij të shërbimit dhe një thikë të gjatë 46 cm. Ai fillimisht gjuajti nga dritarja dhe më pas qëlloi makinën e emigrantit duke e bërë atë të ndalonte dhe të dilte nga makina me një armë zjarri. E rrahu shoferin që po ikte dhe e qëlloi 11 herë në shpinë, këmbë dhe shputa. Më në fund, ndërsa ai ishte i shtrirë, oficeri e qëlloi shoferin në kokë. Sipas rrëfimit të tij, oficeri e kishte qëlluar atë me mendimin se do të kryente një sulm terrorist. Ai ishte i fiksuar me idenë e një sulmi terrorist në vendin e tij dhe mendonte se do të shpërblehej. “Mu duk se kishte tipare myslimane dhe koka ime nuk ndalej”. Ai u dënua me 14 vjet burg. Dënimi nuk e pranoi rrethanën e agruar që të trajtohet si krim i urrejtjes. Bazohet në “sëmundje të papritur mendore” të autorit të krimit.

Rasti studimor 2: Zjarrvënie

Në një shtet pjesëmarrës të OSBE-së, zyrat e bashkësisë afgane në kryeqytet u sulmuan dhe u dogjën. Një grup nacionalist mori përgjegjësi për sulmin. Pas sulmit, Bashkësia Myslimane theksoi se ata më herët kishin njoftuar policinë për një telefonatë kërcënuese që kishin marrë, por policia nuk dukej se kishte marrë masa serioze për të kryer hetim apo për ta kapur grupin. Në vitin 2017, i njëjti grup mori përgjegjësi për një sulm në shtëpinë e një djali afgan, i cili kishte dalë në lajme në lidhje me moslejimin e mbajtjes së flamurit gjatë një feste kombëtare.

Rasti studimor 3: Mesazhe dhe grafite

Muret e një godine të një universiteti dhe disa xhami të ndryshme në të gjithë qytetin u spërkatën me grafite. Mesazhet thoshin, “Nuk do të ketë xhami në [lagjen tonë]” dhe “Vdekje për Myftiun e Madh”.

Rasti studimor 4: Shkelje

Pas deklaratës së një politikani që ndalon ndërtimin e xhamive të reja, anëtarët e një grupi nacionalist shkelën në territorin e një xhamie dhe aty vendosën një poster, ku thuhej “Islamizimi vret”. E postuan atë në YouTube dhe policia u informua, por askush nuk u akuzua kurrë për vepër penale edhe pse fytyrat e tyre ishin të dukshme gjatë ngjarjes.

Rasti studimor 5: Sulm fizik

Një burrë sikh u sulmua jashtë një klubi nate të një destinacioni turistik nga një roje dhe kolegët e tij, sepse dukej si “terrorist”. Nga policia na u tha “çfarë prisni pas sulmeve të Parisit” dhe se “njerëzit e bardhë janë ndryshe nga njerëzit me ngjyrë”. Këto komente nga policia erdhën pasi u sulmua dhe u ndalua të hynte në klub nga sulmuesit agresivë që e pështynë, pavarësisht se ai ofroi që ta linin me kaq e të largohet. “Ata më rrethuan dhe njëri prej tyre më goditi në fytyrë me aq forcë, sa çallma më ra përtokë”, shtoi ai. “Unë u trondita, por u trondita edhe më shumë nga qëndrimi i policisë”, tha ai, duke shtuar se oficerët kishin parë se si sulmuesi kishte pështyrë dhe ishte përpjekur ta godiste përsëri pasi ishte identifikuar. Shtoi se policia kishte refuzuar të arrestonte sulmuesin e tij, dhe në vend të kësaj e kishte paralajmëruar se mund ndeshet me hakmarrje nga miqtë e rojës. Duke iu referuar incidentit, zëdhënësi i policisë rajonale mohoi të ketë pasur probleme me sjelljen e punonjësve të policisë. Menaxheri i klubit të natës tha se ai dënon të gjitha sjelljet raciste dhe se sulmuesi në fjalë ishte pezulluar dhe ishte në pritje të një hetimi, por ai mohoi çdo sulm që kishte ndodhur dhe deklaroi se personit sikh i ishte refuzuar hyrja sepse klubi kishte qenë plot.

Shtojca 2: Veprime të sugjeruara për palët kryesore të interesit

Tabela përmbledhëse

Unë jam	Çfarë mund të bëj për të ndihmuar në adresimin e problemit?	Me kë mund të punoj për të adresuar problemin?	Si mund ta përdor këtë botim?
Deputet	<p>Miratoni legjislacionin specifik dhe të përshtatur për të adresuar krimet nga urrejtja, duke siguruar dënime efektive që marrin parasysh rëndësinë e krimeve të motivuara nga paragjykimi.</p> <p>Kërkoni një shqyrtim ligjor nga ODIHR të legjislacionit ose ligjeve që lidhen me krimet e urrejtjes.</p> <p>Filloni një hetim parlamentar dhe shihni nëse duhet bërë më shumë në lidhje me adresimin e nevojave të sigurisë së bashkësive myslimane.</p> <p>Kontaktoni bashkësinë myslimane në rrethin tuaj që të mësoni më shumë rreth shqetësimeve të tyre.</p> <p>Sigurohuni që partia juaj politike të marrë masa për të sfiduar racizmin dhe intolerancën.</p> <p>Përdorni çdo mundësi për të dënuar dhe refuzuar shprehjet e paragjykit anti-mysliman: online dhe offline, të dhunshme dhe jo të dhunshme, dhe kërkoni këshilla ekspertësh për identifikimin e shprehjeve të koduara të paragjykit anti-mysliman.</p>	<p>Bashkoni forcat me deputetët e tjetër të partisë suaj ose të partive të tjera.</p> <p>Mësoni më shumë rreth punës së organeve ndërkombëtare të kuvendit në lidhje me paragjykitet anti-myslimane.</p> <p>Bashkëpunoni ngushtë me aktivistët e shoqërisë civile dhe udhëheqësit fetarë në bashkësinë tuaj për të ndërtuar një koalicion kundër paragjykitimeve anti-myslimane.</p>	<p>Njihuni me detyrimet e zbatueshme ndërkombëtare që adresojnë problemin.</p> <p>Kërkoni mënyra për të filluar, mbështetur dhe për t'u përfshirë në një nga iniciativat konkrete praktike në listë.</p> <p>Mësoni rreth tipareve specifike të krimeve të urrejtjes anti-myslimane për të forcuar përgjigjen tuaj ndaj paragjykitimeve anti-myslimane.</p>

Unë jam	Çfarë mund të bëj për të ndihmuar në adresimin e problemit?	Me kë mund të punoj për të adresuar problemin?	Si mund ta përdor këtë botim?
Nëpunës civil	<p>Nisni me zhvillimin e trajnimeve për krimet e urrejtjes kundër myslimanëve për nëpunësit civilë, veçanërisht për ata që mbikëqyrin dhe hartojnë trajnime për personelin e drejtësisë penale.</p> <p>Sigurohuni që politikat kundër ngacmimit dhe bullizmit në vendin e punës përfshijnë luftimin e intolerancës ndaj myslimanëve.</p> <p>Në varësi të rolit dhe mandatit tuaj, nisni një fushatë ndërgjegjësimi në lidhje me nevojën për t'i luftuar çështjet anti-myslimane.</p> <p>Spektori i brendshëm/Spektori i drejtësisë: zbuloni se si po ecën vendi juaj në fushën e mbledhjes së të dhënave për krimet e urrejtjes anti-myslimane dhe adresoni boshllëqet e të dhënave nëse ato ekzistojnë.</p> <p>Spektori i brendshëm/Spektori i drejtësisë: vlerësoni dhe rishikoni nëse mekanizmat, politikat dhe masat mund t'i adresojnë nevojat e sigurisë të bashkësive myslimane dhe të sigurojnë mbrojtje për vendet myslimane.</p>	<p>Konsultohuni me ekspertë akademikë ose institute kërkimore, si dhe organizata të shoqërisë civile me përvojë në ofrimin e trajnimeve të tilla.</p> <p>Punoni me autoritete lokale, organizata të shoqërisë civile dhe partnerë të medias.</p> <p>Kontakttoni me bashkësitë myslimane dhe organizatat e shoqërisë civile për të mësuar më shumë rreth raportimeve të tyre mbi krimet e urrejtjes kundër myslimanëve.</p> <p>Kontakttoni bashkësinë myslimane dhe lidhuni me përfaqësuesit e saj apo me koordinatorët e sigurisë.</p>	<p>Njihuni me spektrin e sulmeve anti-myslimane në rajonin e OSBE-së dhe me kontekstet kryesore që përbëjnë prapavijën e këtyre sulmeve.</p> <p>Kuptoni pse rritja e ndërgjegjësimi në lidhje me këtë çështje është kaq e rëndësishme.</p> <p>Konsultoni burime dhe ide relevante sa i përket rëndësisë së mbledhjes së të dhënave të krimet të urrejtjes.</p> <p>Shqyrtoni sugjerimet praktike se pse dhe si zyrtarët qeveritarë mund të bashkëpunojnë me bashkësitë myslimane për çështjet e sigurisë.</p>

Unë jam	Çfarë mund të bëj për të ndihmuar në adresimin e problemit?	Me kë mund të punoj për të adresuar problemin?	Si mund ta përdor këtë botim?
Efektiv policie	<p>Vlerësoni nëse një veprë penale që po regjistroni dhe hetoni mund të ketë qenë e motivuar nga paragjykimi.</p> <p>Caktoni një takim me bashkësinë tuaj lokale myslimane për të krijuar kontakte, për të identifikuar shqetësimet e tyre lidhur me sigurinë dhe për të parë se si funksionon kjo bashkësi.</p> <p>Ndërtoni kapacitetin tuaj për të kuptuar dhe për t'iu përgjigjur krimeve të urrejtjes kundër myslimanëve.</p> <p>Vlerësoni se si mund të bashkëpunoni me bashkësinë myslimane për të mbledhur të dhëna për krimet e urrejtjes anti-myslimane dhe për të adresuar raportimin e pamjaftueshëm.</p> <p>Sigurohuni që politikat kundër ngacimit dhe bullizmit në vendin e punës përfshijnë luftimin e intolerancës ndaj myslimanëve.</p> <p>Koordinoni procedurat e komunikimit emergjent me bashkësinë myslimane.</p>	<p>Pyesni viktimën dhe çdo dëshmitar për perceptimin e tyre për ndonjë paragjykim anti-mysliman në një incident apo krim.</p> <p>Bashkoni forcat me disa nga kolegët tuaj për t'i caktuar këto takime.</p> <p>Kërkoni nga mbikëqyrësi juaj të marrë pjesë në një program trajnimi, si TAHCLE dhe PAHCT.</p> <p>Bisedoni me mbikëqyrësit tuaj nëse kjo do të ishte diçka që mund të çohet në nivel kombëtar.</p> <p>Kërkoni një person kontakti në shërbimin e sigurisë së bashkësisë myslimane.</p>	<p>Shikoni treguesit e paragjykimeve të shënuar nën „II. Krimet e urrejtjes kundër myslimanëve në rajonin e OSBE-së: veçoritë kryesore” dhe shikoni nëse ju ndihmon të konstatooni një motivim nga paragjykimi.</p> <p>Mësoni më shumë rreth asaj se si agjencitë e zbatimit të ligjit mund të punojnë me bashkësitë myslimane në çështjet e sigurisë.</p> <p>Konsultohuni me listën e ofruar të burimeve dhe programeve të trajnimit, si programi TAHCLE i ODHR dhe Udhëzuesi për Mbledhjen e të Dhënave.</p> <p>Shikoni praktikatat e mira nga shtetet e ndryshme pjesëmarrëse të OSBE-së.</p>

Unë jam	Çfarë mund të bëj për të ndihmuar në adresimin e problemit?	Me kë mund të punoj për të adresuar problemin?	Si mund ta përdor këtë botim?
<p>Përfaqësues i bashkësisë fetare myslimane</p>	<p>Filloni të ndiqni krimet e urrejtjes anti-muslimane dhe inkurajoni anëtarët e bashkësisë suaj të raportojnë incidente dhe krime. Sigurohuni që metodologjia juaj për të regjistruar dhe interpretuar informacionin është e qartë dhe transparente.</p> <p>Formoni koalicionet me bazë të gjerë me organizatat që punojnë në çështjen e të drejtave të njeriut për t'i adresuar çështjet e tolerancës dhe jodiskriminimit kundër myslimanëve dhe më gjerë.</p> <p>Organizoni një ditë të hapur me bashkësinë myslimane dhe ftoni zyrtarë qeveritarë dhe aktivistë të shoqërisë civile për t'u njohur me bashkësinë.</p> <p>Këmbëngulni që qeveria juaj të përcjellë dhe t'i zbatojë detyrimet e saj ndërkombëtare.</p> <p>Kontaktoni institucionet kulturore dhe arsimore, si dhe mediat, për t'i njoftuar rreth raportimeve dhe shqetësimit tuaj në lidhje me paragjykimet anti-muslimane.</p>	<p>Kontaktoni me rrjetet relevante ndërkombëtare të shoqërisë civile.</p> <p>Kontaktoni me bashkësitë e tjera fetare, organizatat kulturore dhe grupet e shoqërisë civile për të fituar mbështetjen e tyre për koalicionet me bazë të gjerë.</p> <p>Bashkohuni me organizatat tjera të shoqërisë civile për të organizuar një ditë të hapur.</p> <p>Kontaktoni anëtarët e bashkësisë përkatëse, si dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile me përvojë në këtë fushë.</p> <p>Bisedoni me autoritetet e policisë tuaj lokale rreth mundësive për bashkëpunim të mundshëm dhe ngjarje për të promovuar sigurinë e bashkësisë dhe raportimin e krimit të urrejtjes në bashkësinë tuaj lokale.</p>	<p>Mësoni më shumë rreth programeve të trajnimit dhe burimeve të ofruara nga shoqëria civile dhe organizatat ndërqeveritare, si trajnimi i ODIHR-it për shoqërinë civile rreth krimeve të urrejtjes dhe udhëzuesi i tij burimor për shoqërinë civile.</p> <p>Mësoni më shumë për standardet ndërkombëtare që vlejnjë për qeverinë tuaj dhe atë që mund të jetë e rëndësishme për ju.</p>

Unë jam	Çfarë mund të bëj për të ndihmuar në adresimin e problemit?	Me kë mund të punoj për të adresuar problemin?	Si mund ta përdor këtë botim?
<p>Përfaqësues i një oraganizate për të drejtat e njeriut e udhëhequr nga myslimanë</p>	<p>Filloni të monitoroni krimet e urrejtjes anti-myslimane dhe inkurajoni anëtarët e bashkësisë suaj t'i raportojnë ato.</p> <p>Formoni koalicione me bazë të gjerë me organizatat që punojnë në çështjen e të drejtave të njeriut, për t'i adresuar çështjet e tolerancës dhe jodiskriminimit kundër myslimanëve dhe më gjerë.</p> <p>Organizoni ngjarje me bashkësinë myslimane, zyrtarët përkatës qeveritarë, policinë dhe aktivistë të shoqërisë civile, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për sfidat e sigurisë anti-myslimane dhe promovimin e aleancave për trajtimin e kësaj çështjeje.</p> <p>Këmbëngulni që qeveria juaj të ndjekë dhe t'i zbatojë detyrimet e saj ndërkombëtare.</p> <p>Kontaktoni institucionet kulturore dhe arsimore, si dhe mediat, për të ndarë raportimet dhe shqetësimet tuaja në lidhje me paragjykimin anti-mysliman.</p>	<p>Kontakto rrjetet relevante ndërkombëtare të shoqërisë civile.</p> <p>Kontaktoni me bashkësitë e tjera fetare, organizatat kulturore dhe grupet e shoqërisë civile për të fituar mbështetjen e tyre për koalicione me bazë të gjerë.</p> <p>Bashkohuni me organizata të tjera të shoqërisë civile për të organizuar një ditë të hapur.</p> <p>Kontaktoni pjesëtarët e bashkësisë përkatëse, si dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile me përvojë në këtë fushë.</p>	<p>Mësoni më shumë rreth programeve të trajnimit dhe burimeve të ofruara nga shoqëria civile dhe organizatave ndërqeveritare, si trajnimi i ODIHR-it për shoqërinë civile rreth krimeve të urrejtjes dhe udhëzuesi i tij burimor për shoqërinë civile.</p> <p>Mësoni më shumë për standardet ndërkombëtare që vlejnjë për qeverinë tuaj.</p>
<p>Aktivist i një shoqërie civile jomyslimane</p>	<p>Shikoni nëse ka ndonjë gjë që organizata juaj mund të bëjë për të treguar solidaritet ndaj bashkësisë myslimane për sulmet anti-myslimane.</p> <p>Planifikoni një ngjarje të përbashkët kulturore me bashkësinë myslimane për të kultivuar tolerancën dhe për të ndërtuar koalicione kundër paragjyqimeve anti-myslimane.</p> <p>Identifikoni qëllimet e përbashkëta me bashkësitë myslimane për t'u përpjekur së bashku për mbledhjen më të mirë të të dhënave të krimit të urrejtjes dhe në këtë mënyrë, të ndërtoni koalicione.</p> <p>Organizoni trajnime mbi paragjykimet anti-myslimane brenda organizatës suaj.</p>	<p>Kontaktoni bashkësinë myslimane ose një organizatë të bashkësisë myslimane për të mësuar më shumë rreth shqetësimeve të saj.</p> <p>Kontaktoni bashkësinë myslimane dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile dhe të bashkësisë që punojnë me krimet e urrejtjes.</p> <p>Konsultohuni me ekspertë akademikë ose institute kërkimore, si dhe organizata të shoqërisë civile me përvojë në ofrimin e trajnimeve të tilla.</p>	<p>Mësoni rreth ndikimit që kanë sulmet anti-myslimane në jetën e përditshme të myslimanëve.</p> <p>Mësoni më shumë rreth standardeve ndërkombëtare që vlejnjë për qeverinë tuaj.</p> <p>Njihuni me spektrin e sulmeve anti-myslimane në rajonin e OSBE-së dhe me kontekstet kryesore që përbëjnë prapavijën e këtyre sulmeve.</p>

Unë jam	Çfarë mund të bëj për të ndihmuar në adresimin e problemit?	Me kë mund të punoj për të adresuar problemin?	Si mund ta përdor këtë botim?
Udhëheqës fetar jomysliman	<p>Filloni një iniciativë ndërfetare që bashkon pjesëtarët e bashkësive të ndryshme, duke përfshirë edhe bashkësinë myslimane.</p> <p>Organizoni një ngjarje ndërgjegjësuese në bashkësinë tuaj rreth nxitjes së urrejtjes dhe krimeve anti-myslimane dhe ftoni një mysafir të paraqesë një projekt frymëzues për ndërtimin e koalicionit për shoqërinë civile.</p> <p>Fillo të mbledhësh të dhëna për krimet e urrejtjes që e targetojnë bashkësinë tënde.</p>	<p>Kërkoni këshilla dhe mbështetje nga organizata me përvojë në punën ndërfetare dhe ftoni disa anëtarë të tjerë të bashkësisë suaj të bashkohen.</p> <p>Kontakto me profesionistët e sigurisë së bashkësisë myslimane dhe shiko nëse ka një mënyrë për të bashkëpunuar me ta në fushën e mbledhjes së të dhënave të krimit të urrejtjes.</p>	<p>Mësoni rreth disa ngjarjeve ndërfetare dhe iniciativave që kanë ndodhur në të gjithë rajonin e OSBE-së në përgjigje të sulmeve anti-myslimane.</p> <p>Njihuni me manifestimet bashkëkohore të incidenteve dhe krimeve të urrejtjes anti-myslimane dhe mësoni se pse është kaq e rëndësishme t'i kapërceni ato përmes një qasjeje bashkëpunuese dhe të bazuar në të drejtat e njeriut.</p> <p>Mësoni më shumë rreth praktikave të mira ekzistuese.</p>
Avokati i Popullit/Organ i barazisë	<p>Nisni një sondazh për viktimizimin që të mësoni më shumë rreth nevojave të sigurisë të bashkësive myslimane dhe përvojës së tyre me krimet e urrejtjes kundër myslimanëve.</p>	<p>Konsultohuni me organizatat për mbështetjen e viktimave, bashkësinë myslimane dhe organet ndërkombëtare.</p>	<p>Mësoni më shumë për disa nga tiparet e paragjykitimit bashkëkohor anti-mysliman dhe si ndikon ai në bashkësitë myslimane.</p>
Mësimdhënës	<p>Kontrolloni nëse nxënësit myslimanë në shkollën tuaj përjetojnë ndonjë ngacmim, kërcënim ose dhunë gjatë rrugës për në shkollë, si dhe brenda shkollës.</p> <p>Krijoni mundësi që nxënësit të mësojnë për Islamin dhe në veçanti për intolerancën ndaj myslimanëve, racizmin dhe ksenofobinë.</p> <p>Sigurohuni që programi juaj mësimor dhe materialet mësimore të jenë gjithëpërfshirëse dhe të paanshme.</p> <p>Mbështetni dhe përfshihuni në trajnime për format bashkëkohore të paragjykimeve anti-myslimane.</p>	<p>Konsultohuni me kolegët tuaj, kontaktoni me organizatat e bashkësisë myslimane dhe lidhuni me organizatat rinore myslimane.</p> <p>Kërkoni mbështetje nga drejtoria e shkollës.</p>	<p>Mësoni më shumë për disa nga tiparet e paragjykitimit bashkëkohor anti-mysliman dhe si ndikon ai në bashkësitë myslimane.</p>

Shtojca 3: Islami dhe myslimanët: Çfarë duhet të dinë efektivët e policisë

Ky aneks është përshtatur dhe përmbledhur nga ODIHR me leje nga botimi *Islami dhe myslimanët: Çfarë duhet të dinë efektivët e policisë* botuar nga Shoqata e Shërbimeve Sociale Islame, Kanada.

Kjo shtojcë është përpiluar për t'i ndihmuar efektivët e policisë që ta kuptojnë më mirë bashkësinë myslimane, besimin dhe kulturën e tyre. Ajo nuk është menduar si shpjegim i sjelljes së çdo myslimani që një efektiv mund të hasë.¹²¹

Kush është mysliman?

Mysliman është një njeri që beson në fenë islame. Myslimanët besojnë se ka vetëm një Zot (Allahu) dhe se profeti Muhamed është profeti i fundit i Allahut. Myslimanët Sunitë dhe Shiitë përfaqësojnë dy kategori kryesore në Islam. Këto përfaqësojnë dy anë të ndryshme që u ndanë pas vdekjes së Profetit Muhamed, mbi trashëgimtarët e tij. Shumica e myslimanëve të botës janë sunitë. Vlerësimet sugjerojnë se shifra është diku midis 85% dhe 90%.¹²²

Ç'është Islami?

Islami është më shumë se një fe, është një mënyrë jetese. Nënkupton një nënshtrim paqësor ndaj vullnetit të të vetmit Zot (Allah në arabisht). Myslimanët besojnë në të gjithë profetët, duke përfshirë Jezusin dhe Moisiun. Myslimanët janë urdhëruar të ndjekin shembullin e Profetit Muhamed, i cili dallohej për nga ndershmëria dhe mëshira e tij.

Shtyllat e Islamit

Si të gjitha fetë, edhe feja islame ka një grup thelbësor besimesh dhe praktikash që e përcaktojnë atë. Këto janë disa emërues të përbashkët që e dallojnë dhe e përcaktojnë besimin islam. Në minimumin e saj, kjo bërthamë përfshin ato që njihen si pesë shtyllat e Islamit. Pesë shtyllat e besimit janë:

121 *Islami dhe muslimanët: Çfarë duhet të dinë efektivët e policisë*, Shoqata e Shërbimeve Sociale Islame, Kanada, <<http://www.issacanada.com/islam-and-muslims-what-police-offices-need-to-know/>>.

122 Sunitët dhe Shiitët: Përçarja e lashtë e Islamit:: <https://www.bbc.com/news/world-middle-east-16047709>

1. Dëshmia e besimit (shehadeti): Besimi dhe pohimi se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Pejgameri Muhamed është i dërguari i Allahut

Dëshmia e besimit është shtylla më themelore dhe më e rëndësishme e Islamit. Teologët myslimanë pajtohen se besimi dhe shqiptimi i dëshmisë së besimit është bindja dhe vepërimi përcaktues që e bën një njeri mysliman. Gjithashtu vlen dhe e kundërta: mohimi i dëshmisë së besimit do të thotë se një njeri nuk është mysliman. Në nivelin më bazik, dëshmia e besimit do të thotë një bindje e fortë dhe e palëkundur në një Zot, i cili nuk ka të barabartë dhe nuk është lindur dhe nuk ka lindur njeri tjetër. Dëshmia gjithashtu do të thotë të besosh se Muhamedi është i dërguari i Zotit, i cili me besnikëri e ka transmetuar atë që ia ka shpallur Zoti. Besimi se Muhamedi ishte vetëm një qenie njerëzore që nuk kishte fuqi apo atribute hyjnore është një pjesë kyçe e besimit islam. Roli i Muhamedit ishte i kufizuar në transmetimin e shpalljes hyjnore fjalë për fjalë dhe në të vepruarit me besnikëri sipas urdhrave të Zotit.

Zoti në të cilin besojnë myslimanët, në arabisht quhet Allah. Myslimanët besojnë se adhurojnë të njëjtin Zot që adhurojnë hebrenjtë dhe të krishterët. Sipas përdorimit në Kuran, fraza „Popujt e librit“ i referohet pasuesve të besimit abrahamik, kryesisht të krishterëve dhe hebrenjve. (Arsyeja që thuhet kryesisht për të krishterët dhe hebrenjtë është se Kurani përmend edhe sabianët, por juristët myslimanë e zgjeruan statusin e Popujve të librit tek zoroastrianët, hindutë dhe sikët dhe disa juristë madje shtuan edhe konfucianët në listë. Duke iu drejtuar ithtarëve të Librit, Kurani i përkujton pasuesit e tri religjioneve monoteiste se ata të gjithë e adhurojnë të njëjtin Zot.

2. Lutje (salat): Myslimanëve u kërkohet të kryejnë pesë lutje rituale në ditë. Myslimanët falin pesë namaze ditore të ndara në kohë të caktuara (tradita sunitë) në përputhje me pozitën e diellit, myslimanët shiitë bashkojnë namazet e mesditës dhe të mbrëmjes dhe në këtë mënyrë ata falen tri herë të ndara brenda ditës. Gjithashtu, myslimanëve u kërkohet të kryejnë aktin e lutjes në xhami një herë në javë, të premtëve, që njihet si falja e xhumasë. Myslimanët inkurajohen që të falen në xhami sa më shumë që të jetë e mundur. Falja e xhumasë të premtën bëhet për t'i bashkuar bashkësitë myslimane për të dëgjuar një predikim para se të kryejnë aktin e lutjes së bashku si një kongregacion.

3. Agjërimi gjatë Ramazanit (sijam): Gjatë muajit të Ramazanit, nga agimi deri në perëndim të diellit, çdo ditë për tridhjetë ditë, myslimanët abstenojnë nga ngrënia dhe pirja, nëse janë fizikisht në gjendje ta bëjnë këtë, si dhe nga marrëdhëniet intime seksuale. Ky është një muaj në të cilin myslimanët përqendrohen në të gjitha format e vetë-disiplinës dhe përpiqen të heqin zakonet e këqija. Gjatë muajit të Ramazanit, myslimanët priten që të përpiqen edhe më fort që t'i kapërcejnë dëshirat inferiore dhe dobësitë e tyre. Në burimet islame, kjo njihet si *xhihad al-nafs*, lufta kundër vetvetes.

4. Dhënia e lëmoshës (zekatit): Kjo nënkupton një përqindje të caktuar (që varion nga 2,5 përqind deri në 20 përqind, në varësi të sektit) të pasurisë së tyre për të varfëritë çdo vit. Krahas këtyre lëmoshave, myslimanët inkurajohen fort të japin sadaka, secili sipas pasurisë dhe mundësisë së tij.

Dhënia e lëmoshës është një nga detyrimet më të theksuara në Kuran. Kurani përmend grupe njerëzish që posaçërisht meritojnë bamirësi: të varfërit, jetimët, të afërmit në nevojë, udhëtarët dhe të panjohurit ose të huajt në vend, dhe të burgosurit e luftës ose njerëzit e tjerë në një gjendje robërie. Diçka me rëndësi është se shumica e dijetarëve myslimanë nuk bëjnë dallim në mes të dhënies së lëmoshës për myslimanët apo jomyslimanët.

5. Haxhi: Një pelegrinazh në Mekë një herë në jetë për ata myslimanë që mund ta përballojnë udhëtimin dhe shëndeti i të cilëve i lejon ta bëjnë atë.

Haxhi është simbol i bashkimit mysliman dhe i barazisë themelore të të gjithë myslimanëve. Të gjithë myslimanët bëjnë haxhin të veshur me të njëjtat rroba, në mënyrë që të mos ketë përçarje mes të pasurve dhe të varfërve; të gjithë qëndrojnë pranë njëri-tjetrit para Allahut, ndërsa vishen me të njëjtët mbështjellës të bardhë (ihram) për burrat dhe veshje të thjeshta për gratë.

„Këto pesë shtylla përbëjnë shtyllën kurrizore të besimit islam dhe sipas ligjit islamik tradicional, të gjithë myslimanët duhet të përpiqen të paktën t’i përmbushin pesë detyrimet me ndershmëri dhe sinqeritet.“ Mohimi i njëjës prej pesë shtyllave e përjashton njeriun nga besimi islam, që do të thotë se myslimani, në parim, duhet t’i pranojë pesë shtyllat si të detyrueshme. Më pas zbatimi i pesë shtyllave është një çështje tjetër. Për sa kohë që dikush pranon se pesë shtyllat janë thelbi i Islamit dhe thotë dëshminë e besimit, ai pranohet në përfaqimin e Islamit. Objektivi thelbësor i pesë shtyllave është t’i mësojë njerëzit të punojnë vazhdimisht në zhvillimin e një marrëdhënieje me Perëndinë; për të mësuar devotshmërinë, vetëpërbajtjen dhe përlësinë; për të theksuar vëllazërinë e përbashkët të të gjithë myslimanëve; dhe për të nënvizuar rëndësinë e shërbimit ndaj të tjerëve si një mjet për të adhuruar Perëndinë. Pesë shtyllat janë përshkruar si themeli mbi të cilin qëndron pjesa tjetër e Islamit, sepse ato hapin potencialin e realizimit të vërtetë sublim - për të realizuar Perëndinë në vetvete duke iu dorëzuar Hyjnisë.”¹²³

A kanë myslimanët një libër të shenjtë?

Kurani është libri i shenjtë i myslimanëve. Myslimanët besojnë se i është shpallur Profetit Muhamed para 14 shekujsh, në një periudhë 23 vjeçare dhe e ka ruajtur formën e tij origjinale deri në këtë ditë. Kur marrim Kuranin në dorë duhet të trajtohet me respekt.

Ç’është syneti dhe hadithi?

Syneti është praktika e Profetit Muhamed dhe ajo që ai e aprovoi. Hadithet janë thënie të Profetit Muhamed.

123 Kjo pjesë mbi pesë shtyllat e Islamit është përshtatur nga Khaled Abou El Fadl, *Vjedhja e Madhe: Shkëputja e Islamit nga ekstremitetit*, <<https://www.searchforbeauty.org/islam-101/what-muslims-believe/>>.

Festat Myslimane

Ka dy festivale vjetore. **Fitër Bajrami** (Festa e mbarimit të agjërimit) zhvillohet menjëherë pas muajit Ramazan. **Kurban Bajrami** (Festa e flijimit) zhvillohet gjatë Haxhit. Ndiqet kalendari hënor për të përcaktuar datën e secilës. Çdo festë fillon me lutje të veçanta në të cilat marrin pjesë të gjithë myslimanët dhe zakonisht është një nga tubimet më të mëdha të myslimanëve në një vend.

Haxhi është një pelegrinazh vjetor në Mekë, një udhëtim që kërkohet të paktën një herë në jetën e një myslimani, nëse ata janë të aftë financiarisht dhe fizikisht.

Viti i Ri islamik fillon me ditën e parë të muajit Muharrem, muaji i parë në kalendarin hënor islamik. Kalendari islamik filloi me shpërnguljen e Profetit Muhamed dhe ndjekësve të tij nga Meka në Medinë.

Mevludi shënon lindjen e Pejgamerit dhe i referohet përvjetorit të ditëlindjes së Profetit Muhamed.

Ashura

Ashura bie në ditën e dhjetë të muajit Muharrem. Për myslimanët Sunit kjo zakonisht shënohet duke kryer një agjërime vullnetar që praktikohet nga Profeti Muhamed. Për myslimanët shiitë, ajo shënon përvjetorin e vdekjes tragjike të nipit të profetit, Huseini. Zakonisht përkujtohet duke mbajtur zi dhe nganjëherë duke ri-përsëritur ngjarjen tragjike.

Kufizimet në të ushqyer

Islami ndalon konsumimin e mishit të dërrit dhe produkteve të tij. Alkooli dhe të gjitha llojet e drogës janë të ndaluara në Islam. Ushqimi që i plotëson kërkesat fetare myslimane quhet „hallall”.

Udhëzime të përgjithshme

Myslmanëve dhe myslimaneve u rekomandohet që të vishen në mënyrë modeste në publik.

- a. Disa burra praktikojnë që të mbulojnë trupin e tyre nga kërthiza deri poshtë gjunjëve me rroba të gjëra dhe jo transparente. Disa burra myslimanë mbulojnë kokën e tyre me një kapelë rrethore, ndonjëherë të bardhë, ndonjëherë me ngjyra të tjera, zakonisht të quajtur „kufi”. Burrat myslimanë inkurajohen nga shembulli i Profetit Muhamed dhe risin mjekrën e tyre. Ky është një akt i rëndësishëm fetar që duhet të respektohet. Ata nuk duhet të detyrohen ta heqin atë përveç nëse është e nevojshme për sigurinë dhe shëndetin.

- b. Disa gra myslimane ndjekin rekomandimet për të mbuluar trupin e tyre, por fytyrën dhe duart e tyre me veshje të lirshme dhe jotransparente. Disa gra myslimane i mbulojnë flokët, qafën dhe gjoksën e tyre me një shall që zakonisht quhet “hixhab”. Disa gra myslimane gjithashtu mbulojnë fytyrën e tyre me një vello të hollë të quajtur “niqab”.

Duhet të theksohet gjithashtu se jo të gjithë burrat dhe gratë myslimane vishen në këtë mënyrë. Kjo në asnjë mënyrë nuk e zvogëlon përkushtimin e tyre ndaj besimit.

Frazat arabe që përdorin myslimanët

Elhamdulillah

Falë Zotit, vjen si përgjigje ndaj pyetjes: “Si je?”

Assalamu Alejkum

Kjo është një shprehje që myslimanët e thonë sa herë që takohen me njëri-tjetrin. Është një përhëndetje që përkthehet si „Paqja qoftë mbi ty.“

Jazakum Allahu khairan

All-llahu të shpërbleftë për mirësitë tua! Versioni mysliman i falënderimit.

Subhan'Allah

Vetëm Allahu është i denjë për falënderim në raste arritjeje apo bekimi.

Insha' Allah

Në dashtë Zoti, thuhet kur premtojmë diçka ose synojmë të bëjmë diçka.

Allah' O Akbar

Zoti është i madh, thirrje për namaz, një frazë që përdoret shpesh në adhurimin e Zotit. Disa Terma të Përdorur dhe Diskutuar Gjerësisht

Xhihad

Përkthimi i gjerë në gjuhën angleze „luftë e shenjtë“ ka sjellë keqkuptim të masë, pasi fjala xhihad do të thotë betejë, përpjekje, synim. Termi “luftë e shenjtë” nuk ka rrënjë në terminologjinë islame. Beteja më e rëndësishme është pastrimi i zemrës duke kryer vepra të mira dhe duke ndjekur urdhëratë e Allahut. Islami lejon luftën vetëm nën kushte të rrepta të vetëmbrojtjes dhe për t’i dhënë fund persekutimit. Në traditën islame kur flasim për xhihadin si formë ndërhyrjeje ushtarake mund të deklarohet vetëm nga autoritete të larta fetare dhe politike të bazuara në kushte dhe rregulla të qarta të luftës.

Hoxha

Hoxha është “drejtuesi” i cili udhëheq faljen në xhami dhe kryen ceremoninë javore të xhumasë. Në disa shoqëri, ku xhamitë janë qendrat e komunitetit mysliman, hoxha gjithashtu ka rolin e këshilluesit shpirtëror dhe zëdhënës i komunitetit. Shumë xhami ose fatore më të vogla, punësojnë hoxhë me orar të plotë por gjithashtu ka raste ku shërbejnë

edhe vullnetarisht. Nuk duhet ti krahasojmë me priftërinjtë, pasi kjo formë nuk ekziston në islam (Mirëpo myslimanët shiitë pozicionit të hoxhës i japin më shumë rëndësi)

Sheriati

Sheriati është një organ/përmbledhje gjithëpërfshirëse e opinioneve dhe jurisprudencës që mbulon të gjitha sferat e jetës: shoqërore, politike, ekonomike dhe shpirtërore. Myslimanët ndjekin Sheriatin në jetën e tyre të përditshme në një nivel personal, të tillë si abstenimi nga alkooli ose bixhozi. Sheriati rrjedh nga Kurani (burimi i parë i shpallur hyjnor i besimit) dhe hadithet (burimi i dytë i fesë) thënie dhe profetit. Qëllimi i Sheriatit është vendosja e drejtësisë dhe paqes në shoqëri. Masat ndëshkuese të përmendura në Kuran janë vetëm një pjesë e vogël e këtij burimi.

Fetva

Një mendim ose vendim fetar jo i detyrueshëm, që mund të nxirret për çdo çështje vetëm nga dijetarë të kualifikuar të Islamit. Çdo mysliman mund të kërkojë një fetva se dijetarët mund të deklarojnë një me iniciativën e tyre në çështjet që kanë të bëjnë me jetën shoqërore, politike, ekologjike dhe shpirtërore të myslimanëve.

Etiketa shoqërore¹²⁴

Privatësia dhe shtrëngimi i duarve

Rekomandohet që efektivet të jenë të së njëjtës gjini kur hetojnë gratë apo burrat myslimanë. Nëse kjo nuk është e mundur, rekomandohet që të pranohet një efektivi i gjinisë së kundërt dhe t'u shpjegohet. Disa myslimanë gjithashtu do të zgjedhin të mos shtrëngojnë duart ose të kenë ndonjë kontakt fizik me njerëz të gjinisë së kundërt, përveç nëse ata janë prindërit e tyre, vëllezërit e motrat ose bashkëshortët. Një pohim apo lëvizje e thjeshtë me kokë mjafton në këto raste. Ajo duhet të merret si një formë për të vendosur kufij personalë.

Kontrollet e trupit

Nëse kërkohet një kontroll trupor, rekomandohet shumë që një efektivi policie i të njëjtës gjini ta bëjë atë. Rekomandohet që kjo të bëhet në privatësi. T'i kërkojë një gruajë myslimane të heqë shaminë ose veshjen e saj të jashtme duhet të hyjë në këtë kategori.

Heqja e këpucëve në shtëpi

Nëse nuk është rast urgjent, është e këshillueshme që të hiqen këpucët kur hyn në një shtëpi myslimane. E njëjta gjë vlen kur vizitoni një vend adhurimi mysliman.

124 Ky seksion nuk synon të përcaktojë atë që konsiderohet etiketë sociale e përshtatshme nga të gjithë myslimanët kudo, por përfaqëson një përmbledhje të shkurtër të praktikave që respektohen dhe vlerësohen në shumicën e komuniteteve muslimane.

Shtojca 4:

Përkufizimi i terminologjisë

Vendimet dhe zotimet e Këshillit Ministror të OSBE-së flasin për “intolerancën ndaj myslimanëve” dhe kjo është terminologjia e përdorur në këtë Udhëzues. Zotimet dhe dokumentet zyrtare të OSBE-së nuk përmbajnë një përkufizim ose shpjegim të mëtejshëm të terminologjisë së përdorur.

Rekomandimi Nr. 7 i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës të Këshillit të Evropës e përkufizon racizmin si „besimi se një bazë e tillë si raca, ngjyra, gjuha, feja, origjina kombëtare ose etnike justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash“.¹²⁵

Për më tepër, në Rekomandimin e Politikave të Përgjithshme Nr. 8 për luftimin e racizmit gjatë luftës kundër terrorizmit, ky Komision thotë: “Si rezultat i luftës kundër terrorizmit që ka filluar që nga ngjarjet e 11 shtatorit 2001, grupe të caktuara personash, veçanërisht arabët, hebrejtë, myslimanët, disa azilkërkues, refugjatë dhe emigrantë, disa pakica të dukshme dhe persona të cilët perceptohen se iu përkasin grupeve të tilla, janë bërë veçanërisht të cenueshëm ndaj racizmit dhe/ose diskriminimit racor në shumë fusha të jetës publike, përfshirë arsimin, punësimin, strehimin, qasjen në mallra dhe shërbime, qasjen në vende publike dhe lirinë e lëvizjes”.¹²⁶

Raporti Evropian i Islamofobisë, që mbulon 34 vende për vitin 2018, i përpiluar nga Fondacioni për Kërkime Politike, Ekonomike dhe Sociale (SETA), një institut kërkimor jofitimprurës, përdor shpjegimin dhe formulimin e mëposhtëm: “Kur flasim për islamofobi, nënkuptojmë racizmin anti-mysliman. Siç kanë treguar studimet e antisemitizmit, përbërësit etimologjikë të një fjale nuk tregojnë domosdoshmërisht kuptimin e saj të plotë, as se si ajo përdoret. I tillë është edhe rasti i studimeve të islamofobisë. Islamofobia është bërë një term i njohur në akademi, po aq sa edhe në sferën publike. Kritika ndaj myslimanëve apo fesë islame nuk është domosdoshmërisht islamofobike. Islamofobia ka të bëjë me një grup dominues njerëzish që synojnë marrjen, stabilizimin dhe zgjerimin e pushtetit të tyre me anë të përcaktimit të një kurbanit – të vërtetë apo të shpikur – dhe përjashtimit të këtij kurbanit nga burimet /të drejtat/ përkufizimi i një „ne“ të ndërtuar. Islamofobia operon duke ndërtuar një identitet statik “mysliman”, i cili atribuohet në terma negativë dhe i përgjithësuar për të gjithë myslimanët. Në të njëjtën kohë, imazhet islamofobike janë fluide dhe ndryshojnë në kontekste të ndryshme, sepse islamofobia na tregon më shumë për islamofobin sesa për myslimanët/Islamin.”¹²⁷

125 Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t Nr. 7 mbi Legjislacionin Kombëtar për Luftimin e Racizmit dhe Diskriminimit Racial: <<https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-7-revised-on-national-legislatio/16808b5aae>>.

126 Rekomandimi i Politikës së Përgjithshme të ECRI-t Nr. 8 mbi Luftimin e Racizmit gjatë Luftimit të Terrorizmit: <<https://rm.coe.int/ecri-general-policy-recommendation-no-8-on-combating-racism-while-figh/16808b5abc>>.

127 Raportet Evropiane dhe Islamofobia; redaktor! Bayrakli, Enes dhe Hafez, Farid; Fondacioni SETA dhe Instituti Leopold Weiss, financuar nga Bashkimi Evropian, 2019; <<http://www.islamophobiaeurope.com/2018-reports/>>



osce

ODIHR